



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 474 Akti

Nr. 523Vendimi
Tiranë, më 07.4 2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petcovic, në datën 5.4.2022, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Eriselda Bala**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Eriselda Bala, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka zhvilluar shortin në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Eriselda Bala do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Suela Zhegu, Brunilda Bekteshi, Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 23.12.2019, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Eriselda Bala, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Suela Zhegu. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Në datën 9.1.2020 subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit në datën 22.01.2020 deklaroi mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

6. Në datën 15.3.2022, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Eriselda Bala, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e tij brenda datës 28.4.2022, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47, të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 15.3.2022, subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën. Subjekti, në datat 30.3.2022 dhe 1.4.2022, dërgoi në mënyrë elektronike, shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ.

8. Trupi gjykues, në datën 31.03.2022, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Eriselda Bala, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, duke njoftuar se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 5.4.2022, në orën 13:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Eriselda Bala u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petcovic. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me

rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Eriselda Bala dhe në datën 7.5.2022 zhvilloi seancën për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Znj. Eriselda Bala ka qenë bashkëpunuese me Komisionin gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur dhe paraqitur dokumente shkresore sa herë që i është kërkuar dhe brenda afateve të përcaktuara, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLP-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese¹ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizoi një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. ILDKPKI-ja, me raportin nr. *** prot., datë 29.10.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Eriselda Bala, e cila ka qenë subjekt deklarues në ILDKPKI që prej vitit 2008 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ka dorëzuar rregullisht deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV) të interesave pasurorë,

¹Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

ndërsanë datën 26.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, ky institucion ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin; (ii) nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor për të justifikuar mundësinë financiare të familjarëve për shumat e dhëna dhuratë/hua; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim të kriterit pasuror të pavarur nga përfundimet e ILDKPKI-së, si dhe një vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI së bashku me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra prezent me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; si dhe (d) argumentimet e dhëna verbalisht në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Nga ana e Komisionit janë analizuar pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, sipas formularit (shtojca nr. 2) të datës 26.1.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, si vijon:

15. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Automjet i blerë më 7.2.2009, tip "Mercedes-Benz C220 CDI", viti i prodhimit 2003, blerë në çmimin 11.390 euro, me targa ***. Për blerjen e automjetit janë përdorur kursime të miat gjatë viteve të studimeve në Shkollën e Magjistraturës, konkretisht shuma prej 301.000 lekësh dhe 5.000 USD, të depozituara në bankë dhe një hua prej 800.000 lekësh nga familjarë, V.L, shumë e cila është shlyer plotësisht prej meje me anë të kursimeve nga paga si prokurore. Vlera e automjetit 11.390 euro. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente shkresore². Në lidhje me këtë pasuri, ILDKPKI-jaka konstatuar: "Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e DPSHTRr-së (rezulton se përveç vlerës 11.390 euro janë paguar dhe detyrimet doganore në shumën 478.502 lekë të cilat nuk janë deklaruar)".*

Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

16.1 Nga verifikimi i DPV-e rezultoi se subjekti ka kryer për herë të parë deklarime në vitin 2009, si vijon:

-Në rubrikën përshkrimi i pasurive e ka deklaruar këtë pasuri me përshkrimin: "*Automjet tip 'Mercedes-Benz C220'. Viti i prodhimit shkurt 2003. Blerë më shkurt në vitin 2009 me anë të depozitave të mia bankare 5.000 USD dhe 300.000 lekë. Vlera 11.300 euro. Zotëron: 100%*", pa deklaruar burimin e krijimit të këtyre depozitave.

- Në po të njëjtën rubrikë ka deklaruar pakësim të depozitave të saj, përkatësisht në vlerën 5.000 USD, në "Intesa Sanpaolo Bank", si dhe vlerën 300.000 lekë në "ProCredit Bank".

-Në rubrikën "detyrime financiare ndaj personave juridikë e fizikë", subjekti ka deklaruar: "*Detyrim në lekë në vlerën 800.000 lekë për blerjen e makinës nga familjarë. Data e fillimit të detyrimit shkurt 2009. Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në datën 31 dhjetor të vitit të deklarimit 300.000 lekë. Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer në shumën 500.000 lekë*".

²Aneks nr. 4/1, në dosjen e ILDKPKI-së.

16.2 Me kërkesë të Komisionit, DPSHTR³-ja ka konfirmuar se:

i) Automjeti me targa*** është në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe është blerë në datën 7.1.2009, sipas faturës së shitjes në gjuhën gjermane në vlerën 11.390 euro, e cila parashikon se shuma 10.000 euro është paguar në datën 7.1.2009, në rrugë bankare, ndërsa shuma 1.390 euro do të paguhej *cash* në datën 7.2.2009⁴.

ii) Referuar deklaratës doganore, datë 12.2.2009, subjekti ka paguar vlerën 478.502 lekë për zhdoganimin e këtij mjeti. Kjo shumë nuk rezultoi të ishte deklaruar nga ana e subjektit në deklaratën periodike dhe as në deklaratën *Vetting*. Sa i takon burimit të krijimit të të ardhurave për të paguar këtë shumë, nëpërgjigje të pyetësorit nr.2, datë 6.12.2021, ndër të tjera, subjekti ka sqaruar se: “*Dua të sjell në vëmendjen tuaj se në kohën kur është kryer ky shpenzim, jetesa ime ka qenë së bashku me familjen e origjinës, prindërit dhe dy motrat. Në këtë periudhë kemi qenë të punësuar katër persona në familje, nëna ime V.B, babai B.B, motra E.B dhe unë. Kjo makinë ka qenë për nevoja familjare dhe referuar përdorimit të saj dhe/apo policave të sigurimit, ka qenë në emrin tim dhe të nënës sime V.B*”. Duke iu referuar këtij deklarami, shpenzimet e zhdoganimit janëpërfshirë nëanalizën financiare të kryer përperiudhën1993 – 12.2.2009, kur subjekti ka banuar në familjen prindërore.

Në lidhje me burimin e krijimit tëpasurisë

17. Komisioni hetoi në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie sipas deklarimeve në deklaratën *Vetting*: (i)*kursimet gjatë viteve të studimeve në Shkollën e Magjistraturës, konkretisht shuma prej 301.000 lekë dhe 5.000 USD, të depozituara në bankë;si dhe (ii)hua prej 800.000 lekësh, marrë nga familjarë, shtetasi V.L.* Konkretisht:

17.1 Sa i takon burimit *kursime gjatë viteve të studimeve në Shkollën e Magjistraturës*, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë në Shkollën e Magjistraturës për periudhën tetor 2006 - 2008 dhe është trajtuar me bursë gjatë kësaj periudhe. Për rrjedhojë, kursimet gjatë kësaj periudhe nuk mund të kenë shërbyer për blerjen e mjetit. Ndërsa, në lidhje me shumat prej 301.000 lekësh dhe 5.000 USD, të depozituara në bankë, nga të dhëna të paraqitura nga “ProCredit⁵ Bank”, nga rezultoi se:

i) Subjekti ka çelur depozitë në monedhën lekë në datën 27.12.2006,në “ProCredit Bank”, në vlerën 120.000 lekë dhe, më pas, ka kryer depozitime për çdo vit duke e mbyllur (tërhequr) depozitën në datën 28.3.2009, në vlerën 309.579,19 lekë së bashku me interesat përkatëse të përfituara. Siç vërehet, kjo shumë nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi për blerjen e automjetit të blerë në datën7.1.2009, zhdoganuar më 12.2.2009.

ii) Subjekti ka çelur në datën 13.7.2006 një depozitë në valutë, në vlerën 5.000 USD, e cila ishte mbyllur në datën 13.9.2008 dhe kjo shumë ishte depozituar në “Intesa Sanpaolo Bank”⁶ në datën 17.9.2008. Subjekti e ka tërhequr depozitën së bashku me interesat e përfituara në vlerën 5.065,85 USD, në datën 24.9.2009. Siç vërehet, kjo shumë nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi për automjetin, pasi është tërhequr 7 muaj më vonë nga data e blerjes së automjetit.

17.2. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni e pyeti subjektin lidhur me faktin që dy depozitat e sipërpërmendura janë tërhequr pas blerjes së mjetit. Nëpërgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka sqaruar se⁷: “... *burim për blerjen e këtij automjeti janë pikërisht ato që kam deklaruar dhe më parë, por për shkak se kursimet e mia ndodheshin të depozituara në bankë dhe në mënyrë që mos të penalizohesha për tërheqjen e këtyre depozitave nga banka përpara*

³Referojuni shkresën nr. *** prot., datë 22.5.2020, në dosjen e Komisionit.

⁴Sipas sistemit *TIMS* nuk rezulton që subjekti apo bashkëshorti të kenë dalë jashtë shtetit në janar të vitit 2009.

⁵Shkresë nr. OP-***prot., datë 14.5.2020.

⁶Shkresë nr. ***prot., datë 19.5.2020.

⁷Pyetësor nr. 3 datë 24.1.2022.

datës së maturimit jam ndihmuar për një afat të shkurtër kohe deri në maturimin e depozitave nga prindërit e mi. Këtë ndihmë nuk e kam paraqitur në deklaratën periodike të deklarimit të pasurisë të vitit 2009, pasi veprimi është kryer dhe përfunduar brenda vitit 2009, pra, brenda të njëjtës periudhë deklarimi. Ndërkohë që kam deklaruar ndryshimet e ndodhura në periudhën midis deklaramëve duke sqaruar faktin se janë pakësuar dy depozitat e mia të cilat janë përdorur për blerjen e automjetit, si dhe huaja ndaj familjes së hallës sime e cila vazhdon të mos ishte shlyer ende në vitin pasardhës.

Në lidhje me burimin e të ardhurave të prindërve të mi, siç kam deklaruar dhe më parë prindërit e mi kanë qenë gjithmonë në marrëdhënie pune në institucione shtetërore dhe të ardhurat e tyre kanë qenë të kënaqshme duke krijuar kursime vit pas viti. Në lidhje me të ardhurat e familjarëve të mi, nënës V.B, motra E.B dhe babait B.B, kam bashkëlidhur dokumentacion dhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

Në printimin e statement bankar nga 'Raiffeisen Bank', ku përveç të ardhurave nga paga për periudhën 4.5.2005 – 15.5.2009 (periudhë gjatë të cilës paga e babait tim B.B është marrë nëpërmjet kësaj banke), ndodhet dhe statement bankar i depozitës nr. llogarie 2302005402, ku në datën 22.8.2008, babai im B.B, ka tërhequr nga llogaria shumë prej 1,137,000 lekë, të cilat i ka mbajtur gjendje cash në banesë për disa vite". Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore.

17.3. Përsa i takon burimit të të ardhurave të prindërve, të cilat sipas subjektit e kanë ndihmuar për blerjen dhe zhdoganimin e mjetit përpara se depozitat e subjektit të maturoheshin, nga ana e Komisionit u kryen verifikime bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ⁸, nga të cilat rezultoi se:

- Babai i subjektit të rivlerësimit, shtetasi B.B ka qenë në marrëdhënie pune pa ndërprerje që prej datës 1.9.1978, në disa pozicione të ndryshme në Ministrinë e Mbrojtjes (Forcat e Armatosura, ***, etj.);

- Nëna e subjektit të rivlerësimit, shtetasja V.B ka qenë në marrëdhënie pune pa ndërprerje që prej datës 2104.1981 deri në momentin e daljes në pension në gusht të vitit 2020, në disa pozicione të ndryshme në Ministrinë e Mbrojtjes (repart ushtarak).

- Motra e subjektit të rivlerësimit, shtetasja E.B ka qenë në marrëdhënie pune⁹ pa ndërprerje që prej datës 5.12.2008 deri në nëntor të vitit 2014.

- Investimet e kryera nga prindërit e subjektit konsistojnë vetëm në blerjen e një apartamenti, i përfutur nga Enti Kombëtar i Banesave¹⁰ dhe një automjeti¹¹ të blerë në vitin 2008 nga babai i saj.

- Babai i subjektit, shtetasi B.B, ka çelur në datën 16.6.2003 depozitë në vlerën 6.600 USD, në "Tirana Bank"¹².

- Nëna e subjektit shtetasja V.B, ka çelur në "ProCredit Bank", në datën 19.1.2006 depozitë në vlerën 1.310.000 lekë (kjo shumë vjen si rezultat i tërheqjes së depozitës në "Raiffeisen Bank"¹³) dhe në datën 13.7.2006 depozitë në vlerën 10.000 USD¹⁴.

⁸Depozituar nga subjekti në pyetësorin nr. 2, datë 6.12.2021, librezat e punës të prindërve, si dhe nga korrespondenca e Komisionit me bankat e nivelit të dytë.

⁹Sipas librezës së punësimit.

¹⁰Kontratë shitje apartamenti nr. ***, datë 11.6.2008, administruar me shkresën e ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Veri, nr. *** prot., datë 8.6.2020, si finalizim i kontratës së shitjes me kusht nr. ***, datë 13.5.2002.

¹¹Shkresë nr. *** prot., datë 22.5.2020, nga DPSHTRr-ja. Mjet i blerë në vlerën 3.900 euro dhe TVSH në doganë 304.906 lekë.

¹²Shkresë nr. *** prot., datë 15.5.2020.

¹³E cila figuron që prej vitit 2005.

¹⁴Shkresë nr. OP-*** prot., datë 14.5.2020.

- “Raiffeisen Bank” konfirmon deklarinimin e subjektit se babai i saj ka tërhequr nga llogaria e tij në këtë bankë në datën 22.8.2008, shumën 1.137.000 lekë, sipas saj mbajtur *cash* prej tij në banesë¹⁵.

- Të ardhurat e prindërve të subjektit, vetëm nga pagat të evidentuara në bankë, për periudhën 2006 – shkurt 2009, kanë qenë në vlerën 4.246.211 lekë.

- Për një hetim sa më shterues, meqenëse depozitat e prindërve të subjektit datojnë që prej vitit 2003, Komisioni i kërkoi¹⁶ subjektit dokumentacion justifikues ligjor për të provuar të ardhurat e përfituara nga punësimi i prindërve të saj përpara vitit 2004. Subjekti depozitoi dokumentacionin përkatës¹⁷. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se në dokumentacionin e depozituar nuk janë paraqitur shifrat e sakta të të ardhurave vjetore, pasi nuk janë përfshirë të ardhurat shtesë si pagesat për orë jashtë orarit apo shpërblimet vjetore.

Në analizë të të gjithë informacioneve si mësipër, duke marrë në konsideratë faktin se depozitat e subjektit datojnë përpara fillimit të Shkollës së Magjistraturës dhe gjatë saj (pra, përpara emërimit të subjektit në detyrë), periudhë gjatë së cilës subjekti ka jetuar me familjen prindërore, si dhe faktin që prindërit e saj kanë qenë gjithmonë në marrëdhënie pune me institucione shtetërore dhe me pagë mbi mesataren, nga të dhënat e administruara duket se prindërit e subjektit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme, si për të çelur depozitën në vitin 2006 në vlerën 5.000 USD, ashtu edhe për t’i dhënë këtë shumë subjektit në momentin e blerjes së mjetit, sikurse pretendon në shkurt të vitit 2009, për shkak se depozita maturohej më vonë. Gjithashtu, është vlerësuar se ata kanë pasur mundësi për t’i dhënë subjektit shumën 300.000 lekë në momentin e blerjes së mjetit, pasi siç ka rezultuar, kjo shumë ishte tërhequr nga subjekti pas blerjes së mjetit.

17.4. Sa i takon burimit *hua prej 800.000 lekësh, marrë nga familjarë, shtetasi V.L,* nga deklarinimet e subjektit rezultoi se:

- Në deklaratën periodike të vitit 2009, subjekti ka deklaruar detyrimin financiar në vlerën 800.000 lekë, për blerjen e automjetit, por pa përcaktuar emrin e personit ndaj të cilit ishte ky detyrim.

- Në përgjigje të pyetësorit nr.1, datë 9.1.2020, lidhur me huan e marrë dhe burimin e ligjshëm të krijimit të saj, subjekti sqaroi se: *“Në vitin 2009, kam marrë hua nga familja e hallës (e deklaruar nga bashkëshorti i saj V.L) në shumën tetëqind mijë lekë. Huan e mora pa kushte dhe e përdora për blerjen e automjetit, të cilin e kam në përdorim edhe sot. Huan e mësipërm e kam shlyer 100%. Burimi i ligjshëm i të ardhurave të huadhënësit dhe gjendja e shlyerjes së tij vërtetohen me: (i) deklaratë e huadhënësit V.L (bashkëshorti i hallës), i cili, deklaron dhënien e huas në adresën time dhe shlyerjen e huas nga ana ime. Dokumenti origjinal, në vitin 2016 është dorëzuar nga ana ime në ILDKPKI; (ii) kontratë e shitjes së shtëpisë së dytë në pronësi të huadhënësit me nr.***, datë 27.06.2008; (iii) kontratë e blerjes së shtëpisë në të cilën jeton, në Tiranë me nr.***, datë 12.02.2001”.*

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 6.12.2021, për të provuar burimin e krijimit të të ardhurave të huadhënësit, subjekti depozitoi:

¹⁵Shkresë nr. *** prot., datë 14.5.2020.

¹⁶Me pyetësorin nr. 6, datë 22.2.2022.

¹⁷(i) shkresë e ISSh-së (Drejtorja e Arkivit Qendror), për të ardhurat dhe kontributet e shtetasit B.B (babai i subjektit), për periudhat tetor 1993 - shtator 2000 dhe janar 2001 - dhjetor 2004; (ii) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* me punëdhënës Ministria e Mbrojtjes, për shtetasen V.B (nëna e subjektit), për periudhat qershor 1993 – tetor 1993, shtator 1995 – shtator 2000 dhe janar 2003 - gusht 2003, ku konfirmohet se ka përfutur pagesë transferte si bashkëshorte e ushtarakut, z. B.B; (iii) shkresë e ISSh-së “vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* me punëdhënës Reparti Ushtarak ***”, për të ardhurat dhe kontributet e shtetases V.B, për periudhën 1.9.2003 – 31.5.2007; (iv) shkresë nga Ministria e Mbrojtjes, e vitit 1999, ku shtetasja V.B, ka përfutur një shtesë mbi pagë si bashkëshorte e ushtarakut.

- i) ekstraktin historik të regjistrit tregtar për *person fizik*“****”, me NIPT ***, me datë regjistrimi më 25.3.2004, me objekt aktiviteti “tregti të konfeksioneve me pakicë”;
- ii) kontratë shitje me akt noterial tëdatës 27.6.2008, sipas sëcilës nga ana e shtetasve V.L, B.L dhe E.L, është shitur pasuria e paluajtshme (truall me sip. 300 m² + ndërtesë me sip. 100 m²), në fshatin ***, Gjirokastër, në vlerën 3.496.600 lekë. Duke qenë se sipas kontratës, shtetasi V.L ishte pronar i 1/3 pjesë të pasurisë së shitur, si burim përdhënien e huas është konsideruar 1/3 e kësaj shume, pra, vlera 1.165.533 lekë;
- iii) gjithashtu, subjekti ka paraqitur dhe kontratë shitje noteriale tëdatës 12.2.2001, me tëcilën konfirmohet blerja e pasurisë apartament në vitin 2001, nga ana e shtetasit V.L, në Tiranë.

17.5. Pas kryerjes se disa veprimeve verifikuese në lidhje me huadhënësin, rezultoi se shtetasi V.L figuron i regjistruar¹⁸ si person fizik në datën 1.1.2004, me emrin “****”, me NIPT***, me administrator z. V.L. Nga dokumentacioni i dërguar nga DPT-ja¹⁹ mbi fitimin e realizuar për çdo vit, janë vënë në dispozicion tëdhëna në lidhje me të ardhura *neto* tëkëtij aktiviteti për periudhën 2005 – 2012 dhe, konkretisht,për vitin 2008, vërtetohetnjë fitim *neto* prej 1.000.0000 lekësh. Referuar kësaj të ardhure, si dhe kontratës së shitjes së pasurisë më 27.6.2008, sipas së cilës shtetasi V.L ka përfituar shumën 1.165.533 lekë, duke pasur në konsideratë dhe shpenzimet e jetesëspër një person nëvlerën 136.620 lekë (ndërkohe nuk ështëvërtetuar investim i tij në vitin 2008), nëpërfundim të hetimit administrativ, Komisioni çmoi se shtetasi V.L ka pasur mjaftueshëm të ardhura për t’i dhënë subjektit shumën 800.000 lekësh në fund të vitit 2008, deklaruar si burim për blerjen e mjetit objekt verifikimi.

18. Bazuar nëpërlllogaritjen e të ardhurave *neto*të përfituara nga prindërit e subjektit sipas legjislacionit të kohës, si dhe duke konsideruar të ardhur të ligjshme huan në vlerën prej 800.000 lekësh, marrë nga shtetasi V.L, bazuar në tëdhënat që dispononte, Komisioni kreu analizën financiare të subjektit së bashku me familjen prindërorë, gjithësej5 anëtarë, për periudhën 1993 – 12.2.2009, kur është paguar në total vlera e blerjes dhe zhdoganimin e tij, nga ku rezultoi se mundësia për kursim ishte në vlerën 1,627,051lekë, pasqyruar nëtabelën vijuese:

Nr.	Përshkrimi	Periudha 1993 – 12.2.2009
1	Të ardhura	14,706,753
	Të ardhura babai	9,178,355
	Të ardhura nëna	1,685,631
	Të ardhura subjekti	1,240,650
	Hua nga V.L (prindërit) ²⁰	1,500,000
	Të ardhura nga interesat	302,117
	Hua nga V.L (subjekti)	800,000
2	Shpenzime	6,076,545
	Shpenzime jetese	6,076,545
3	Pasuri	7,003,157
	Automjet babai	785,318

¹⁸Shkresë nr. *** prot., datë 7.12.202 nga QKB-ja.

¹⁹Me shkresën *** prot., datë 9.12.2021, në dosjen e Komisionit.

²⁰Shihni kontratën e huas nr. ***, datë 13.11.2007, bashkëlidhur shkresës nr. *** prot., datë 14.5.2020, lëshuar nga “Raiffeisen Bank”.

	Automjet subjekti + zhdoganimi	1,917,059
	Apartament prindërit	860,915
	Banka	3,439,866
	Mundësia për kursim	1,627,051

Barra e provës dërguar subjektit

19. Në përfundim të hetimit administrativ, pavarësisht se pasuria objekt verifikimi rrjedh nga burime krijimi përpara emërimit të subjektit në detyrë, nga Komisioni u evidentuan konstatimet, dukej se: (i) subjekti kishte kryer deklarim të pasaktë, pasi nuk kishte deklaruar detyrimin doganor të paguar për automjetin në vlerën 478.502 lekë, as në deklaratën *Vetting* dhe as në atë periodike të vitit 2009; (ii) subjekti kishte kryer deklarim të pasaktë lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, kur deklaronte kursimet gjatë viteve të studimeve në Shkollën e Magjistraturës, pasi depozita në shumën 5.000 USD ishte çelur përpara se subjekti të fillonte këtë shkollë dhe, për pasojë, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, iu kalua subjektit barrë e provës për të paraqitur sqarime dhe dokumente në lidhje këto konstatime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

20. Sa i takon mosdeklarimit të detyrimit doganor në vlerën 478.502 lekë, në parashtrimet e saj, subjekti ka deklaruar se kjo ka ndodhur pasi në DPV-në për vitin 2009, kur është deklaruar automjeti, kërkohej deklarimi i shpenzimeve në shumën mbi 500.000 lekë, ndërkohë që shpenzimi për zhdoganimin e mjetit ka qenë më pak se kjo vlerë. Gjithashtu, subjekti ka sjellë nëvëmendje se zhdoganimi është bërë me tënjëjtat burime me të cilat është blerë automjeti në vlerën 11.300 euro, konkretisht: (i) 800.000 lekë hua nga z. V.L; (ii) të ardhura nga kursimet nga paga; si dhe (iii) depozitat bankare në shumat 5.000 USD dhe 300.000 lekë tërhequr përkatësisht në “Intesa Sanpaolo Bank” dhe në “ProCredit Bank”.

Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, pavarësisht se vlera e zhdoganimit ka qenë pjesëpërbërëse e vlerës së mjetit, të cilën subjekti duhet ta deklaronte në rubrikën përkatëse të DPV-së për vitin 2009, Komisioni vlerësoi të konsiderojë të arsyeshëm pretendimin e subjektit se mosdeklarimi ka qenë për shkak të faktit se ky shpenzim nuk e kalonte vlerën 500.000 lekë.

21. Sa i përket konstatimit, në lidhje me deklarim të pasaktë të burimit të krijimit të kësaj pasurie, pasi si burim janë deklaruar kursimet gjatë viteve të studimeve në Shkollën e Magjistraturës, ndërkohë që depozita në shumën 5.000 USD në “Intesa Sanpaolo Bank” është çelur përpara se subjekti të fillonte Shkollën e Magjistraturës, subjekti në parashtrime i është referuar faktit që deri në vitin 2012 ekonomia ka qenë e përbashkët me familjen e origjinës dhe se prej fillimit të Shkollës së Magjistraturës kishte filluar të gjeneronte të ardhura nga bursa që merrte të cilat i dorëzonte në familje. Sipas saj, llogaria në bankë në emrin e subjektit ishte krijuar me kursimet e prindërve në vitin 2006, periudhë kur babai kishte shkuar për një trajnim në SHBA, me qëllim për ta ndihmuar babanë financiarisht në rast nevojë të mundshme. Sipas subjektit, duke qenë se dorëzonte në familje një shumë të konsiderueshme nga bursa që merrte në Shkollën e Magjistraturës, atëherë shuma e depozituar në këto llogari në momentin e deklarimit të parë duhet konsideruar si kursim nga të ardhurat nga bursa. Subjekti në mbështetje të pretendimeve të saj ka depozituar disa dokumente shkresore²¹.

²¹(i) kopje të urdhrin nr. ***, datë 18.4.2006, “Për dërgim me studime jashtë shtetit”; (ii) kontratë nr. ***prot., datë 6.6.2006, “Për arsimim dhe kualifikim brenda dhe jashtë vendit të ushtarakëve aktivë”, për periudhën kohore 14.6.2006-9.12.2006.

21.1. Në analizë të parashtrimeve vërehet se subjekti i referohet faktit që të ardhurat nga bursa në Shkollën e Magjistraturës, të cilat kanë filluar nga viti 2006 deri në vitin 2008 në total prej 981.375 lekësh, i ka depozituar në llogarinë e çelur nëdatën 27.12.2006 në “ProCredit Bank” me depozitim e shumës 120.000 lekë, shumë të cilën ka deklaruar se e ka përdorur për blerjen e automjetit, ndonësetërheqja e shumës 300.000 lekë është kryer më vonë nga blerja e mjetit. Po kështu, edhe përdepozitën nëvlerën 5.000 euro çelur në datën 13.7.2006 në “Intesa Sanpaolo Bank” me të ardhura tëprindërve (para se subjekti të fillonte Shkollën e Magjistraturës), e cila ështëtërhequr pas blerjes dhe zhdoganimit të mjetit, subjekti i referohet të ardhurave nga Shkolla e Magjistraturës, me të cilat i ka kthyer prindërve shumën 5.000 euro. Pra, subjekti mban qëndrimin se në momentin e blerjes dhe zhdoganimit të mjetit kur akoma nuk ishin tërhequr nga depozitat shumat 300.000 lekë dhe 5.000 euro, si burim kanëshërbyer të ardhura të ligjshme tëvërtetuara tëprindërve të saj, të cilat ia ka kthyer prindërve. Por, përkundër sa pretendon subjekti, këto të ardhura tëprindërve nuk rezultojnë t’i ketë deklaruar si burim për blerjen e mjetit nëdeklaratën *Vetting*, në të cilën ka deklaruar shprehimisht se: “Për blerjen e mjetit janëpërdorur kursime të miat gjatë viteve të studimeve në Shkollën e Magjistraturës, konkretisht shuma prej 301.000 lekë dhe 5.000 USD, të depozituara në bankë”.

21.2. Nëpërfundim të procesit, konkludohet se subjekti ka deklaruar nëmënyrë të pasaktë nëdeklaratën *Vetting* burimin e krijimit tëautomjetit objekt verifikimi me kursimet të saj gjatë viteve të studimeve në Shkollën e Magjistraturës, konkretisht të shumave 301.000 lekë dhe 5.000 USD, të depozituara në bankë, pasidepozita në shumën 5.000 USD ishte çelur përpara se subjekti të fillonte Shkollën e Magjistraturës. Ndërkohe, është fakt se të dyja shumat e deklaruar si burim për blerjen e mjetit objekt verifikimi, subjekti nuk i ka pasur në momentin e blerjes dhe zhdoganimit të mjetit, fakt për të cilin ka paraqitur shpjegimet e saj gjatë procesit tërivlerësimit. Duke marrë tëmirëqena pretendimet e subjektit se: (i) shumën 5.000 euro ia ka kthyer prindërve me të ardhura tëShkollës së Magjistraturës;si dhe (ii) pretendimin se në momentin e blerjes dhe zhdoganimit të mjetit kanëshërbyer të ardhura tëprindërve (plus huaja në shumën 800.000 lekë marrë nga z. V.L), këtopasaktësi në vetvete mund të mos kenë një peshë specifike tëposaçme, sidomos në kushtet kur prindërit e saj kanë pasur mjaftueshëm të ardhura si para vitit 2006 (periudhë kur subjekti nuk ka qenë në detyrë), ashtu edhe në momentin e blerjes dhe zhdoganimit të mjetit. Por, në procesin e vlerësimitpërfundimtar tëçështjes, pasaktësitëjanë marrënkonsideratënë procesin e vendimarrjes nga ana e Komisionit duke u vlerësuar në raport me disa rrethana të tjera të evidentuara gjatë hetimit administrativ si vijojnë:

i) deklarimin e pasaktë qysh në DPV-nëpër vitin 2009, kur si burim për blerjen e mjetit janë deklaruar dy depozita të cilat janëtërhequr pas blerjes dhe zhdoganimit të mjetit, pa dhënëasnjë sqarim në lidhje me burimin real të të ardhurave që kanëshërbyer në momentin e blerjes së mjetit dhe zhdoganimit të tij;

ii) edhe nëdeklaratën *Vetting*, në të cilën subjekti ka pasur tëgjithëmundësinë dhe detyrimin ligjor për tëplotësuar një deklaratë tëre e tëdetajuar duke dhënë deklarime të sakta në lidhje me burimin e krijimit tëpasurisë, subjekti mungon tëketë kryer deklarime në lidhje me të ardhura tëprindërve të saj, të cilat sipas subjektit kanëshërbyer si burim faktik në momentin e blerjes dhe zhdoganimit tëautomjetit;

iii) faktit që nëmënyrë tëpërsëritur subjekti deklaroi se si burim për blerjen e pasurive gjatëperiudhës që ka qenë në detyrë, kanëshërbyer vlera monetare të cilat nuk i ka pasur nëmomentin e blerjes së pasurive (trajtuar hollësisht në vijim), për të cilat, po nëmënyrë tëpërsëritur, gjatë hetimit administrativ ka pretenduar se i ka marrë në formë huaje a dhurimesh nga persona të tretë.

22. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Apartament me sipërfaqe 91.09 m², i ndodhur në ***, apartamenti ku aktualisht banoj, i blerë në shumën 48.000 euro me anë të kontratës së

shitjes nr. ***, datë 28.1.2016, e regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nr.pasurie ***, në bashkëpronësi me bashkëshortin G.J.N. Për blerjen e këtij apartamenti nga ana ime janë përdorur 1.000.000 (një milion) lekë dhuratë nga gjyshërit e mi Z.B dhe H.B me anë të kontratës së dhurimit nr.***, datë 25.11.2011, shumë e tërhequr nga llogaria e hapur prej tyre në datën 19.1.2006 pranë Bankës së Shqipërisë, shumën 1.000.000 (një milion) lekë dhuratë nga prindërit e mi B.B e V.B, shumë kjo e tërhequr nga llogaria në emër të nënës sime V.B, llogari e hapur më 13.7.2006, në 'ProCredit Bank', shumën 1.000.000 (një milion) lekë hua nga motra ime E.B, shumë e tërhequr nga llogaria e saj pranë Union Bank, shumë ende e pashlyer nga ana ime. Diferenca prej 400.000 (katërqind mijë) lekë kursime nga paga ime si prokurore. Pjesa takuese: 50%".Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente shkresore²².

23.Bashkëshorti i subjektit G.J.N, lidhur me këtë pasuri, ka deklaruar:“Apartament me sipërfaqe 91.09 m², i ndodhur në “***”, apartamenti ku aktualisht banoj, i blerë në shumën 48.000 euro me anë të kontratës së shitjes nr. ***, datë 28.1.2016, e regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë me nr.pasurie ***, në bashkëpronësi me bashkëshorten Eriselda Bala. Për blerjen e apartamentit nga ana ime janë përdorur këto burime: dhuratë nga prindërit e mi B dhe SH.N 6.600 euro dhe 1.100.000 lekë të tërhequra nga depozitat e tyre bankare nga kursimet e tyre në vite të depozituara pranë 'Raiffeisen Bank'. Shuma 4.000 USD, tërhequr nga llogaria ime personale nr.***, në 'Raiffeisen Bank' dhe shumë 500.000 lekë gjendje cash nga kursimet nga paga/dieta/shpërblime të kursyera në vite nga paga si oficer i policisë gjyqësore prej vitit 2002 e në vijim. Pjesa takuese: 50%”.

24. ILDKPKI-ja,në lidhje me këtë pasuri, ka konstatuar se subjekti: “Nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me mundësinë financiare të shtetasve: (i) shtetasit Z.B dhe H.B (gjyshërit e subjektit) për shumën 1.000.000 lekë bërë dhuratë subjektit deklarues; (ii) shtetasit B.B e V.B (prindërit e subjektit) për shumën 1.000.000 lekë bërë dhuratë subjektit deklarues; (iii) shtetasja E.B (motra e subjektit) për shumën 1.000.000 lekë dhënë hua subjektit deklarues; (iv) shtetasit B.N e SH.N (prindërit e bashkëshortit) për shumën 6.600 euro dhe 1.100.000 lekë, bërë dhuratë për blerjen e apartamentit. Deklarim i pasaktë lidhur me vlerën e shlyerjes së apartamentit të banimit me sip. 91.9 m², pasi deklaruar shlyer vlera në vitin 2012 në shumën 47.000 euro dhe në vitin 2015 në shumën 1.000 euro, ndërkohë sipas DPPP-së në vitin 2012 është bërë shlyerja totale e shumës 48.000 euro”.

Hetimi i Komisionit përkëtë pasuri

25. Në lidhje me mënyrën e përfitimit tëpronësisë, deklaramet e subjektit dhe statusit aktual të saj, gjatë hetimit administrativ rezultoi se në rend kronologjik janë kryer veprimet dhe deklaramet si vijojnë:

- Me kontratë sipërmarrjenr. ***, datë 12.5.2012²³, pala porositëse Eriselda Bala dhe bashkëshortiG.J.N kanë porositur pranëshoqërisë“****” sh.p.k, ndërtimin e një apartamenti, nëçmimin e shitjes 48.000 euro.

- NëDPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar: “Lidhur kontratë sipërmarrje për apartament në vlerën 48.000 euro, paguar deri tani 47.000 euro, në bashkëpronësi me G.J.N. Pjesa takuese: 50%”.

²²Aneks nr. 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së.

²³Depozituar nga subjekti në pyetësorin nr. 1, datë 9.1.2020, nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 5.11.2020, si dhe nga shoqëria “****” sh.p.k., datë 20.12.2021.

- Në DPV-në e vitit 2014, bashkëshorti i subjektit (në atë kohë në cilësinë e bashkëjetuesit të saj), ka deklaruar: “Kontratë sipërmarrje nr.***, datë 12.5.2012, për porositjen e një apartamenti me sipërfaqe 91.09 m², në ‘***, me vlerë të përgjithshme 48.000 euro. Pjesa takuese: 50%”.

- Me kontratën e shitjes nr. ***, datë 28.1.2015, pala shitëse shoqëria “****” sh.p.k. i shet palës blerëse Eriselda Bala dhe GJ.N, pasurinë nr.***.

-Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: “Apartamenti në bashkëpronësi me bashkëshortin/bashkëjetuesin GJ.N me kontratën e sipërmarrjes nr.***, datë 12.5.2012, i deklaruar dhe në deklarimet e mëparshme, është paguar kësti i fundit prej 1.000 euro dhe është lidhur kontrata e shitjes. Bashkëlidhur kopje e certifikatës së pronësisë”.

- Në DPV-në e vitit 2015, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar: “Pakësuar shuma prej 300.000 lekë gjendje cash në shtëpi. Janë përdorur për pagesën e këstit prej 1.000 euro për blerjen e shtëpisë dhe për procedurat e hipotekimit”.

- ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tiranë Veri²⁴ ka konfirmuar regjistrimin e pasurisë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit GJ.N. Ndërkohë, UKT-ja²⁵ dhe FSHU-ja²⁶ kanë konfirmuar kontratat përkatëse për furnizim me energji elektrike dhe ujë të pasurisë.

Bazuar në sa më sipër, nuk u konstatuan problematika lidhur me fitimin e pronësisë.

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

26.Në deklaratën Vettingsubjekti rivlerësimit ka deklaruar se si burim krijimi për pjesën e saj takuese për këtë pasuri kanë shërbyer: (i) shuma 1.000.000 lekë dhuratë nga gjyshërit Z.B dhe H.B, me anë të kontratës së dhurimit nr.***, datë 25.11.2011, shumë e tërhequr nga llogaria e hapur prej tyre më 19.1.2006, pranë Bankës së Shqipërisë; (ii) shuma 1.000.000 lekë dhuratë nga prindërit B.B dhe V.B, shumë kjo e tërhequr nga llogaria në emër të nënës, llogari e hapur më 13.7.2006, pranë “ProCredit Bank”; (iii) shuma 1.000.000 lekë hua nga motra E.B, shumë e tërhequr nga llogaria e saj në “Union Bank”;si dhe (iv) shuma 400.000 lekë kursime nga paga si prokurore.

27.Në deklaratën Vetting bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se burim krijimi për pjesën e tij takuese për këtë pasuri kanë shërbyer: (i) shumat 6.600 euro dhe 1.100.000 lekë dhuratë nga prindërit e tij, B.N dhe SH.N, të tërhequra nga depozitat e tyre bankare nga kursimet e tyre në vite të depozituara pranë “Raiffeisen Bank”; (ii) shuma 4.000 USD tërhequr nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank”; si dhe (iii) shumë 500.000 lekë gjendje cash, nga kursimet nga paga/dieta/shpërblime të kursyera ndër vite nga paga si oficer i policisë gjyqësore prej vitit 2002 e në vijim.

Analizë specifike e secilit prej burimeve të deklaruara

28. Në lidhje me burimin: 1.000.000 lekë të dhuruar nga gjyshërit Z.B dhe H.B, rezultoi se:

- Subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë dhurim në DPV-në e vitit 2011, me përshkrimin “dhuratë nga gjyshërit e mi me kontratën e dhurimit nr.***, datë 25.11.2011. Vlera: 1.000.000 lekë”.

- Subjekti i rivlerësimit ka depozituar pranë “Credins Bank”²⁷, shumën 1.200.000 lekë, në datën 19.12.2011. Kjo shumë është tërhequr nga subjekti në datën 22.6.2012, në vlerën

²⁴Shkresë nr. *** prot., datë 8.6.2020.

²⁵Me shkresën nr. K-*** prot., datë 18.5.2020.

²⁶Me shkresën nr. ***, datë 14.5.2020, në dosjen e Komisionit.

²⁷Shkresë nr. *** prot., datë 13.8.2020.

1.438.712,40 lekë²⁸, përpara likuidimit të këstit të dytë të apartamentit, pretenduar nga subjektimi 23.7.2012.

- Nëpërgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar dhurimin e shumës 1.000.000 lekë nga gjyshërit me rastin e fejesës së saj me burim të ardhura nga biznesi dhe ekonomia ndihmëse e tyre, si pronarë të dyqanit të shitblerjes, të cilët e kanë blerë në vitin 1993. Gjithashtu, kanë pasur nga 40-60 koshere bletësh dhe kanë mbajtur gjedhë (lopë). Aktivitetin e bletarisë e kryejnë edhe sot.

- Nëpërgjigje të pyetësorit nr.2, subjekti ka dhënë deklarime me të detajuara për burimet e të ardhurave të gjyshërve duke deklaruar se ... gjyshërit e mi kanë jetuar gjithë jetën në fshatin *** të Rrethit Gjirokastrë. Gjyshja ime H.B, ka punuar shitëse në dyqanin e fshatit dhe në vitin 1994 me anë të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 14.1.1994, ka privatizuar, duke blerë objektin, njësi shitje ushqimore (dyqan i përzier²⁹), ndërkohë që prej vitit 1993 ka vijuar të ushtrojë aktivitetin tregtar me lejen Nr.***. Duke jetuar në fshat, prej gjyshërve të mi janë shfrytëzuar dhe të ardhurat nga bujqësia, blegtoria, si dhe bletërritja. Fakt ky i vërtetuar dhe nga Drejtoria e Bujqësisë Vlorë, me vërtetimin nr. *** prot., datë 17.1.2020, me anë të të cilit vërtetohet fakti se fermeri Z.R.B prej vitit 2011 është i regjistruar në sistemin “****” me kodin e fermës *** si bletërritës me 51 koshere. Me anë të këtyre të ardhurave të siguruara nga bujqësia, blegtoria, bletërritja, si dhe aktiviteti tregtar, gjyshërit e mi kanë pasur të ardhura të kënaqshme në vite çka provohet dhe nga vërtetimi i Bankës së Shqipërisë, Dega ***, datë 25.1.2016, me anë të të cilit provohet fakti se H.B ka hapur llogari pranë kësaj banke që prej datës 19.1.2006 e në vazhdim. Duke qenë se ata kanë jetuar në fshat dhe unë kam qenë mbesa e tyre e parë dhe me gjyshërit e mi gjithmonë kam pasur një marrëdhënie të veçantë, gjatë fëmijërisë sime një pjesë të vitit e kaloja tek ata dhe ky dhurim me rastin e fejesës sime është bërë në kuadër të ndihmës për të më qëndruar pranë njësoj si prindërit e mi”. Në mbështetje të deklarimeve të saj, subjekti depozitoi edhe dokumentacion justifikues³⁰.

28.1. Pavarësisht dokumentacionit të depozituar nga subjekti, Komisioni kreu hetime të mëtejshme mbi të ardhurat e përfituara nga gjyshërit e subjektit, shtetasit Z dhe H.B, nga ku rezultoi se:

- ISSH-ja³¹ ka informuar se shtetasi Z.B, nga muaji mars i vitit 1992 ka përfutur pension pleqërie, ndërsa shtetasja H.B nga tetori i vitit 1994, përfiton pension pleqërie.

- “Raiffeisen Bank”³² ka konfirmuar që shtetasit Z dhe H.B, kanë pasur llogari dyemërore dhe figurojnë më depozitë në vlerën 1.439.000 lekë që prej vitit 2004. Kjo shumë së bashku me interesat e përfituara në vitin 2006 është investuar në Bono Thesari, pranë Bankën së Shqipërisë.

²⁸Shumë e krijuar si rezultat i dhurimit 1.000.000 lekë nga gjyshërit, kursimet e subjektit dhe interesat e përfituara.

²⁹Referuar termit të përdorur në kontratën e shitjes.

³⁰(i) kontratë dhurimi nr. ***, datë 25.11.2011; (ii) kartelë e klientit H.B pranë Bankës së Shqipërisë, që vërteton krijimin e shumës kohë më parë dhe të tërheqjes së shumës 1.000.000 lekë nga H.B. Sipas kësaj kartele në datën 4.2.2011 është tërhequr shuma 1.650.917 lekë dhe nga kjo shuma prej 1.000.000 lekësh i është dhuruar subjektit të rivlerësimit; (iii) leje e ushtrimit të aktivitetit privat tregti mallrash të ndryshëm në njësi, me datë lëshimi më 2.2.1993, në emër të H.B; (iv) vërtetim, datë 25.1.2016, nga Banka e Shqipërisë, dega ***, që konfirmon faktin se shtetasja H.B (gjyshja e subjektit) ka hapur llogari pranë Bankës së Shqipërisë ***, bono thesari të tregtueshme dhe të likuidueshme, të emetuara nga qeveria e Republikës së Shqipërisë që prej datës 19.1.2006 e në vazhdimësi.;(v)kontratë shitblerje nr. ***, datë 14.1.1994, për blerjen e njësisë së shitjes ushqimore (dyqan i përzier) me sip. 99 m² nga *** ndaj *** Gjirokastrë në vlerën 72.719 lekë për ndërtesën dhe 16.790 lekë për truallin mbi të cilën është ndërtuar ndërtesa.; (vi) vërtetim nr.*** prot., datë 17.1.2020, nga Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave Drejtoria e Bujqësisë Vlorë, ku vërtetohet fakti se fermeri Z.B nga Njësia Administrative ***, fshati ***, Gjirokastrë, prej vitit 2011 është regjistruar në *database* të sistemit “****” me kod fermeri si bletërritës me 51 koshere; (vii) akti i marrjes së tokës në pronësi nr. ***, datë 20.10.1992, në emër të Z.B, ku ka përfutur 6.000 m² tokë arë.

³¹Me shkresën nr. *** prot., datë 2.12.2021.

³²Shkresë nr. *** prot., datë 1.12.2021.

- Banka e Shqipërisë³³ ka informuar se shtetasja H.B, ka llogari *cash*/titujsh për blerjen e bonove të thesarit të shtetit shqiptar dhe se investimi i parë, datonte më 31.1.2006, në vlerën 1.800.000 lekë.

- Meqenëse, sipas deklaramit të subjektit, kursimet e gjyshërve vinin kryesisht nga aktiviteti i tyre si bletërritës, Komisioni mbajti korrespondenca me “****”³⁴, për një informacion më të detajuar në lidhje me fitimin e mundshëm nga ky aktivitet. Kjo e fundit, ka informuar se fitimi *neto* i mundshëm për një koshere për prodhim mjalti është parashikuar në vlerën 22.000 lekë/vit për koshere, ndërsa për prodhim qumësht blete është parashikuar një vlerë relativisht e konsiderueshme prej 128.000 lekë/vit për koshere.

Barra e provës kaluar subjektit të rivlerësimit

28.2. Nëpërfundim të hetimit administrativ, për këtë burim krijimi edhe pse gjatë hetimit administrativ, u evidentua se: (i) kursimet e gjyshërve të subjektit datojnë shumë kohë përpara se subjekti të emërohej në detyrë;(ii) shumta e dhuruar ka qenë e depozituar prej kohësh në bankë prej tyre/gjyshërve; dhe se(iii) po kjo shumë është depozituar nga subjekti në bankë, në analizë të dokumentacionit të administruar, nëpërfundim të këtij hetimi, Komisioni konstatoi: duket se nuk provohej vlera reale e të ardhurave të përfituara nga aktiviteti i gjyshërve, të ardhura këto të përdorura si burim për krijimin e shumës së dhuruar prej tyre, dhe, për pasojë, subjektit iu kalua barrë e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë argumentet në lidhje me konstatimin.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

29. Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e datës 30.3.2022, ka parashtruar si vijon:

29.1. Lidhur me të ardhurat e gjyshërve, ka deklaruar se ata edhe pse pensioniste kanë vijuar të punojnë dhe të nxjerrin të ardhura shtesë nga bujqësia, blegtoria dhe bletërritja, duke iu referuar informacionit të Bankës së Shqipërisë, sipas të cilit, ata kanë hapur llogari bankare që më 19.1.2006, si dhe informacionit të “Raiffeisen Bank”, në lidhje me një llogari të hapur që prej vitit 2004 në vlerën 1.439.000 lekë, e cila, më tej, është investuar në bono thesari në vitin 2006 në Bankën e Shqipërisë. Gjithashtu, subjekti thekson se shpenzimet për jetesë të tyre janë minimale duke pasur parasysh edhe faktin se shumicën e produkteve të konsumit të përditshëm ushqimor i prodhonin vetë.

29.2. Lidhur me aktivitetin tregtar ushtruar nga gjyshja e saj, ashtu sikurse edhe gjatë hetimit administrativ, subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara në lidhje me këtë aktivitet të ushtruar që nga viti 1993, duke iu referuar disa shkresave të lëshuara nga organet tatimore të cilat vërtetojnë ushtrimin e aktivitetit dhe duke deklaruar, gjithashtu, se është e pamundur të vërtetohet fakti se sa kanë qenë tatimet e paguara për çdo vit për aktivitetin tregtar me kod fiskal ***.

29.3. Lidhur me të ardhurat nga aktiviteti i bletërritjes ushtruar prej gjyshit, subjekti duke iu referuar përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 dhe disa dokumenteve shkresore administruar nga Komisioni, ka vijuar të këmbëngulë se është vërtetuar fakti që gjyshi i saj është regjistruar me kodin e fermerit shumëherët dhe ka përfituar të ardhura nga aktiviteti i bletërritjes, duke theksuar se: “...është e pamundur që të llogariten të ardhurat e përfituara në mënyrë të numërueshme, por fakti që fitimet e tyre kanë qenë të depozituara në bankë, madje shumë vite përpara se unë të emërohesha në detyrë, duhet të krijojnë bindjen se fitimi i tyre nga ferma ka qenë real dhe i konsiderueshëm”.

29.4. Sa i takon pagesës së kontributeve të gjyshërve si të vetëpunësuar në bujqësi, subjekti duke iu referuar ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e

³³Shkresë nr. ***pro., datë 24.11.2021.

³⁴Shkresë nr.***prot., datë 1.3.2022, dërguar me e-mail.

Shqipërisë”, ku përcaktohet se personat e vetëpunësuar në bujqësi janë të detyruar të paguajnë kontribut për barrë lindje dhe për pensione, si dhe rregullores nr. 2, datë 2.12.2008, “Për kontributet e sigurimeve shoqërore”, ku përcaktohet se plotësojnë kushtet për t’u siguruar të vetëpunësuarit në bujqësi të aftë për punë, që kanë mbushur moshën 16 vjeç deri në moshën për pension, pretendon se sipas këtyre dispozitave, të vetëpunësuarit në bujqësi mbartin detyrimin për derdhjen e kontributeve, duke nisur nga moshja 16 vjeç deri në moshën e daljes në pension, pra, sigurimi shoqëror dhe shëndetësor në bujqësi është i detyrueshëm deri në moshën e daljes në pension. Sipas subjektit: *“Kjo është arsyeja përse nga gjyshi im Z.B nuk janë derdhur sigurime si i vetëpunësuar në bujqësi/blegtori, pasi ndërkohë ai e kishte mbushur moshën për pension vërtetuar me shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2022, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Dega Rajonale ***. Gjithsesi nga dokumentacioni i dorëzuar prej meje provohet fakti se ai ka qenë i regjistruar si fermer me kod ferme ***, dhe provohet fakti se dispononte një fermë me bletë që prej vitit 2000...”*

29.5. Sipas subjektit: *“Gjyshërit e mi kanë siguruar të ardhura shumë të mira nga parku i bletëve. Duke qenë se sipas legjislacionit tatimor të vetëpunësuarit në bujqësi/blegtori (fermerët) nuk kanë detyrim për regjistrimin në organin tatimor, por sipas ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar’(ndryshimet e bëra me ligjin nr. 9848, datë 17.12.2007), aktualisht i shfuqizuar, e vetmja kërkesë e legjislacionit për t’u njohur një subjekt si fermer është të qenit i pajisur me një numër personal, detyrim i cili është përmbushur nga gjyshi im Z.B, pasi ka qenë i pajisur me kodin e fermës *** të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i regjistruar që prej vitit 2000. Po kështu, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar, të ardhurat e realizuara nga shitja e produkteve bujqësore nga të vetëpunësuarit në bujqësi (fermerët) nuk janë parashikuar si të ardhura të tatueshme”*.

29.6. Në përfundim, subjekti parashtron se sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, është në kushtet e pamundësisë objektive për të provuar të ardhurat faktike të gjyshërve të realizuara nga aktiviteti tregtar me nr. leje ***, i gjyshes H.B dhe të ardhurat e siguruara nga shitja e mjaltit, dhe se ajo, nuk mund të mbajë përgjegjësi përkëtë, duke iu referuar edhe vendimit nr. 14/2021, të Kolegjit, sipas të cilit: *“Trupi gjykues vlerësoi që në kuadër të parimit të objektivitetit në gjykim, problematikat në ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit nga organet shtetërore, nuk duhet të rëndojnë mbi subjektin e rivlerësimit për sa kohë nga procesi i rivlerësimit nuk u evidentuan gjetje në drejtim të veprimeve të qëllimshme nga ana e subjektit të rivlerësimit lidhur me sa më sipër”*.

Në mbështetje të pretendimeve të saj në parashtrime, subjekti ka depozituar disa dokumente³⁵.

Vlerësimi i Komisionit

30. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, bazuar në të gjitha provat e administruara gjatë hetimit administrativ, Komisioni e gjeti të bazuar pretendimin e subjektit se gjyshërit kanë pasur të ardhura të ligjshme për të dhuruar shumën 1.000.000 lekë, pasi deri në nëntor të vitit 2011 kur është dhuruar kjo shumë, gjyshi dhe gjyshja kanë marrë vetëm nga pensionet shumën 2.155.944 lekë, vërtetuar me dokumentacionin nga sigurimet shoqërore. Nderkohë që, veçkëtyre të ardhurave, ata kanë siguruar edhe të ardhura nga aktiviteti privat, bujqësordhe blegtoral, përpara se subjekti të fillonte detyrën, për të cilat subjekti ndodhet në kushtet e pamundësisë për shkaqe objektive dhe ligjore për të vërtetuar të ardhura konkrete dhe pagimin

³⁵(i) vërtetim nr.*** prot., datë 24.03.2022 nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale ***; (ii) vërtetim nr. *** prot., datë 24.3.2022, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale ***; (iii) shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.3.2022, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër; (iv) vërtetimin nr. *** prot., datë 17.1.2020, nga Drejtoria e Bujqësisë Vlorë; (v) vërtetim nr. *** prot., datë 11.2.2022, nga Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë; (vi) deklarata nga shtetasit I.RR, D.SH dhe M.L.

e tatimit mbi këto te ardhura. Për rrjedhojë, në përfundim të hetimit administrativ u vlerësua qëgjyshërit e subjektit kanë pasur të ardhura të ligjshme për dhurimin e shumës 1.000.000 lekë, në vitin 2011.

31. Në lidhje me burimin: 1.000.000 lekë të dhuruar nga prindërit, B.B dhe V.B, rezultoi se:

31.1. Subjekti e ka deklaruar këtë dhurim në DPV-në e vitit 2012, në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, me përshkrimin: “1.000.000 lekë dhuratë nga prindërit e mi për blerje apartamenti”.

31.2. Nëpërgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se: “... si burim për krijimin e këtyre të ardhurave kanë shërbyer të ardhurat nga pagat e të dy prindërve të mi të cilët kanë qenë gjatë gjithë kohës në marrëdhënie pune. Babai im B.B ka qenë në marrëdhënie pune prej vitit 1979 dhe nëna ime që prej vitit 1981. Babai im B.B që prej vitit 1993 e në vijim ka qenë në pozicione drejtuese si ushtarak i lartë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Si rrjedhojë e këtyre të ardhurave ata kanë siguruar kursime në vite dhe shumën prej 1.095.000 (një milion e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë e kanë tërhequr me qëllim për të ma dhuruar në formën e mbështetjes prindërore për të filluar bashkëjetesën në atë kohë me të fejuarin tim G.J.N, aktualisht bashkëshorti”.

31.3. Komisioni të ardhurat e prindërve të subjektit i ka analizuar edhe në paragrafin 17.4 të këtij vendimi. Veçkësaj, duke u fokusuar edhe nëperiudhën në të cilën është kryer dhurimi, në një analizë të thjeshtë, vetëm me të ardhurat nga punësimi i prindërve të subjektit përgjatë viteve 2009 – 2011, Komisionit i rezultoi se ata kishin mundësi të kursenin shumën 1.000.000 lekë të cilën ia kanë dhuruar subjektit të rivlerësimit, si dhe për të ndihmuar për blerjen e automjetit në vitin 2009, sipas pretendimeve të saj. Konkretisht, Komisioni ka analizuar të ardhurat nga punësimi i prindërve dhe shpenzimet e jetesës për 4 persona për periudhën 2009-2011 dhe ka rezultuar se mundësia për kursim është në vlerën 2,411,818 lekë, sikurse është pasqyruar në mënyrë të përmblendhur në tabelën vijuese.

	2009 – 2011
Të ardhura nga paga babai	3,170,751
Të ardhura nga paga nëna	969,873
Shpenzime jetese për 4 persona	(1,639,440)
Shpenzime principal + interes	(15,372)
Ndryshim likuiditeti 2011 – 2008	(73,995)
Mundësia për kursim	2,411,818

31.4. Sa i përket momentit të tërheqjes së shumës 1.000.000 lekë nga banka, Komisionit i ka rezultuar se nëna e subjektit, shtetasja V.B, ka tërhequr shumën 1.095.000 lekë, në datën 5.10.2012 nga llogaria e saj (depozitë) në “ProCredit Bank”, pra, pasi është paguar kësti i dytë i pretenduar për blerjen e pasurisë objekt verifikimi (më 23.7.2012). Në lidhje me këtë fakt e pyetur nga Komisioni, subjekti ka deklaruar se për të siguruar shumën 1.000.000 lekë në datën 23.7.2012, prindërit e saj e kanë marrë hua nga shtetasi V.L (bashkëshorti i hallës), duke sqaruar, ndër të tjera, se: “Çmuj me rëndësi t’ju sqaroj se kontributi i prindërve të mi dhe motrës sime E.L për blerjen e apartamentit janë bërë në kohë reale, pra, në muajin korrik kur unë kisha nevojë. Në atë kohë në fillim u vendos nga unë dhe bashkëshorti (atë kohë i fejuari) që t’i kërkonim shoqërisë sipërmarrëse një shtyrje të afatit të kësteve por

prindërit dhe motra, menduan që të na ndihmonin duke kërkuar një ndihmë të përkohshme hallës dhe bashkëshortit të saj. Për këtë kanë huazuar një shumë parash prej shtetasit V.L (bashkëshorti i hallës), deri në maturimin e depozitave të tyre me afat. Me tërheqjen e depozitave të tyre bankare, ato i janë kthyer bashkëshortit të hallës. Kjo hua është marrë jo vetëm për një periudhë shumë të shkurtër kohore, por edhe mbi bazën e marrëdhënieve shumë të mira familjare mes nesh dhe hallës e bashkëshortit të saj”.

31.5. Sa i takon huas së marrë prej shtetasit V.L, nuk ka një akt shkresor që të vërtetojë këtë marrëdhënie, por gjatë hetimit administrativ është konstatuar se subjekti rivlerësimi dhe familja e saj, kanë hyrë në marrëdhënie huamarrje disa herë me këtë shtetas. Konkretisht, prindërit e subjektit i kanë marrë hua³⁶ shumën 1.500.000 lekë në vitin 2007 për blerjen e apartamentit të tyre dhe e kanë kthyer atë në vitin 2011, me anë të kredisë së marrë në “Raiffeisen Bank”. Gjithashtu, ka rezultuar se subjekti i ka marrë hua shumën 800.000 lekë në vitin 2009 për blerjen e automjetit (trajtuar në paragrafin 15 e vijues të vendimit). Veçkëtyre, subjekti gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se dhe motra E.L, i ka marrë një hua shtetasit V.L në shumën 1.000.000 lekë, për t’i dhënë hua subjektit në datën 24.7.2012 (trajtuar në paragrafin 32 të këtij vendimi).

31.6. Sa i takon mundësisë financiare të shtetasit V.L për të dhënë huanprindërve të subjektit në datën 23.7.2012 (data e pretenduar e pagimit të këstit prej 39.000 euro), gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka kryer një analizë financiare me të dhënat që dispononte nga viti 2009 deri më 23.7.2012, pasqyruar në mënyrë të përmblendhur në tabelën mëposhtë, nga ku ka rezultuar se ky shtetas ka pasur mjaftueshëm të ardhura për të siguruar shumën 1.000.000 lekë të dhënë hua prindërve të subjektit, ashtu sikurse edhe për shumën 1.000.000 dhënë hua motrës së subjektit, po në datën 23.7.2012 (trajtuar në paragrafin 32 të këtij vendimi).

	2009 – 23.7.2012
Të ardhura nga aktiviteti privat ³⁷	2,924,027
Kthimi i huas nga familja Bala	1,500,000
Kthimi i huas nga Eriselda Bala	800,000
Shpenzime jetese përnjë person	(492,124)
Dhënie hua për blerjen e apartamentit të Eriselda Bala (prindërve dhe motrës, nga 1.000.000 lekë secilit)	(2,000,000)
Mundësia për kursim	2,731,903

31.7. Në analizë të të gjitha provave dhe rrethanave të sipërcituara, si dhe faktit që gjatë hetimit nuk kanë dalë të dhëna mbi ndonjë kundërshti për këto marrëdhënie të krijuara midis palëve, si marrëdhënie të posaçme familjare, por edhe në kushtet e mospasjes së ndonjë konflikti të mundshëm interesi³⁸ të subjektit dhe bashkëshortit³⁹ të saj me shtetasin V.L,

³⁶Shihni shkresën nr. ***prot., datë 14.5.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

³⁷Të ardhurat e përfituara nga aktiviteti privat për vitin 2012 janë në vlerën 830.000 lekë. Komisioni e ka ndarë në mënyrë të barabartë fitimin për secilin muaj dhe, për rrjedhojë, të ardhurat e përfituara gjatë vitit 2012 deri në korrik të vitit 2012 janë përllogaritur në vlerën 484.167 lekë (830.000 lekë/12 muaj x 7 muaj).

³⁸Shkresë nr. *** prot., datë 19.1.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. *** prot., (P.H.), datë 19.0=1.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; si dhe shkresën nr. *** prot., datë 4.2.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

³⁹Depozituar me pyetësorin nr. 5, datë 3.2.2022: (i) shkresë nr. *** prot., datë 14.2.2022, nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 9.2.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; (iii) shkresë nr. ***

nëpërfundim të hetimit administrativ, Komisioni nuk ka evidentuar problematika në lidhje me shumën 1.000.000 lekë dhuruar nga prindëritë subjektit, të cilët nuk e kanë pasur në datën 23.7.2012, kur pretendohet të jetë paguar kësti në vlerën prej 39.000 euro, por që sipas subjektit për sigurimin e saj në këtë datë kanë marrë një hua të përkohshme (3-4 mujore) prej shtetasit V.L, deri në maturimin e depozitës së tyre.

32. Në lidhje me burimin: 1.000.000 lekë hua nga motra E.B, gjatë hetimit administrativ, rezultoi se:

32.1. Subjekti e ka deklaruar këtë hua në DPV-në e vitit 2012, në rubrikën “detyrime financiare”, me përshkrimin: “*Shumë 1.000.000 lekë hua motrës sime E.B, shumë e përdorur për kontratën e sipërmarrjes*”.

32.2. Në përgjigje të pyetësorit nr.2, subjekti ka deklaruar se: “*Në lidhje me shumën prej 1.000.000 lekësh të dhënë hua prej motrës sime, si burim i të ardhurave të krijuara prej saj ka shërbyer punësimi i saj si inxhinierë telekomunikacioni pranë kompanive të ndryshme që prej vitit 2008 e në vijim. Si rrjedhojë e të ardhurave nga paga ka krijuar depozitë kursimi pranë ‘Union Bank’, bankë me të cilën ka pasur dhe marrëveshje për kontratë llogari kursimi, me anë të mbajtjes së llogarisë me qëllim kursimi, prej nga ka tërhequr shumën 1.000.000 lekë. Aktualisht kjo hua është shlyer prej meje totalisht*”. Subjekti ka depozituar dokumentacion shkresor bashkëlidhur pyetësorit.

32.3. Bazuar në dokumentet e administruara, për periudhën qershor 2010 – dhjetor 2011, të ardhura të motrës së subjektit janë në vlerën 1.642.918 lekë, e cila duket e mjaftueshme për të mbuluar huan e dhënë. Nga analiza e dokumentacionit të administruarështë konstatuar, gjithashtu, se motra e subjektit e merr pagën në “Union Bank”⁴⁰ dhe se kursimet e saj, janë të investuara në depozitë, nga e cila në datën 9.11.2012 ka tërhequr shumën 1.000.000 lekë.

32.4. Siç vërehet, tërheqja e depozitës prej motrës së subjektit E.B daton pas pagesës së këstit të dytë të apartamentit, sipas pretendimeve të subjektit më 23.7.2012. Në lidhje me këtë fakt subjekti ka deklaruar se motra dhe prindërit kanë marrë hua prej shtetasit V.L (bashkëshorti i hallës), për një periudhë shumë të shkurtër, deri në maturimin e depozitës së saj me afat.

32.5. Në kushtet kur nga të dhënat e administruara, duket se shtetasi V.L ka pasur mjaftueshëm të ardhura nga aktiviteti privat dhe jo vetëm (trajtuar më sipër në paragrafin 31.7), nëpërfundim të hetimit administrativ, nga ana e Komisionit nuk janë evidentuar problematika lidhur me të ardhurat që kanë shërbyer për huan në shumën 1.000.000 lekë marrë prej motrës E.B, e cila nuk e ka pasur këtë shumën në datën 23.7.2012, kur është pretenduar të jetë paguar kësti në vlerën 39.000 euro për blerjen e pasurisë objekt verifikimi dhe që, sipas subjektit, motra e saj e ka siguruar këtë shumën nëpërmjet huas së marrë nga shtetasi V.L, të cilën ia ka kthyer me maturimin e depozitës së saj.

33. Në lidhje me burimin: 400.000 lekë kursime nga paga si prokurore, rezultoi se:

33.1. Subjekti rivlerësimi ka depozituar vërtetimet e punësimit që prej fillimit të detyrës dhe aktualisht, duke provuar marrëdhënien e vazhdueshme të punës.

33.2. Komisioni ka verifikuar dhe *statement* bankar për pagat e marra nga subjekti, nga ku ka rezultuar se nga të ardhurat e përfituara është bërë e mundur krijimi i këtyre kursimeve.

Në këto kushte, deri në momentin e përfundimit të hetimit administrativ, Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë lidhur me këtë burim krijimi.

prot., datë 9.2.2022, nga Komisariati i Policisë ***; (iv) shkresë nr. *** prot., datë 11.2.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁴⁰Shkresë nr. ***prot., datë 9.12.2021.

34.Në lidhje me burimin e deklaruar nga bashkëshorti i subjektit GJ.N: 6.600 euro dhe 1.100.000 lekë dhuratë nga prindërit e tij, B.N dhe SH.N, rezultoi se:

34.1. Në deklaratën periodike të vitit 2012, kur është deklaruar për herë të parë pasuria objekt verifikimi dhe pagesat e kryera, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të pjesës takuese të bashkëshortit (bashkëjetuesit në atë kohë). Ndërsa, bashkëshorti i subjektit, nuk e kishte deklaruar burimin e krijimit të pjesës së tij takuese në deklaratën periodike të vitit 2014, deklarimi i parë i tij për shkak të bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit. Edhe në DPV-në për vitin 2015, bashkëshorti i subjektit nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave përpjesën e tij takuese nëçmimin e blerjes së pasurisë, por ka deklaruar vetëm burimin e krijimit të kështit të fundit të pretenduar prej 1.000 euro për shkak tëpakesimit tëgjendjes *cash* prej 300.000 lekësh. Pra, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar për herë të parë këtë burim në deklaratën *Vetting*.

34.2. Nga hetimi i kryer, rezultoi se nëna e bashkëshortit të subjektit, shtetasja SH.N, në datën 31.8.2006 ka çelur në “Raiffeisen Bank”⁴¹, një depozitë në monedhën lekë nëvlerën 500.000 lekë dhe një depozitë në euro në vlerën 3.000 euro. Ndërsa në datën 31.3.2008, ka shtuar depozitat përkatësisht në vlerat 400.000 lekë dhe 3.000 euro. Investimi në total i shumave 900.000 lekë dhe 6.000 euro plus interesat⁴²të përfituara në vite, kanë mbuluar dhurimin e kryer ndaj bashkëshortit të subjektit. Gjithashtu, ka rezultuar se nëna e bashkëshortit i ka tërhequr këto shuma në datën 15.6.2012, përpara likuidimit të kështit të pretenduar në datën 23.7.2012.

34.3. Në përgjigje te pyetësorit nr. 4, në lidhje me burimin e të ardhurave të prindërve të bashkëshortit, subjekti ka deklaruar se: *“Prindërit e bashkëshortit tim GJ.N, jetojnë në fshatin ***, të rrethit Delvinë. Nëna e bashkëshortit tim shtetasja SH.N që prej vitit 1983 dhe aktualisht është e punësuar në fshat si infermiere/mami për fshatin *** dhe fshatin ***, ndërkohë që babai i bashkëshortit shtetasi B.N që prej vitit 1994 është regjistruar si i vetëpunësuar në bujqësi me numër të sigurimeve shoqërore ***, duke paguar sigurime shoqërore për çdo vit. Kryesisht ai e ka fokusuar aktivitetin e tij në mbarëshkrimin e gjedhëve kryesisht dhen dhe dhi, duke pasur një fermë që çdo vit ka pasur në përbërje 100 – 150 krerë. Duke jetuar në fshat, dhe duke patur të ardhura si nga paga e nënës së bashkëshortit ashtu dhe të ardhura nga bujqësia dhe blegtoaria, të ardhurat e tyre kanë qenë të kënaqshme, si dhe duhet theksuar fakti se jetesa në fshat ka kosto minimale duke qenë se shumicën e produkteve ushqimore si perime, mish e bulmet i prodhojnë vetë.Nga ana ime i është kërkuar Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë, dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorisë Rajonale Vlorë, përlllogaritja mesatare e të ardhurave të mundshme të siguruara për një vit nga ferma, të cilët me anë të shkresës nr. *** prot., datë 11.2.2022, provojnë faktin se mesatarisht për një fermë të përbërë nga 80 krerë dhen/dhi, fitimi vjetor neto është 990,000 (nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë.Është për t’u theksuar fakti se nga dokumentacioni i dorëzuar prej meje provohet fakti se nga ana e babait të bashkëshortit tim, shtetasi B.N është poseduar gjithmonë një fermë me rreth 150 krerë bagëti”*. Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka depozituar dokumentacion për të provuar të ardhurat e përfituara në vite⁴³.

⁴¹Shkresë nr. ***prot., datë 14.5.2020.

⁴²Përkatësisht vlerat 217.149 lekë dhe 630 euro.

⁴³(i) kopje të librezës së punës së shtetasës SH.N (nëna e bashkëshortit) e hapur prej vitit 1983; (ii) kopje të librezës së kontributeve për Sigurimin Shoqëror dhe Shëndetësor të shtetasit B.N për periudhën 1.1.1994 – 31.8.2006; (iii) vërtetim për bazën e vlerësuar nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Delvinë, datë 11.2.2022, për të ardhurat e siguruara për periudhën 1993 – 2006 nga shtetasja SH.N; (iv) aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. *** akti, datë 15.6.1999, me anë të të cilës vërtetohet fakti se shtetasi B.N (babai i bashkëshortit) ka marrë një sipërfaqe prej 31.000 m² tokë arë në total; (v) vërtetim për të vetëpunësuarit në bujqësi, i lëshuar nga DRSSH-js Vlorë, datë 22.12.2020, me anë të të cilës vërtetohet fakti se shtetasi B.N ka qenë i vetëpunësuar në bujqësi dhe ka paguar kontribute për periudhën 1.1.1994 – 31.12.2005; (vi) kontratë (nuk ka numër) e dhënies në përdorim të kullotave dimërore në harkun kohor 1999-2000, së bashku me mandatpagesën për qiranë e kullotave; (vii) kontratë nr. *** e dhënies në përdorim të kullotave pyjore, datë 4.7.2000, së

34.4. Në analizim të dokumentacionit të depozituar, Komisionit i rezultoi se nëna e bashkëshortit ka qenë në marrëdhënie pune në institucion shtetëror, që prej vitit 1983. Gjithashtu, nga dokumentacioni shkresor provohen edhe të ardhurat e saj prej vitit 1993 – 2006, në shumën 1.528.175 lekë. Ndërsa babai i bashkëshortit figuron i vetëpunuar në bujqësi që prej vitit 1994 – 2005 dhe zotëron fermë blegtorale me 150 krerë të imta. Gjithashtu, rezultoi se babai i bashkëshortit përfiton të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit si fermë blegtorale, por duket se nuk provohet me dokumentacion fitimi i realizuar nga ky aktivitet.

Barra e provës kaluar subjektit të rivlerësimit

35. Në lidhje me burimin objekt verifikimi, edhe pse u evidentua se këto depozita datojnë që në vitin 2006, pra, shumë kohë përpara se subjekti të emërohej në detyrë, apo edhe përpara njohjes së saj me bashkëshortin, në analizë të dokumentacionit të administruar lidhur me të ardhurat nga blegtoria, Komisioni konstatoi: duket se nuk provohet vlera reale e fitimit të realizuar nga aktiviteti i blegtorisë nga babai i bashkëshortit të subjektit, të ardhura këto të përdorura si burim për krijimin e shumës së dhuruar, dhe, për pasojë, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barrë e provës për të dhënë argumentet në lidhje me konstatimin.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

36. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e saj të datës 30.3.2022, ka pretenduar në mënyrë të përmblendhur se:

36.1. Fillimisht, subjekti ka pretenduar se prindërit e bashkëshortit nuk e gëzojnë statusin e personit të lidhur, pasi: (i) të ardhurat nga ana e tyre janë realizuar shumë kohë përpara fillimit të bashkëjetesës tonë dhe shumë kohë përpara emërimit tim si prokurore; (ii) bashkëjetesa me shtetasin GJ.N ka filluar në muajin gusht të vitit 2012 pas blerjes së apartamentit në pjesë takuese 50% secili; (iii) unë nuk kam përfituar nga kjo dhuratë e tyre në një moment kur pjesët takuese janë qartësisht të ndara midis nesh; (iv) është një pasuri e krijuar përpara fillimit të bashkëjetesës sonë dhe ai (bashkëshorti i ardhshëm) nuk gëzonte në këtë moment ndonjë status relevant për procesin e rivlerësimit për sa kohë marrëdhënia ende nuk kishte filluar dhe palët nuk kishin asnjë lidhje të ndonjë natyre nga ato të parashikuara nga pikat 13 dhe 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

Në funksion të argumenteve të saj, subjekti i është referuar praktikës së Kolegjit më vendimin nr. 15/2021, në paragrafin 23.7 të tij, si dhe qëndrimin të mbajtur nga Komisioni në disa vendime⁴⁴.

36.2. Pavarësisht pretendimit të mësipërm, subjekti ka argumentuar arsyet përse nga Komisioni duhet të konsiderohen të ligjshme kursimet e prindërve të bashkëshortit, duke renditur shkaqet si vijojnë:

- i) kursimet e realizuara prej tyre kanë qenë të depozituara në bankë;
- ii) prindërit e bashkëshortit jetojnë në fshatin ***, Delvinë;

bashku me mandatpagesën për qiranë e kullotave; (viii) kontratë nr. *** e dhënies në përdorim të kullotave pyjore, datë 17.7.2000, së bashku me mandatpagesën për qiranë e kullotave; (ix) vërtetim nr. *** prot., datë 17.1.2020, i lëshuar nga Drejtoria e Bujqësisë Vlorë, ku konfirmohet fakti se fermeri B.XH.N prej vitit 2005 figuron si fermë blegtorale me 150 krerë të imta dhe nga viti 2011 është i regjistruar në *datbasen* e sistemit “****” të ARSHVMB-së Vlorë, me kodin e fermës, me 115 krerë të imta; (x) vërtetim nr. ***, datë 11.2.2022, i lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë, ku vërtetojnë se B.XH.N ushtron aktivitetin si fermer, mbarëstim të leshta me kod fermeri. Vërtetohet se e ushtron aktivitetin që prej vitit 1994 e në vazhdim dhe ka pasur rreth 100 krerë për çdo vit. Të ardhurat *neto* vjetore janë në shumën 990.000 lekë.

⁴⁴Vendimet: nr. ***, datë 29.10.2021; nr. ***, datë 5.12.2019; nr. ***, nr. ***, nr. ***, datë 4.9.2020, si dhe nr. ***, datë 18.7.2019.

iii) nëna e bashkëshortit shtetasja SH.N që prej vitit 1983 dhe aktualisht është e punësuar në fshat si infermiere/mami për fshatin *** dhe fshatin ***, ndërkohë që babai i bashkëshortit, shtetasi B.N, që prej vitit 1994 është regjistruar si i vetëpunësuar në bujqësi me numër të sigurimeve shoqërore *** që nga viti 1994 deri në vitin 2005, moshë kur ka dalë në pension;

iv) pavarësisht faktit që prej vitit 2005 babai i bashkëshortit ka dalë në pension, prindërit e bashkëshortit ende vijojnë të ushtrojnë aktivitetin si fermerë edhe sot. Kryesisht ai e ka fokusuar aktivitetin e tij në mbarështimin e gjedhëve kryesisht dhen dhe dhi, duke pasur një fermë që çdo vit ka patur në përbërje 100 – 150 krerë;

v) të ardhurat e tyre kanë qenë të kënaqshme;

vi) jetesa në fshat ka kosto minimale duke qenë se shumicën e produkteve ushqimore si perime, mish e bulmet i prodhojnë vetë;

vii) sipas subjektit, provohet fakti se nga ana e babait të bashkëshortit, shtetasit B.N, është poseduar gjithmonë një fermë me rreth 150 krerë bagëti, referuar akteve shkresore te poshtëshënuara:

- kontratës së dhënies në përdorim të kullotave dimërore për disa vite, ku është caktuar saktësisht numri bagëtive pasi dhe pagesa e qerasë bëhej për kokë bagëtish;
- vërtetimit për të vetëpunësuarit në bujqësi, i lëshuar nga DRSSH-ja Vlorë, datë 22.12.202, me anë të së cilit vërtetohet fakti se shtetasi B.N ka qenë i vetëpunësuar në bujqësi dhe ka paguar kontribute për periudhën 1.1.1994 – 31.12.2005;
- vërtetimit nr. *** prot., datë 11.2.2022, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë, që vërteton se B.XH.N ushtron aktivitetin si fermer, mbarështim të leshta me kod fermeri ***. Sipas këtij vërtetimi, vërtetohet se e ushtron aktivitetin që prej vitit 1994 e në vazhdim dhe ka pasur mesatarisht 100 krerë për çdo vit. Të ardhurat *neto* vjetore janë në shumën 990.000 lekë. Sipas këtij informacioni, shumat 6.600 euro dhe 1.100.000 lekë, në total shuma 2.000.000 lekë, dhënë djalit të tyre, do të ishte e mbuluar në harkun kohor të 2-3 viteve.

36.3. Në lidhje me vështirësinë e provueshmërisë së të ardhurave faktike nga bujqësia/blegtoaria, si dhe faktit se fitimi nuk është në proporcion me nivelin e pagimit të sigurimeve shoqërore, subjekti i referohet qëndrimeve të mëparshme të Komisionit, si në vendim nr.***, datë 26.7.2019.

36.4. Gjithashtu, subjekti parashtron se në pamundësi për të siguruar fatura të shitjes së qumështit, nënprodukteve të tij si dhe mishit, për shkak se në bazë të ligjit fermerët përjashtohen nga detyrimi tatimor, ka arritur të sigurojë disa deklarata nga subjekte që blinin rregullisht mishin, qumështin dhe nënproduktet e tij. Sipas subjektit, i njëjti qëndrim mbahet nga Komisioni edhe në vendime të tjera⁴⁵. Në mbështetje të deklarimeve, subjekti ka depozituar disa dokumente shkresore⁴⁶.

Vlerësimi i Komisionit

37. Në lidhje me pretendimin, sipas të cilit prindërit e bashkëshortit nuk e gëzojnë statusin e personit të lidhur, ky pretendim nuk qëndron, pasi referuar përkufizimit të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ata janë në një lidhje interesi me bashkëshortin e subjektit dhe, përrjedhë, edhe me subjektin, pasi të ardhura të krijuara prej tyre janë deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim për blerjen e pasurisë objekt verifikimi.

⁴⁵Vendim nr. ***, datë 23.6.2021; vendim nr. ***, datë 26.7.2019; vendim nr. ***, datë 22.4.2021, si dhe vendim i dhënë nga e njëjti trup gjykues.

⁴⁶ (i) vërtetim për të vetëpunësuarit në bujqësi datë 22.12.2020; (ii) kontratë nr. ska e dhënies në përdorim të kullotave dimërore datë 1999-2000; (iii) mandatarkëtimi nr. ***, datë 16.9.1999; (iii) kontratë nr. *** e dhënies në përdorim të kullotave pyjore në datën 4.7.2000; (iv) mandatarkëtimi nr. ***, datë 4.7.2000; (v) kontratë nr. ***, e dhënies në përdorim të kullotave pyjore në datën 17.7.2000; (vi) mandatarkëtimi nr. ***, datë 17.7.2000; (vii) vërtetim nr. *** prot., datë 17.1.2020, i Drejtorisë Bujqësisë Vlorë; (viii) vërtetim nr. ***, datë 11.2.2022, i Drejtorisë Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë; (ix) deklarata nga shtetasi K.K, A.G dhe P.K.

37.1 Sa i takon pretendimeve në lidhje me të ardhura të ligjshme, si nga paga e nënës së bashkëshortit, ashtu edhe nga blegtoria, Komisioni i është referuar fakteve dhe rrethanave, si vijojnë:

Së pari, nga të dhënat bankare Komisioni kishte konstatuar se të ardhurat nënës së bashkëshortit si infermiere për periudhën 2005 – 2011, kanë qenë rreth 1.500.000 lekë. Subjekti, në parashtrimet e saj, paraqiti dokumente shkresore për të ardhurat nga paga si infermiere nënës së bashkëshortit që nga viti 1993 dhe, konkretisht, sipas dokumenteve, të ardhurat e saj nga pagat si infermiere për periudhën 1993 – 1.2.2011 janë në vlerën 2.808.817 lekë.

Së dyti, nuk ka të dhëna për të ardhurat konkrete të vjetërimit të subjektit si i vetëpunësuar në bujqësi dhe blegtori si dhe të dhëna për pagimin e taksave apo detyrimeve tatimore. Por, referuar dokumenteve shkresore:

- vërtetim nga Drejtoria e Bujqësisë Vlorë⁴⁷, i cili konfirmon faktin se fermeri B.XH.N prej vitit 2005 figuron si fermë blegtorale me 150 krerë të imëta dhe nga viti 2011 është i regjistruar në *datasbase* sistemit “****”, të ARSHVMB-së Vlorë, me kodin e fermës, me 115 krerë të imëta;

- vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë⁴⁸, i cili vërteton se: (a) shtetasi B.XH.N ushtron aktivitetin si fermer, mbarështim të leshta me kod fermeri; (b) ushtron aktivitetin që prej vitit 1994 dhe në vazhdim; (iii) ka pasur rreth 100 krerë/vit; (c) të ardhurat *neto* vjetore janë me përafërsi në shumën 990.000 lekë;

- kontratat e vitit 2000, për marrjen me qira të kullotave, të cilat hedhin dritë mbi faktin se vjetërimit i subjektit ka pasur në zotërim krerë të imëta;

- deklaratat shtetasve K.K, A.G dhe P.K, të cilët vërtetojnë se kanë ushtruar aktivitetin e tregimit të mishit dhe se janë furnizuar nga fermeri B.N;

- fakti që në “Raiffeisen Bank” në llogarinë e nënës së bashkëshortit në vitin 2014 ka depozitim të shumës 1.000.000 lekë me përshkrimin *shitja e bagëtive*,

në përfundim të procesit, Komisioni nuk mund të arrijë në konkluzionin se babai i bashkëshortit të subjektit nuk ka siguruar të ardhura nga blegtoria, të cilat kanë reduktuar shpenzimet e jetesës së tyre.

37.2. Në kushtet e pamundësisë objektive për të kryer një analizë të mirëfilltë financiare për prindërit e bashkëshortit, Komisioni bëri një përllogaritje bazuar në të ardhurat e nënës së bashkëshortit si infermiere në vlerën 2.808.817 lekë për periudhën 1993 – 1.2.2011 dhe shpenzimet e jetesës për dy persona⁴⁹, duke i reduktuar ato me 50%. Sipas përllogaritjeve, përkëtë periudhë mundësia e tyre për kursim është në vlerën 1.381.025 lekë, pasqyruar në mënyrë të përmblodhur në tabelën vijuese dhe, për rrjedhojë, ata nuk kanë pasur mundësi për t’i dhuruar bashkëshortit të subjektit shumën prej 2.022.152 lekësh, në qershor të vitit 2012, kur janë tërhequr depozitat⁵⁰.

⁴⁷Vërtetim nr.*** prot., datë 17.1.2020.

⁴⁸Vërtetim nr. ***prot., datë 11.2.2022.

⁴⁹Bashkëshorti i subjektit nuk është përfshirë në këtë analizë, pasi atij i është kryer analiza si person më vete nga viti 2002, kur ka filluar punë dhe është shkëputur nga prindërit deri në vitin 2011 (shihni paragrafin 38.3 të vendimit). Gjithashtu, nuk janë përfshirë: (i) vëllai i bashkëshortit të subjektit U.N, i lindur më 11.10.1984, i cili me të ardhura të tij gjatë viteve që mund të ketë punuar, supozohet se ka përbaluar shpenzimet e tij; (ii) motra e tij E.N, e lindur më 20.6.1991, e cila për shkak të moshës nuk ka punuar dhe të cilës nuk i janë llogaritur shpenzime jetese (shihni kartat e ID në përgjigje të pyetësorit nr. 6).

⁵⁰Përberë prej 6.600 euro/922.152 lekë, sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë + 1.100.000 lekë tërhequr nga nëna e bashkëshortit në datën 15.6.2012.

Analiza për periudhën 1993 – 1.2.2011	
Të ardhura të nënës si infermiere 1993 – 2000	550,715
Të ardhura të nënës si infermiere 2001 – 1.2.2011	2,258,102
Shpenzime jetese 1993 – 2000 (50% e të ardhurave)	275,358
Shpenzime jetese 2001 – 1.2.2011 (sipas ILDKPKI-së për 2 persona x 50%)	1,152,435
Mundësia për kursim	1,381,025

37.3. Është e vërtetë se prindërit e bashkëshortit të subjektit i kanë realizuar këto të ardhura përparabashkëjetesës së djalit të tyre me subjektin dhe para se ajo të ishte subjekt deklarues, ashtu sikurse subjekti pretendon. Por, mungesa e të ardhurave ligjore të tyre që justifikojnë dhurimin e shumave 6.600 euro dhe 1.100.000 lekë, për të paguar sipas pretendimit të subjektit këstin në vlerën 39.000 euro në datën 23.7.2012, merrnjë peshë specifike tëposaçme në rastin e subjektit të rivlerësimit Eriselda Bala dhe në disfavor të saj, referuar fakteve dhe rrethanave si vijojnë:

i) Subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë deklaruar në asnjë DPV shumat e dhuruara prej 6.600 euro dhe 1.100.000 lekë, si burim për blerjen e pasurisë objekt verifikimi me të ardhura të prindërve të bashkëshortit. Ky burim është deklaruar për herë të parë nga bashkëshorti vetëm në deklaratën *Vetting*, me përshkrimin: *“Dhuratë nga prindërit e mi B dhe SH.N 6.600 euro dhe 1.100.000 lekë të tërhequra nga depozitat e tyre bankare nga kursimet e tyre në vite të depozituara pranë Raiffeisen Bank”*.

ii) Këto dhurata nuk janë deklaruar në asnjë prej deklaratave periodike vjetore as nga subjekti dhe as nga bashkëshorti. Nderkohë, vërehet se bashkëshorti i subjektit në DPV për vitin 2014 ka deklaruar 100.000 lekë dhuratë nga nëna e tij si burim për likuiditetin në *cash* prej 300.000 lekësh.

iii) Në mungesë të deklaratimeve, tërheqja e shumave të sipërpërmendur në vlerën totale prej 2.022.152 lekësh prej nënës së bashkëshortit në datën 15.6.2012, nuk mund të përbejë provë që këto shuma i janë dhënë bashkëshortit të subjektit për t’i përdorur për blerjen e pasurisë objekt verifikimi. Për mëteqë, si burime për blerjen e pasurisë objekt verifikimi, për pjesën më të madhe të çmimit të blerjes, subjekti ka deklaruar si burime të ardhurave siguruara nga dhurata e huamarrje nga persona të tretë.

Në këto kushte, edhe në rastin kur prindërit e bashkëshortit të subjektit do të justifikonin me të ardhura të ligjshme shumën prej 2.022.152 lekësh, mbetet e pavërtetuar që këto shuma janë përdorur për pagesën e çmimit të pasurisë objekt verifikimi, qoftë më 8.6.2012, kur janë kryer transfertat bankare në emër të subjektit, qoftë më 23.7.2012, kur subjekti pretendon të jetë paguar kësti prej 39.000 euro.

38. Në lidhje me burimin e deklaruar nga bashkëshorti i subjektit: 4.000 USD të tërhequr nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank” dhe 500.000 lekë *cash*, siguruar nga kursimet nga paga/dieta/shpërblime të kursyera, ndër vite, nga paga si oficer i policisë gjyqësore prej vitit 2002 e në vijim, i cili gjithashtu mungon të jetë deklaruar në DPV duke u deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting*, Komisioni ka vlerësuar t’i analizojë së bashku këto dy shuma, për sa kohë bëhet fjalë për kursime të krijuara përpara njohjes me

subjektin dhe të përdorura në të njëjtën kohë. Sa i takon këtyre shumave, gjatë hetimit administrativ rezultoi se:

38.1. Bashkëshorti i subjektit në datën 1.12.2010 ka tërhequr nga llogaria e tij e pagës në “Raiffeisen Bank” shumën 1.600.000 lekë dhe në po të njëjtën datë në “Raiffeisen Bank” ka derdhur shumën 15.000 USD. Nga kjo shumë ka tërhequr në datën 20.7.2012, në vlerën 4.000 USD.

38.2. Edhe pse depozitimi i kësaj shumë daton përpara bashkëjetesës me subjektin, Komisioni verifikoi mundësitë e bashkëshortit të subjektit, për të krijuar shumën 15.000 USDsi dhe shumën 500.000 lekë,gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, duke pasur në konsideratë faktin se ai ka qenë i punësuar në institucione shtetërore dhe të ardhurat e tij nga punësimi datojnë prej vitit 2002. Komisioni kreu analizën financiare me të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuar të tij për periudhën 2002 –2010, nga ku rezultoi se GJ.N ka pasur mundësi financiare të kursejë shumën 500.000 lekë (gjendje *cash*) dhe shumën 15.000 USD, ku nga kjo e fundit janë tërhequr 4.000 USD nëdatën 20.7.2012.

38.3.Në këto kushte, deri nëpërfundim të hetimit administrativ nuk ka pasur ndonjë dyshim në lidhje me mundësinë e bashkëshortit të subjektit për të krijuar me të ardhura të ligjshme shumën 4.000 USD të tërhequr nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank”, nëdatën 20.7.2012, si dhe likuiditetin prej 500.000 lekësh, të cilat nëdeklaratën*Vetting* janë deklaruar prej tij si burim për blerjen e pasurisë objekt verifikimi.

Në lidhje me pagesat e kryera për këtë pasuri

39. Gjatë hetimit administrativ sa i takon mënyrës sëlikuidimit tëçmimit të shitjes prej 48.000 euro, rezultoi se:

39.1. Nëkontratën e porosisë, datë 12.5.2012, është parashikuar:(i) *kësti i parë në shumën 8.000) euro, do të likuidohet menjëherë me firmosjen e kësaj kontrate, siçështë rënë dakord mes palëve;* (ii) *kësti i dytë në shumën 39.000 euro do të likuidohet në momentin e dorëzimit të çelësave, me përfundimin e plotë të ndërtesës (brenda muajit qershor të vitit 2012);* (iii) *kësti i tretë në shumën 1.000 euro do të likuidohet me nënshkrimin e kontratës së shitjes së apartamentit. Pagesat do të kryhen në numrin e llogarisë*** të shoqërisë“****” sh.p.k., në“Societe Generale Albania”.*

39.2. Në kontratën e shitjes nr. ***, datë 28.1.2015, parashikohet vlera e apartamentit 48.000 euro dhe se *kjo vlerë është likuiduar nga ana e blerësit në favor të shitësit në llogarinë bankare të këtij të fundit.*

39.3. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar këtë mënyrë të likuidimit: (i) shumën 8.000 euro në datën e nënshkrimit të kontratës së porosisë më 12.5.2012; (ii) shumën 39.000 euro në datën 23.7.2012, sipas mandat arkëtimit të lëshuar nga shoqëria në këtë date; (iii) shumën 1.000 euro në datën 5.1.2015, sipas mandat arkëtimit të lëshuar nga shoqëria nëkëtë datë.

39.4. Nga korrespondenca e Komisionit me DPPPP-në⁵¹ dhe BKT-në⁵², rezultoi se kishte raportime për dy transaksione të kryera nëemër të subjektit të rivlerësimit, konkretisht dy depozitime *cash* në vlerat 33.150 euro dhe 14.850 euro, për llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., datë 8.6.2012, me burim kursime familjare, njëra prej të cilave me përshkrimin“për blerje apartamenti”.

39.5. Në lidhje me këto dy transferta subjektit i janëkërkuar sqarime dhe nëpërgjigje tëpyetësorit nr. 3, subjekti i ka qëndruar vlerës prej 48.000 euro, duke deklaruar të njëjtën

⁵¹Shkresë nr. *** prot., datë 14.5.2020.

⁵²Shkresë nr. *** prot., datë 12.5.2020 dhe shkresë nr.*** prot., datë 20.1.2022.

mënyrë likuidimi si në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dhe duke depozituar përsëri dy shkresa të titulluara *mandatarkëtime* të lëshuar nga shoqëria “***” sh.p.k., sipas të cilave Eriselda Bala ka paguar shumat 1.000 euro dhe 39.000 euro, përkatësisht në datat 5.1.2012 dhe 23.7.2012. Ndërsa në lidhje me dy transaksionet bankare të datës 8.6.2012 të kryera në emër të saj në BKT, ka deklaruar se: “Në lidhje me ekzistencën e këtyre dy mandateve jam vënë në dijeni vetëm në datën 24.01.2022 me anë të e-mail-it tuaj bashkëlidhur pyetësorit të tretë. E vënë në dijeni në lidhje me ekzistencën e këtyre dy mandateve menjëherë kam kërkuar informacion pranë BKT-së, ku i vetmi informacion që më është dhënë ka qenë fakti se këto pagesa të këtyre mandateve janë kryer në dy degëtë ndryshme të BKT-së, konkretisht një nga mandatet i përket degës së BKT ‘***’ dhe tjetra në degën e BKT ‘***’, të dy këto veprime të kryera në datën 8.6.2012.

*E bindur se ky veprim nuk është kryer nga ana ime dhe e bindur për falsitetin e tyre kam kërkuar kryerjen e ekspertimit grafik të nënshkrimeve të mandateve të vëna në dispozicion nga ana juaj, ku eksperti me anë të ekzaminimit grafik nr. ***, datë 28.1.2022, ka arritur në konkluzionin se dy shkrimet dhe dy ‘firmat’ e formës ‘***’, të shkruara në emër të shtetasës Eriselda Bala në dy dokumentet objekt ekspertimi: (1) ‘derdhje në llogari’ për shoqërinë ‘***’ sh.p.k., datë 7.6.2012, nga Eriselda Bala, shuma 33,150.00 euro, me vulë të BKT-së; dhe (2) ‘derdhje në llogari’ për shoqërinë ‘***’ sh.p.k., datë 8.6.2012, nga Eriselda Bala, shuma 14.855,00euro, me vulë të BKT-së, nuk janë shkruar nga asnjëri prej dy shtetasve: Eriselda Bala apo G.J.N.*

*Dy “firmat” që shoqërojnë dy shkrimet me përmbajtje ‘E.B’ në dy dokumentet objekt i këtij ekspertimi, janë dukshëm produkte grafike të imitimeve dhe sajimeve grafike! Një kopje të aktit të ekspertimi grafik nr. ***, datë 28.1.2021, po jua vendos në dispozicion. Ndërkohë, është shprehur subjekti, në rast se nga ana juaj do të çmohej e nevojshme kryerja e një ekspertimi nga grup ekspertësh të caktuar nga ana juaj, e mirëpres këtë vendim tuajin⁵³. Duke qenë e bindur në falsitetin e nënshkrimeve, nga ana ime ky fakt do të ndiqet edhe në rrugë ligjore.*

Fakti që pagesa është bërë në dy degë të ndryshme të BKT-së, në të njëjtën ditë është, gjithashtu, një element i cili duhet të krijojë bindjen tuaj se ky veprim është i falsifikuar, pasi nuk ka logjikë që unë të endesha me një shumë të tillë parash nga një cep në cepin tjetër të Tiranës, duke shkuar sa në një degë të bankës BKT në tjetrën për të kryer një pagesë të cilën shumë mire mund të ishte kryer njëherësh.

*Po kështu, nga ana ime ka pasur gjithmonë transparencë në çdo veprim që është kryer duke deklaruar dhe pagesat cash në zyrat e shoqërisë ‘***’ sh.p.k. dhe nuk do të kishte logjikë të fshihja pagesa të tilla të cilat siç dihet nëpërmjet bankës janë lehtësisht të verifikueshme.*

*Të gjitha këto provohen dhe nga vërtetimi i lëshuar nga shoqëria “***” sh.p.k., që pohon faktin se pagesa nga ana jonë si porositës është bërë nëpërmjet mandateve të ndarë në 3 këste siç ka qenë e parashikuar në kontratë dhe ashtu siç është deklaruar prej meje vit pas viti, si dhe pohojnë faktin se pagesa në bankë është bërë nga punonjësit e zyrës së financës së shoqërisë ‘***’ sh.p.k.*

*Gjithashtu, nuk mundet kurrësi të mendohet se një apartament 2+1, në ‘***’, te vendi i quajtur *** në vitin 2012, të kushtonte 96.000 (nëntëdhjetë e gjashtëmijë) euro, pasi nëse do të disponoja një shifër të tillë është e sigurt që zgjedhja ime për të jetuar do të kishte qenë në një zone tjetër të Tiranës. Jam e sigurt se as sot pas 10 vjetësh një shtëpi me të njëjtën sipërfaqe në të njëjtin vend, nuk kushton 96.000 euro.*

⁵³Duke iu referuar rastit të subjektit të rivlerësimit S.N, ku Kolegji i Posaçëm i Apelitimit çmoi të domosdoshme kryerjen e ekspertimit grafik të nënshkrimit.

Për të bindur trupin gjykues, në lidhje me faktin se vlera e apartamentit që unë disponoj është 48.000 euro ashtu siç është parashikuar në kontratën e sipërmarrjes dhe të shitjes, po ju dorëzoj dhe kopje të kontratave të fqinjëve të mi të cilët kanë blerë sipërfaqe të përafërt, ashtu si edhe unë kundrejt shumës të përafërt me atë të shpenzuar nga ana ime dhe shtetasit G.J.N për blerjen e apartamentit.

Duke patur parasysh sa parashtrova më sipër, theksoj faktin se dy mandatpagesate kryera pranë BKT-së, duke falsifikuar nënshkrimin tim, duhet të konsiderohen nul dhe nuk duhet të mbahen parasysh nga Komisioni, si dhe ritheksoj faktin se çmimi i blerjes së pronës apartament banimi është 48.000 (dyzetë e tetë mijë) euro”.

39.6. Subjekti, në mbështetje të deklarimeve si më sipër, ka depozituar: (i) aktekspertimin kriminalistik lidhur me nënshkrimin e bërë në mandatet bankare; (ii) vërtetim nga shoqëria “****” sh.p.k., ku konfirmon pagesën prej 48.000 euro pranë zyrave të shoqërisë, sipas mandatar-këtimeve dhe pranon faktin e një lapsusi në qarkullimin e plotë të shumës përpara depozitimit të kësteve të parashikuara në kontratë; si dhe (iii) kontrata të ngjashme të cilat datojnë disa vjet më pas, nga verifikimi i të cilave, sipas subjektit, nuk ka ndonjë luhatje domethënëse krahasuar me atë të subjektit.

40. Siç vërehet, Komisioni është ndodhur përpara dy mënyrave të likuidimit të çmimit të shitjes prej 48.000 euro:

Së pari, sipas informacionit të BKT-së dhe DPPPP-së, kjo shumë është paguar tërësisht në rrugë bankare në datën 8.6.2012, me dy transfertë bankare në emër të subjektit Eriselda Bala.

Së dyti, sipas variantit të paraqitur nga subjekti gjatë hetimit administrativ, kjo shumë është paguar me tri këste, pjesërisht në qershor të vitit 2012 me lidhjen e kontratës së porosisë, pjesërisht në korrik të vitit 2012 (39.000 euro) dhe pjesërisht në janar të vitit 2015 (1.000 euro).

Ndodhur në këto kushte, Komisioni ka kryer disa veprime hetimore me qëllim: (i) për të vërtetuar pretendimet e subjektit sipas të cilit, pagesa e shumës prej 48.000 euro është bërë me këstet e siperpërmendura, dhe jo në rrugë bankare në datën 08.06.2012, fakt që afekton në mënyrë të drejtpërdrejtë analizën financiare; si dhe (ii) për të hequr dyshimet se subjekti mund të kishte blerë një pasuri tjetër, përveç asaj të deklaruar në deklaratën *Vetting*. Konkretisht, nga Komisioni janë ndërmarrë hapat hetimore si vijojnë:

40.1. I është kërkuar informacion Bankës Kombëtare Tregtare, e cila ka depozituar⁵⁴ *statement*, ku pasqyrohen transaksionet e shoqërisë “****” sh.p.k., mandatet e veprimeve të derdhjeve në emër të shtetasës Eriselda Bala, si dhe dokumenti i identitetit të personit në emër të të cilit janë bërë derdhjet, që i përket subjektit të rivlerësimit Eriselda Bala. Komisioni kërkoi nga Banka Kombëtare Tregtare edhe pamjet filmike për transaksionet bankare të kryera në datën 8.6.2012, në favor të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., por banka në përgjigjen e saj⁵⁵ ka informuar se bazuar në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, udhëzimeve të dala në bazë dhe për zbatim të tij, si dhe kuadrit rregullator të Bankës së Shqipërisë, nuk është e detyruar të mbajë pamje filmike përtej afateve ligjore.

40.2. I është kërkuar informacion shoqërisë “****” sh.p.k., në lidhje me pagesën e çmimit prej 48.000 euro dhe në përgjigjet e dërguara zyrtarisht vërehet se⁵⁶:

- Fillimisht shoqëria ka informuar se likuidimi nga subjekti është kryer sipas afateve të përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes dhe, për këtë, ka depozituar të njëjtat mandatpagesate

⁵⁴Përgjigjet nr. ***, datë 23.2.2022 dhe nr. ***prot., datë 2.3.2022.

⁵⁵Përgjigje nr. ***prot., datë 9.3.2022.

⁵⁶Me përgjigjet e datave 20.12.2021, 9.2.2022, 24.2.2022 dhe 3.3.2022, nga shoqëria “****” sh.p.k.

që ka depozituar subjekti. Në fakt mënyra e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes se likuidimi i shumës 39.000 euro do të bëhej brenda muajit qershor të vitit 2012 në rrugë bankare, nuk përputhet me mandatpagesën e datës 23.7.2012, paraqitur nga subjekti gjatë hetimit, e cila vërteton pagesën e shumës 39.000 euro në korrik të vitit 2012, jo në rrugë bankare.

- Në vijim, shoqëria ka sqaruar se depozitimi i shumës prej 48.000 euro në numrin e llogarisë së shoqërisë është bërë nga një punonjës i saj i zyrës së financës, përpara depozitimit nga pala blerëse (subjektit) sipas kësteve të parashikuara në kontratën e sipërmarrjes, si pasojë e një lapsusi nga ngarkesa e madhe e punës. Lidhur me faktin se kujt i korrespondonin shumat e depozituara në llogarinë e shoqërisë në BKT, shoqëria ka informuar se ato shuma ishin nga dividendi (të ardhurat/fitimi) i administratorit.

- Lidhur me faktin nëse nga shoqëria ishte nënshkruar ndonjë marrëdhënie kontraktore me të afërm të subjektit, shoqëria ka informuar se nuk ka pasur asnjë marrëdhënie kontraktore me familjarë të subjektit.

40.3. Në vijim të hetimit, Komisioni ka kërkuar nga shoqëria “****” sh.p.k. informacion dhe dokumentacion lidhur me: (i) raste të ngjashme me subjektin e rivlerësimit ku shoqëria ka kryer pagesa për klientin përpara se ky i fundit të depozitonte vlerën përkatëse të çmimit të pasurisë; (ii) identitetin e punonjësit të shoqërisë që ka kryer pagesat në bankë në datën 8.6.2012, në emër të subjektit; (iii) qëllimin e derdhjes së bërë nga shtetasja K.F, në llogarinë e shoqërisë në po të njëjtën datë dhe me të njëjtin përshkrim si në rastin e subjektit; si dhe (iv) nevojën e shoqërisë për kryerjen e derdhjeve në emër të znj. Eriselda Bala, ndërkohë që referuar veprimeve bankare në datën 8.6.2012, llogaria në BKT mbyllet me shumën 74.000 euro. Në përgjigje, shoqëria “****” sh.p.k. ka informuar⁵⁷ Komisionin se:

- e kanë të vështirë të evidentojnë raste të ngjashme me znj. Eriselda Bala për shkak se në atë periudhë situata në punë ka qenë e ngarkuar;

- e kanë të pamundur identifikimin e punonjësit të departamentit të financës që ka kryer derdhjet në BKT, në datën 8.6.2012, si rrjedhojë e ndryshimit të stafit me kalimin e viteve;

- sa i përket derdhjes së bërë në po të njëjtën datë dhe me të njëjtin përshkrim si në rastin e znj. Eriselda Bala, në vlerën 40.350 euro nga shtetasja K.F, ka specifikuar se edhe kjo shtetase është kliente e shoqërisë, pasi ka blerë një njësi shërbimi dhe vlera e depozituar prej saj përbën likuidim pjesor të kontratës së sipërmarrjes;

- sa i përket nevojës së shoqërisë për kryerjen e derdhjeve në emër të znj. Eriselda Bala, ndërkohë që referuar veprimeve bankare në datën 8.6.2012, llogaria në BKT mbyllet me vlerën 74.000 euro, shoqëria ka sqaruar ekzaktësisht se: *“.. sipas statementit të datës 8.6.2012, atë ditë janë kryer likuidime edhe nga klientë të tjerë, për këtë arsye statementi bankar mbyllet me vlerë më të lartë se qarkullimi që është bërë në bankë për znj. Bala i vlerës 48.000 euro”, si dhe “Në llogaritë bankare të shoqërisë ‘****’ sh.p.k. ka hyrje dhe dalje të të ardhurave pothuajse çdo ditë. Ashtu siç kemi klientë që kryejnë transfertat sipas kontratave të porosisë që nënshkruajmë, kemi nënkontraktorët, të cilët ne na duhet të likuidojmë në përputhje me marrëdhënien që kemi me ta. Duke qenë se shoqëria të gjitha likuidimet e muajit paraardhës i realizon brenda datës 10 të muajit pasardhës, ku përkatësisht këto janë edhe ditët që klientët likuidojnë këstet sipas kontratës, ka pasur të nevojshme të kryejë pagesa kundrejt personave të tretë, për këtë arsye ka marrë masa duke bërë qarkullimin e shumës prej 48.000 euro, në datën 8.6.2012, në mënyrë që ditën e hënë, përkatësisht, në datën 11.6.2012 të likuidonte furnitorët”.* Në mbështetje të deklarimeve shoqëria ka depozituar dokumentacionin përkatës.

⁵⁷Përgjigje datë 9.3.2022.

40.4. Është thirrur shoqëria “****” sh.p.k. për të dëshmuar në lidhje me transaksionet bankare të kryera në emër të subjektit në datën 8.6.2012. Përfaqësuesja e shoqërisë, në seancën dëgjimore përpara anëtarëve të trupit gjykues dhe vëzhguesit ndërkombëtar, në cilësinë e dëshmitarit,⁵⁸ ka deklaruar si vijon:

- Sa i takon pagesës së shumë 48.000 euro, në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., në emër të subjektit, ndër të tjera, përfaqësuesja deklaroi se: *“... kemi dakordësuar me bankën që të marri paratë dhe të bëjmë depozitimin sa herë që, patjetër, që ata duan mandat të firmosur nga klienti. Firmat ne i bënim dhe i çonim nga zyra jonë domethënë, të firmosura në zyrë me formatin e tyre dhe të depozituara pranë bankës, me një kopje të kartës së identitetit. Niveli i kontrollit ka qenë më i ulët, realisht. Kështu që ishte një akord paraprak që kompania mund të depozitohet për llogari të klientëve dhe e kemi kërkuar ne për të pasur qartësi në llogari domethënë. Në qoftë se ishin të gjitha, L derdh për klientin, ne do ta kishim të vështirë në një statement, ku L derdh në BKT, të identifikonim klientët. Kështu që kemi kërkuar atëherë nga banka që çdo klient të kishte emrin e vetë individual në momentin e derdhjes. Dhe ata kërkuan që të kishin një mandat individual dhe një kartë identiteti, që vjen në momentin e depozitimit ...”*. Në vijim ka deklaruar se: *“... shumicën e rasteve i firmosim vetë edhe mandatet kur derdhim në bankë dhe lënë një kartë identiteti që ne e depozitojmë”*.

- Përfaqësuesja e shoqërisë, gjithashtu, ka dhënë deklarime edhe mbi: (i) burimin e shumave të depozituara; (ii) faktin se kujt i përkisnin këto shuma; (iii) qëllimin e bërjes së këtyre pagesave nga shoqëria përpara se të bëhej shlyerja nga subjekti; (iv) kush i kishte kryer veprimet dhe me çfarë cilësie i kishte kryer në bankë; si dhe (v) nëse ka qenë në dijeni subjekti për kryerjen e këtyre pagesave në bankë.

- Më konkretisht, përfaqësuesja ka deklaruar se ata janë njoftuar nga klienti që nuk e kishte të mundur që ta kryente pagesën për këtë kësht në muajin qershor dhe likuidimin do ta bënte më vonë, dhe në kushte të tilla kishin injektuar fondet e tyre, pra të administratorit dhe fondet e xhiros së biznesit në llogari. Përfaqësuesja e shoqërisë, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Pra, në hipotekë, detyrimi është që të çosh kontratën e porosisë bashkë me mandatet e derdhjes në bankë të vlerës së kontratës. Kështu që ajo që kemi bërë dhe në kushtet e besimit ndaj klientit dhe në kushtet e nevojave operacionale të biznesit, ne kemi derdhur këto fonde nga fondet e shoqërisë ...”, “Administratori, vit pas viti të paktën në këto dy vite që bëhet fjalë, ka marrë dividendin e tij, është rreth 4-5 milionë lekë të reja, domethënë janë fonde që ai i injekton në biznes sa herë që është nevoja ... Fondet janë të derdhura në bankë dhe janë përdorur për pagesa furnitorësh, qartësisht”* dhe se *“... lekët kanë qenë nga administratori se s’kanë nga të jenë tjetër. Domethënë pronari bën derdhje në arkë dhe ne shkojmë i çojmë në bankë”*.

- Sa i përket qëllimit të bërjes së këtyre pagesave nga shoqëria përpara se të bëhej shlyerja nga subjekti, përfaqësuesja e shoqërisë ka deklaruar se: *“Ne thjesht jemi detyruar që për efekt të operacioneve tona këtë likuidim ta bënim përpara se fizikisht të na vinte. Kjo është gjithçka që ka ndodhur dhe që ka krijuar situatën”*. Por në fakt, as përfaqësuesja e shoqërisë dhe as shoqëria në përgjigjet zyrtare për Komisionin, nuk paraqiti raste të tjera të kësaj praktike të ndjekur, sipas së cilës likuidimi i çmimit të shitjes të ishte bërë përpara se shuma të vinte fizikisht nga klientët blerës.

- Sa i përket faktit se kush dhe me çfarë cilësie i kishte kryer veprimet e derdhjes në bankë, përfaqësuesja pranoi që këto pagesa janë kryer nga një punonjës i shoqërisë për identitetin e të cilit nuk kishte dijeni dhe, ndër të tjera, ka deklaruar *“Ne çojmë një mandat dhe një kartë identiteti ...”, “Të Balës, po...”* dhe se *“Ka pasur një akord me BKT-në në atë kohë, që të bënim depozitime për klientët. Në dijeninë time, banka mbante në regjistrat e vetë, nuk e di si është paraqitur në statement, por banka mban në regjistrat e vetë personin që vjen e*

⁵⁸Sipas procesverbalit për marrjen e deklarimeve të shoqërisë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga znj. L.H, mbajtur në datën 2.3.2022.

depoziton, sepse duhet të jenë në rregull ata, por në statement të llogarisë sonë ne kemi kërkuar që të paraqitet vetëm emri i klientit, për ta pasur të lehtë ta ndajmë njërin nga tjetri, domethënë të mos figurojnë në emrin e punonjësit çdo herë dhe ne e kemi të vështirë të adresojmë se cili bëri çfarë derdhje, në qoftë se ka raste, në qoftë se ka më shumë se një rast”.

- Sa i përket faktit nëse ka qenë në dijeni subjekti për kryerjen e pagesave në bankë në datën 08.06.2012, përfaqësuesja e shoqërisë ka deklaruar: *“Në momentin që ka ndodhur unë kam përshtypjen që jo. Klientët njoftohen në momentin e parë të nënshkrimit të kontratës që e gjithë shuma totale e kontratës deri në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, pra deri në momentin që hipotekohet objekti, do duhet të jetë eventualisht ose menjëherë e depozituar në llogarinë bankare të shoqërisë, sepse ne e dinim në atë moment që detyrimi ligjor i hipotekës ishte, të gjitha pagesat në sistemin bankar. Kështu që ia kemi bërë me dije që këto fonde do ti çojmë në bankë, pastaj momenti që ne i kemi çuar nuk është vënë në dijeni njeri”* dhe sërish ka deklaruar se: *“Në dijen time më të mirë, jo nuk i kemi thënë”.*

Siç vërehet, përfaqësuesja e shoqërisë është e paqartëdhe jo bindëse në deklaratimet e saj në lidhje me pagesën në rrugë bankare të shumës 48.000 euro në datën 08.06.2012 nga një punonjës i shoqërisë dhe dijeninë e subjektit për kryerjen e kësaj pagese.

40.5. Me qëllim evidentimin e faktit nëse në emër të të afërmeve të subjektit janë kryer veprime noteriale/kontrata/marrëveshje për pasuri të tjera të mundshme të përfituara nga shoqëria “****” sh.p.k. është kërkuar informacion nga Dhoma Kombëtare e Noterëve, noteret A.H, M.D dhe M.SH, të cilat kanë kryer veprime noteriale në emër të subjektit, FSHU, UKT, si dhe administratori i pallatit ku ndodhet pasuria e subjektit. Nga përgjigjet e vëna në dispozicion⁵⁹ nuk u evidentua ndonjë marrëdhënie kontraktore e shoqërisë me të afërm të subjektit.

40.6. Në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit, Komisioni ka mbajtur korrespondencë edhe me institucionet punëdhënëse të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit⁶⁰ të saj, të cilët në përgjigjet⁶¹ e tyre, në asnjë rast nuk konfirmuan shqyrtimin e çështjeve ku pjesëmarrës me çfarëdolloj statusi të kenë qenë shoqëria “****” sh.p.k. apo shtetasi A.N.N (administrator i shoqërisë).

40.7. Në lidhje me ndonjë trajtim preferencial të mundshëm në përfitimin e kësaj pasurie, Komisioni i është referuar udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2011”, sipas të cilit, çmimi lekë/m², për vitin 2011, për qytetin e Tiranës, në zonën 4/1 (aty ku ndodhet dhe apartamenti i subjektit) është 75.000 lekë/m². Apartamenti i blerë nga subjekti dhe bashkëshorti është me sipërfaqe totale 91.09 m². Duke u bazuar në çmimet referuese, rezulton se vlera e apartamentit është 6.831.750 lekë, vlerë që është me e lartë nga çmimi që ka paguar subjekti, pasi apartamenti është blerë në vlerën 48.000 euro ose 6.600.730 lekë. Pra, rezulton se apartamenti është blerë në vlerën 231.020 lekë më lirë nga vlerat e tregut (6.831.750 – 6.600.730). Gjithashtu, subjekti dhe shoqëria “****” sh.p.k. kanë vënë në dispozicion të Komisionit kontrata të ngjashme për pasuri apartament në të njëjtin pallat, nga ku ka

⁵⁹Përgjigjet e noteres A.H në datën 28.2.2022, noteres A.D në datën 28.2.2022 dhe noteres M.SH në datën 28.2.2022. Përgjigje nr. ***prot., datë 8.3.2022, e UKT-së. Përgjigje e administratorit, hyrë në Komision, me nr. ***prot., datë 7.3.2022. Përgjigje nr. ***prot., datë 4.3.2022, e FSHU-së. Përgjigje me nr. ***prot., datë 7.3.2022, e Ministrisë së Drejtësisë, sektori i monitorimit të veprimeve noteriale.

⁶⁰Depozituar me pyetësin nr. 5, datë 3.2.2022: (i) shkresë nr. *** prot., datë 14.2.2022, nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 9.2.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; (iii) shkresë nr. *** prot., datë 9.2.2022, nga Komisariati i Policisë ***; (iv) shkresë nr. *** prot., datë 11.2.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁶¹Shkresë nr. *** prot., F. N., datë 19.1.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. *** prot., (P. H.) datë 19.1.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; dhe shkresë nr. *** prot., datë 4.2.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

rezultuar se të gjitha kontratat janë përafërsisht me të njëjtat çmime me njëra-tjetrën dhe me atë të subjektit. Në këto kushte, nuk u evidentuan elemente të përfitimit të pasurisë në kushte preferenciale nga subjekti.

41. Bazuar në të gjitha sa më sipër, referuar dokumentacionit mbi transaksionet e derdhjeve të kryera në “Banka Kombëtare Tregtare”, në datën 8.6.2012, për llogari të shoqërisë “****” sh.p.k. në emrin e subjektit, Komisioni, deri në fazën e përfundimit të hetimit administrativ, vlerësoi që duke marrë në konsideratë faktet si: (i) përshkrimin dhe burimin e shumave të evidentuara në mandatpagesa; (ii) faktin që është përdorur dokumenti i identitetit të subjektit në momentin e kryerjes së dy transfertave bankare, në total prej 48.000 euro, në datën 8.6.2012; (iii) faktin se përfaqësuesja e shoqërisë nuk ishte bindëse në shpjegimet e saj; (iv) faktin që sa i përket pretendimeve të subjektit mbi falsitetin e nënshkrimeve dhe ndjekjen e kësaj çështjeje në rrugë ligjore, nuk rezultoi që subjekti të kishte ndërmarrë ndonjë veprim ligjor ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. dhe bankës BKT; (v) faktin që më 8.6.2012 është paguar e gjithë shuma e çmimit të blerjes, ndërkohë që një pjesë e këtij çmimi ishte paguar më parë, Komisioni kreu analizën financiare duke përfshirë përveç pagesave me mandatpagesa të depozituara prej subjektit edhe transaksionin prej 48.000 euro në bankë.

42. Me qëllim evidentimin e mundësive financiare të subjektit për blerjen e pasurisë me të ardhura të ligjshme, Komisioni kreu analizën financiare⁶², pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese.

Nr.	Përshkrimi	2011	23.7.2012
1	TË ARDHURA	926,649	2,987,576
	Të ardhura nga paga subjekti	924,630	526,443
	Të ardhura nga paga bashkëshorti		424,441
	Dhurim nga gjyshërit me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 25.11.2011		
	Hua E.B (motra) 2012 (1.000.000 lekë)		1,000,000
	Dhuratë nga prindërit për blerje apartamenti 1.000.000 lekë		1,000,000
	Të ardhura nga interesat	2,019	36,693
	Dhurim nga prindërit e bashkëshortit		
2	SHPENZIME	440,964	6,913,088
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	136,620	164,528
	Shpenzime qiraje	72,000	42,000
	Shpenzime dy pagesat në BKT (48.000 euro më 8.6.2012)		6,706,560
	Shpenzime TIMS	232,344	
3	PASURI	1,399,475	4,154,851
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme		
	Apartament me sip. 91.09 m ²⁶³		6,460,620

⁶²E cila mund të ndryshojë në procesin e vlerësimit përfundimtar në varësi të provave dhe dokumenteve që subjekti do të paraqesë në ushtrim të barrës së provës.

⁶³Kjo vlerë është shumatore e dy kësteve të para prej 8.000 euro dhe 39.000 euro. Kësti i fundit prej 1.000 euro nuk është përfshirë si shpenzim në këtë analizë, për shkak se sipas variantit të subjektit është paguar në janar të vitit 2015.

	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	1,399,475	(2,305,769)
	DIFERENCA (1-2-3)	-913,789	-8,080,362

42.1 Kjo analizë: (i) është kryer deri në datën 23.7.2012, kur është paguar kësti i dytë i pretenduar prej 39.000 euro. Sa i takon këstit të paguar në datën 5.1.2015, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar në deklaratën e vitit 2015 se ka zvogëluar gjendjen e tij *cash* për pagesën e këtij kësti. Komisionit, në analizën financiare të kryer për vitin 2014, nuk i kanë rezultuar problematika në krijimin e kësaj gjendjeje *cash* dhe as në vitin 2015 kur është përdorur ky likuiditet *cash*; (ii) ka përfshirë vitin 2011, për faktin se në këtë vit ishte kryer dhurimi nga gjyshërit në vlerën 1.000.000 lekë deklaruar si një nga burimet e pasurisë, të cilën Komisioni, deri në fazën e përfundimit të hetimit administrativ, nuk e mori në konsideratë si të ardhur të ligjshme dhe, për rrjedhojë, kjo shumë u konsiderua si shpenzim i subjektit; (iii) nuk ka përfshirë si të ardhura të ligjshme dhurimet nga nëna e bashkëshortit të subjektit në shumat 6.660 euro dhe 1.100.000 lekë, dhe, për rrjedhojë, këto shuma u konsideruan si shpenzime të subjektit.

Barra e provës kaluar subjektit të rivlerësimit

43. Me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve, duket se: subjekti gjendej në pamundësi financiare në vlerën 8.994.151 lekë për të paguar: (i) këstet sipas pretendimeve të saj plus dy pagesat në vlerën 48.000 euro, në BKT, në datën 8.6.2012, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare; (ii) kishte paqartësi për Komisionin kryerja e këtyre pagesave në bankë; si dhe (iii) mbetej i dyshimtë qëllimi dhe destinacioni real i tyre.

Përmbledhje e fakteve dhe rrethanave të rezultuara nga hetimi administrativ

44. Përpara se të analizohen parashtrimet e subjektit, Komisioni rikujton se për pasurinë objekt verifikimi, në rend kronologjik, janë kryer në mënyrë të përmbledhur veprimet dhe deklaratimet/mosdeklarimet si vijojnë:

44.1. Me kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 12.5.2012, midis palëve “****” sh.p.k. nga njëra anë dhe Eriselda Bala dhe GJ.N nga ana tjetër, pala porositëse ka porositur ndërtimin e një apartamenti me sip. *neto* 91.09 m², me çmim 48.000 euro, i cili është parashikuar të shlyhet në këtë mënyrë: (i) kësti i parë në shumën 8.000 euro do të likuidohet menjëherë me firmosjen e kësaj kontrate, siç është rënë dakord mes palëve; (ii) kësti i dytë në shumën 39.000 euro do të likuidohet në momentin e dorëzimit të çelësave, me përfundimin e plotë të ndërtesës (brenda muajit qershor të vitit 2012); (iii) kësti i tretë në shumën 1.000 euro do të likuidohet me nënshkrimin e kontratës së shitjes së apartamentit. Pagesat do të kryhen në numrin e llogarisë ***, të shoqërisë “****” sh.p.k., në bankën “Societe Generale Albania”.

44.2. Në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar: “*Lidhur kontratë sipërmarrjeje për apartament në vlerën 48.000 euro, paguar deri tani 47.000 euro, në bashkëpronësi me GJ.N. Pjesa takuese 50 %*”. Në këtë deklaratë nuk është deklaruar burimi i krijimit të pasurisë dhe as detyrimi i mbetur prej 1.000 euro, sikurse kërkohet nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar. Por, në rubrikën “përshkrimi i pasurive”, subjekti ka deklaruar pakësim të llogarisë në “Credins Bank”, përdorur për blerje shtëpie. Në rubrikën “përshkrimi i detyrimeve” ka deklaruar hua në vlerën 1.000.000 lekë motrës së saj E.B, e përdorur për kontratën e sipërmarrjes. Ndërsa në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, ka deklaruar vlerën 1.000.000 lekë dhuratë nga prindërit e saj për blerje apartamenti. Siç vërehet, në këtë deklaratë, subjekti nuk ka kryer deklaratime në lidhje me të ardhura apo burime që kanë shërbyer për pjesën takuese të bashkëshortit (ish-bashkëjetuesi) GJ.N, në pasurinë objekt verifikimi.

44.3. Në DPV-në e vitit 2014, kur i ka lindur detyrimi, bashkëjetuesi i subjektit GJ.N ka plotësuar DPV-në e vitit 2014, në të cilën ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 12.5.2012, për porositjen e një apartamenti me sip. 91.09 m² me vlerë të përgjithshme 48.000 euro, në pjesë takuese 50%, por pa kryer asnjë deklaram në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë.

44.4. Me kontratën e shitjes me akt noterial nr. ***, datë 28.1.2015, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse Eriselda Bala dhe GJ.N, vërtetohet kalimi i pronësisë së pasurisë nr. ***, në emër të blerësve, sipas së cilës çmimi i shitjes është likuiduar në favor të shitësit në llogarinë bankare të tij.

44.5. Në DPV-në e vitit 2015, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri, por pa deklaruar burimet e krijimit të saj.

44.6. Në DPV-në e vitit 2015, bashkëshorti i subjektit GJ.N e ka deklaruar këtë pasuri në bashkëpronësi me bashkëshorten dhe pjesën takuese 50%, duke sqaruar se është paguar kësti i fundit prej 1.000 euro, me burim pakësimin e gjendjes *cash* në shtëpi prej 300.000 lekësh. Siç vërehet, është deklaruar vetëm burimi i krijimit të këstit të fundit të pretenduar prej 1.000 euro.

44.7. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë apartament të blerë me kontratë nr. ***, datë 28.1.2016 (ka një lapsus në shënimin e vitit 2016), në pjesë takuese 50%, duke deklaruar vetëm burimet e likuditeteve të përdorura për blerjen e pjesës së saj takuese, si vijojnë: “(i) 1.000.000 lekë dhuratë nga gjyshërit e mi Z.B dhe H.B me anë të kontratës së dhurimit nr. ***, datë 25.11.2011; (ii) 1.000.000 lekë dhuratë nga prindërit e mi B.B e V.B; (iii) 1.000.000 lekë hua nga motra ime E.B. Diferenca prej 400.000 lekësh kursime nga paga ime si prokurore”.

44.8. Në deklaratën *Vetting* bashkëshorti i subjektit GJ.N ka deklaruar pasurinë e blerë në çmimin 48.000 euro, në pjesë takuese 50%, duke deklaruar vetëm burimet e likuditeteve të përdorura për blerjen e pjesës së tij takuese si vijojnë: “(i) dhuratë nga prindërit e mi B dhe SH.N 6.600 euro dhe 1.100.000 lekë; (ii) 4.000 USD, të tërhequra nga llogaria personale pranë ‘Raiffeisen Bank’; dhe (iii) 500.000 lekë gjendje *cash* nga paga/dieta/shpërblime të kursyera në vite nga paga si oficer i policisë gjyqësore prej vitit 2002 e në vijim”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

45. Në analize të çdo pretendimi dhe dokumenteve që subjekti ka vënë në dispozicion me parashtrimet e veta në ushtrim të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur ka rezultuar se:

45.1. Në përpjekje për të qartësuar Komisionin për sa i është kërkuar në barrën e provës në lidhje me pagesat e kryera në emër të saj pranë BKT-së në datën 8.6.2012, në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., në total në shumën 48.000 euro dhe dyshimet e ngritura për destinacionin e tyre, subjekti ka pretenduar ashtu sikurse dhe gjatë hetimit administrativ se, asnjëra prej pagesave nuk është kryer prej saj apo prej bashkëshortit të saj. Konkretisht, midis të tjerave, subjekti ka deklaruar: “... siç e kam theksuar dhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, pa dashur të bie në përsëritje, pagesa e kryer në dy degët e BKT-së përbën një veprim të falsifikuar dhe, si i tillë, duhet të konsiderohet nul, absolutisht i pavlefshëm, nga ana e Komisionit”. Nën bështetje të këtij pretendimi, subjekti i është referuar aktit të ekzaminimit grafik nr. ***, datë 28.1.2022, të dorëzuar bashkëlidhur provave të pyetësorit nr. 3, si dhe faktit që pagesa është bërë në dy degë të ndryshme të BKT-së në të njëjtën ditë, duke argumentuar se: “... ky është gjithashtu një element, i cili duhet të krijojë bindjen e Komisionit se ky veprim është i falsifikuar pasi nuk ka logjikë që unë të endesha me një shumë të tillë parash nga një cep në cepin tjetër të Tiranës duke shkuar sa në një degë të BKT-së në tjetrën për të kryer një pagesë e cila shumë mirë mund të ishte kryer njëherësh ...”.

45.2. Subjekti ka paraqitur disa argumente në funksion të pretendimit se as ajo dhe as bashkëshorti i saj nuk janë paraqitur pranë dy sporteleve të BKT-së për të kryer dy pagesat në datën 8.6.2012, në llogari të shoqërisë “***” sh.p.k. dhe se këto derdhje janë kryer nga një punonjës i shoqërisë, duke deklaruar, ndër të tjera, se: “...pasi u njoha me rezultatin e hetimit administrativ nga Komisioni, si dhe me provat dhe korrespondencën gjatë hetimit, nuk mund të lija pa vënë re faktin që në të njëjtën ditë në të njëjtin moment në të njëjtën degë të BKT-së rezulton të jenë kryer pagesa nga 3 klientë të ndryshëm në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., nëpërmjet BKT-së. Normalisht do të ishte rastësi shumë e madhe të ndodheshim njëkohësisht të gjithë aty në të njëjtin moment, por ajo që të bën më tepër përshtypje është fakti se si ka mundësi ku pagesa e shtetasit A.H rezulton të jetë bërë vetëm një minutë përpara pagesës së kryer në emrin tim në të njëjtën degë të BKT-së dokumenti i tij identifikues është i skanuar me ngjyra, ndërsa dokumenti im identifikues është kopje pa ngjyra. Kjo tregon që kurrsesi nuk mund të jetë mbajtur kopje nga e njëjta pajisje e bankës, por tregon faktin se nga punonjësi/ja e shoqërisë “***” sh.p.k. i është vendosur në dispozicion një kopje e kartës sime të identitetit, gjë që punonjësit e shoqërisë “***” sh.p.k. e dispononin për sa kohë kishin një kopje të kontratës së sipërmarrjes, e cila shoqërohet edhe me kopje të kartës së identitetit të palëve kontraktuale, të lidhur që më 12.5.2012 mes nesh ...”.

Në vijim, duke iu referuar depozitimit të shumës 48.000 euro, në datën 8.6.2012, subjekti deklaroi se: “... ky veprim është bërë nga shoqëria vetëm me qëllimin për të qarkulluar nëpërmjet sistemit bankar shumën e përfituar nga blerja e apartamentit, pavarësisht se këtë veprim e kanë bërë pa autorizimin tim apo të bashkëshortit tim, duke kryer kështu në bashkëpunim me bankën elementet e veprës penale ‘falsifikim i dokumenteve’ dhe ‘shpërdorim i detyrës’, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal”.

Në përfundim, subjekti ka deklaruar: “... gjithashtu, theksoj se nga ana ime është bërë kallëzim në lidhje me këtë fakt, ku kam depozituar kallëzimin penal nr. ***, datë 31.1.2022, dhe më tej nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është vendosur regjistrimi i procedimit penal nr. ***, datë 15.2.2022, për veprat penale ‘falsifikim i dokumenteve’ dhe ‘shpërdorim detyre’, të parashikuara nga nenet 186/3 dhe 248 të Kodit Penal dhe çështja është ende në hetim”.

45.3. Subjekti, pa deklaruar në parashtrime shkakun përse nuk është respektuar afati i kontratës së sipërmarrjes për likuidimin e këstit prej 39.000 euro brenda qershorit të vitit 2012, vijon të mbajë qëndrimin se kjo pagesë është kryer më 23.7.2012, ndërsa pagesa prej 1.000 euro është kryer më 5.1.2015, sipas dy shkresave të titulluara mandatar-këtimi, të lëshuara nga shoqëria “***” sh.p.k., përkatësisht në këto data. Për të mbështetur këtë pretendim, subjekti i është referuar, ndër të tjera, edhe datave të tërheqjeve të tri depozitave bankare në emër të saj dhe bashkëshortit, tërheqje të kryera pas datës 8.6.2012. Konkretisht, subjekti ka deklaruar: “... nëse do të analizoheshin datat e tërheqjes së depozitave bankare, konkretisht: (i) depozita në emrin tim pranë ‘Credins Bank’ në shumën 1.438.000 lekë është tërhequr nga llogaria e bankës më 22.6.2012; (ii) depozitat e prindërve të bashkëshortit 6.600 euro dhe 1.100.000 lekë janë tërhequr nga banka në datën 15.6.2012; (iii) depozita e bashkëshortit G.J.N prej 4.000 USD është tërhequr në datën 20.7.2012, shpjegojnë qartësisht arsyen përse kësti i dytë prej 39.000 euro është kryer në muajin korrik dhe nuk mundet kurrsesi të ishte kryer e gjithë pagesa në datën 8.6.2012, kur pjesa më e madhe e parave janë tërhequr nga banka pas datës 8.6.2012, konkretisht në datat që citova më lart, 15.6.2012, 22.6.2012 dhe 20.7.2012. Kjo është dhe arsyeja përse nga ana jonë u mundësua pagesa e këstit të dytë si kësti kryesor i pagesës së apartamentit vetëm në datën 23.7.2012, kur ishte siguruar e gjithë shuma e nevojshme ...”.

45.4. Në mbështetje të argumentit se çmimi i blerjes së pasurisë është paguar në pjesën më të madhe (39.000 euro) në datën 23.7.2012, subjekti ka deklaruar se: “... siç e kam deklaruar

dhe në përgjigjen e pyetësorit nr. 3, në kontratën e sipërmarrjes ishte parashikuar fakti se dorëzimi i çelësave të apartamentit do të bëhej në momentin e pagesës së këstit të dytë. Nga provat e dorëzuara prej meje rezulton se pagesa prej 39.000 euro është kryer në datën 23.7.2012, ndërkohë që procesverbali i dorëzimit të çelësave është bërë një ditë më vonë më datë 24.7.2012. Kjo provon faktin se nëse pagesa do të ishte kryer prej nesh që në datën 8.6.2012 atëherë edhe çelësat do të na ishin dorëzuar shumë më shpejt. Po kështu edhe aplikimi për kredi për mobilim dhe kredia për blerjen e pajisjeve elektroshtëpiake, të dyja kreditë janë marrë në muajin gusht të vitit 2012, janë tregues i momentit kur na është vënë në dispozicion realisht apartamenti pasi vetëm pas dorëzimit të tij, nga ana jonë u vijua me mobilimin e tij për ta bërë atë të jetueshëm ...”.

45.5. Në funksion të argumenteve, subjekti deklaroi se ka qenë gjithmonë transparente duke deklaruar lidhjen e kontratës së sipërmarrjes, pagesat e kryera si në deklaratat vjetore periodike ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, duke theksuar se: “... për sa kohë rezulton të kem qenë transparente në çdo deklaratë nuk do të kishte logjikë që unë të mos deklaroja një pagesë të kryer nëpërmjet sistemit bankar, nëse do ta kisha kryer, veprim i cili është lehtësisht i verifikueshëm”.

45.6. Subjekti këmbëngul se ka vërtetuar që pasuria është blerë brenda çmimit referencë të zonës përkatëse në vlerën 48.000 euro, duke deklaruar se: “... nëse nga ana jonë do të disponohej shuma prej 96.000 euro (e përbërë nga pagesa reale e kryer prej meje prej 48.000 sipas mandatpagesave dhe shumës 48.000 euro pagesë e kryer me anë të falsifikimit pranë BKT-së) nga ana ime do të ishte zgjedhur blerja e një apartamenti në një zonë tjetër, më të preferuar, më afër vendit të punës dhe qendrës, por ndërkohë nga ana jonë nuk ishte e mundur as blerja e një garazhi për automjetin me shumën që dispononim. Përfundimisht, sa më sipër kjo vërtetohet katërcipërisht që çmimi i blerjes së apartamentit në bashkëpronësi është real, i pavesuar dhe i mundshëm nga ana financiare për mundësitë tona”.

45.7. Subjekti pretendon se bashkëshorti i saj e ka fituar pjesën e tij takuese në pasuri me të ardhura para fillimit të bashkëjetesës në gusht të vitit 2012, të ardhura të përfituara pjesërisht prej tij dhe pjesërisht të dhuruara prej prindërve të tij, të krijuara në një periudhë kur sipas saj, marrëdhënia ende nuk kishte filluar dhe palët nuk kishin asnjë lidhje të ndonjë natyre nga ato të parashikuara nga pikat 13 dhe 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Por, pavarësisht qëndrimit të mbajtur se ajo nuk ka përfituar nga ky dhurim dhe pavarësisht pretendimit që prindërit e bashkëshortit nuk duhet të konsiderohen si persona të lidhur për kursimet e tyre të realizuara përpara fillimit të bashkëjetesës dhe, për më tepër, përpara fillimit të detyrës si prokurore, subjekti ka dhënë sqarime dhe dokumente shkresore për sa i është kërkuar nga Komisioni në lidhje me të ardhura të prindërve të bashkëshortit (trajtuar hollësisht në paragrafin 34 e vijues të vendimit).

45.8. Subjekti ka kundërshtuar përfshirjen nga Komisioni si shpenzim në analizën financiare të njoftuar me rezultatet e hetimit administrativ edhe të shumës 48.000 euro, transferuar në llogari të shoqërisë më 8.6.2012, duke kërkuar që si shpenzim për blerjen e pasurisë të përlllogariten vetëm shumat: (i) 8.000 euro, paguar me lidhjen e kontratës së sipërmarrjes datë 12.5.2012; (ii) shuma 39.000 euro, paguar në datën 23.7.2012; dhe (iii) 1.000 euro, paguar në datën 5.1.2015 dhe duke kërkuar nga Komisioni qëpagesa e kryer nëpërmjet dy mandatave pranë BKT-së në vlerën totale 48.000 euro, të konsiderohet nul, absolutisht e pavlefshme dhe të mos llogaritet në analizën financiare dy herë vlera e blerjes së apartamentit.

45.9. Veç sa më sipër, subjekti ka pretenduar se: (i) gjyshërit e saj, H dhe Z.B kanë pasur mjaftueshëm të ardhura për t'i dhuruar shumën prej 1.000.000 lekësh në vitin 2011 me burime nga pensioni, nga aktiviteti tregtar, nga bletërritja dhe toka bujqësore, origjina e krijimit të të cilave daton përpara se ajo të bëhej subjekt deklarues; (ii) prindërit e bashkëshortit, B dhe SH.N, kanë pasur mjaftueshëm të ardhura për t'i dhuruar djalit të tyre

shumat 6.600 euro dhe 1.100.000 lekë, me burim nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral, të krijuara përpara bashkëjetesës së tyre dhe përpara se ajo të bëhej subjekt deklarues. Në përfundim kërkon që këto shuma të konsiderohen të ardhura të ligjshme në analizën financiare.

45.10. Gjithashtu, në lidhje me analizën financiare, subjekti ka pretenduar se udhëtimi për në Romë në vitin 2011 ka qenë për arsye pune dhe, për këtë arsye, nuk duhet përlogaritur në rubrikën “shpenzime” të saj, pasi shpenzimet e udhëtimit janë mbuluar nga Prokuroria e Përgjithshme ndërsa shpenzimet e qëndrimit nga organizatorët. Të njëjtin argument ka paraqitur në lidhje me dy udhëtimet e bashkëshortit GJ.N në vitin 2016, një në Kinë, ku nga Komisioni është llogaritur shpenzimi 1.700 euro dhe një në Egjipt me kosto të llogaritur nga Komisioni në vlerën 1.750 euro, pasi të dy këto udhëtime kanë qenë për arsye pune dhe shpenzimet kanë qenë të paguara nga organizatorët. Për të vërtetuar këto pretendime, subjekti ka paraqitur dokumente shkresore nga institucionet ligjore kompetente.

45.11. Në përfundim, subjekti pretendon se ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për të paguar çmimin e blerjes prej 48.000 euro, nga i cili: 1.000 euro është paguar në datën e lidhjes së kontratës së porosisë datë 12.5.2012, shuma 39.000 euro më 23.7 2012 dhe 1.000 euro më 5.1.2015.

Vlerësimi i Komisionit bazuar në provat e administruara dhe në ligjin e zbatueshëm

Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni çmoi se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës në lidhje me analizën financiare dhe as në lidhje me paqartësitë dhe dyshimet e ngritura sa i takon transfertave bankare të kryera në emër të saj në datën 8.6.2012, në BKT, arsyetuar hollësisht si vijon:

46. Sa i takon pretendimit që pagesat e kryera në datën 8.6.2012, në emër të subjektit, përkatësisht në vlerat 33.150 euro dhe 14.850 euro, në total në shumën 48.000 euro, në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k. nuk janë kryer prej saj, Komisioni nuk e ka vënë në diskutim ndonjëherë këtë fakt dhe, për rrjedhojë, nuk ka vënë në dyshim rezultatin e aktit të ekzaminimit grafik nr. ***, datë 28.1.2022, sipas të cilit, dy shkrimet dhe nënshkrimet në emër të shtetasve Eriselda Bala në dy dokumentet objekt ekspertiminuk janë shkruar nga asnjëri prej dy shtetasve Eriselda Bala apo GJ.N. Ky fakt u vërtetua nga informacioni i paraqitur nga shoqëria “****” sh.p.k., e cila, në të gjitha komunikimet që ka pasur me Komisionin, qoftë nëpërmjet akteve shkresore, qoftë nëpërmjet deklarimeve të përfaqësueses së saj përpara Komisionit, ka pranuar që kjo shumë është derdhur në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k. nga një punonjës i saj, pra jo nga subjekti i rivlerësimit apo bashkëshorti i saj. Në këto kushte, këmbëngulja e subjektit se nënshkrimi në aktet bankare nuk është i saj apo i bashkëshortit të saj dhe, si i tillë, duhet të konsiderohet *nul* nga Komisioni, vlerësohet i panevojshëm, për sa kohë shoqëria e pranoi këtë fakt dhe, për më tepër, ka dhënë sqarime të detajuara në lidhje me pagesat dhe shkaku e kryerjes së tyre.

Nga ana tjetër, subjekti pretendon se nuk e ka autorizuar shoqërinë për derdhjet në bankë në datën 8.6.2012. Ndërkohë është konstatuar se transaksionet e raportuara pranë DPPP-së në datën 8.6.2012 kanë qenë në emër të subjektit të rivlerësimit Eriselda Bala dhe me burim “kursime”. Bazuar në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave, neni 4/1 p. 1/a, si pjesë evigjilencës së duhur, subjekti raportues (në këtë rast banka) duhet të identifikonte klientin dhe të verifikonte identitetin e tij nëpërmjet dokumenteve, të dhënave ose informacioneve nga burime të besueshme. Në këto kushte, mbetet e paqartë se si transaksionet janë kryer nga punonjësi i shoqërisë pa asnjë autorizim nga klienti (në këtë rast subjekti), si dhe fakti që vetëm në këtë rast është bërë gabim, pasi nga ana e shoqërisë nuk u evidentuan raste të ngjashme, kur depozitimi i shumave është kryer prej saj, pa autorizim nga klientët. Për më tepër, mbetet i dyshimtë fakti se janë realizuar dy transaksione të ndryshme në dy degë të

ndryshme të BKT-së nga dy punonjës të ndryshëm të bankës, të cilët të dy nuk kanë përmbushur detyrimet e parashikuara në ligj. Këto paqartësi, si dhe fakti që pagesa është bërë nga një punonjës “i panjohur” i shoqërisë së ndërtimit, së bashku me rrethana të tjera të trajtuara hollësisht në këtë vendim, në lidhje me dy aktet shkresore të titulluara *mandatarkëtim*, apo me mënyrën se si subjekti ka siguruar shumën 39.000 euro në datën 23.7.2012, kur pretendon të jetë likuiduar pjesa më e madhe e çmimit të shitjes, përforcojnë bindjen se ka qenë subjekti që ka autorizuar depozitim në rrugë bankare të shumës prej 48.000 euro në datën 8.6.2012, fakt i pranuar edhe në kontratën e shitjes së pasurisë, sipas së cilës çmimi i shitjes është paguar në llogarinë bankare të palës shitëse.

47. Në parashtrime, ashtu sikurse edhe gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se për dy transfertat e kryera në emër të saj në BKT, në datën 8.6.2012, në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., në total në shumën 48.000 euro, është vënë në dijeni vetëm më 24.1.2022, me anë të e-mail-it bashkëlidhur pyetësorit të tretë, qëndrim i mbajtur edhe në seancën dëgjimore, gjatë së cilës ajo e ka konsideruar të palogjikshëm derdhjen e shumës 48.000 euro nga një punonjës i shoqërisë në emër të saj. Këto deklarime të subjektit vijnë në kundërshtim me kontratën e shitjes me nr. ***, date 26.1.2015, në paragrafin ku përshkruhet çmimi i shitjes së pasurisë prej 48.000 euro, në të cilën përcaktohet shprehimisht se *kjo vlerë është likuiduar nga ana e blerësit në favor të shitësit në llogarinë bankare të këtij të fundit*, kontratë e cila është nënshkruar me vullnetin e lirë të palëve, dhe si e tillë, përbën një provë shkresore me vlerë të pakontestueshme që tregon dijeninë e subjektit për pagesën e çmimit të shitjes prej 48.000 euro, në rrugë bankare. Në këto kushte, pretendimi i subjektit se vetëm në datën 24.1.2022 ka marrë dijeni për kryerjen e pagesës së shumës 48.000 euro në rrugë bankare në emër të saj, është i pabazuar. Për më tepër, subjekti ka qenë në dijeni të faktit se çmimi i shitjes do të likuidohet në rrugë bankare referuar fakteve dhe provave si vijojnë: (i) në informacionin e bërë prezent para Komisionit nga ana e shoqërisë rezultoi se klientëve në çdo rast iu është bërë me dije se pagesa e çmimit të blerjes së pasurive do të bëhet në rrugë bankare, ndonëse shumat mund të depozitoheshin paraprakisht *cash* pranë ambienteve të shoqërisë (trajtuar hollësisht në vijim); (ii) kjo praktikë është materializuar edhe në kontratën e sipërmarrjes më 12.5.2012, ku është përcaktuar se pagesat për likuidimin e çmimit të shitjes (duke përfshirë dhe shumën 8.000 euro) do të shlyhen në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k.⁶⁴.

48. Subjekti, në parashtrime, ka pretenduar se në lidhje me dy pagesat e kryera në emër të saj ka paraqitur kallëzimin penal nr. ***, datë 31.1.2022. Për të vërtetuar këtë pretendim, fillimisht, bashkëlidhur parashtrimeve të datës 30.3.2022, ka paraqitur vërtetimin nr. ***, datë 18.3.2022, me anë të të cilit vërtetohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 15.2.2022, për veprat penale “falsifikim dokumenti” dhe “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, nisur me kallëzim të shtetasës Eriselda Bala dhe çështja është në hetim. Më pas, në datën 1.4.2022, në rrugë elektronike, por edhe fizikisht pranë ambienteve të Komisionit, subjekti ka paraqitur vërtetimin me nr. prot. ***, date 31.3.2022, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, sipas të cilit subjektit i janë vënë në dispozicion kopje të akteve procedurale nga procedimi penal nr. ***, i vitit 2022. Në këto akte nuk rezultoi të jetë bashkëlidhur kallëzimi penal nr. ***, datë 31.1.2022, por nga përmbajtja e vendimit për caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit grafik të shkrimit, rezultoi se shtetasja Eriselda B Bala ka kallëzuar penalisht BKT-në për faktin se nga kjo bankë është konfirmuar përpara Komisionit në lidhje me ekzistencën e dy mandatarkëtimeve në favor të subjektit “****” sh.p.k., në të cilat kallëzuesja pretendon se emri dhe nënshkrimi nuk janë të sajat. E

⁶⁴Kontrata parashikon likuidimin në bankën “Societe Generale Albania”. Në fakt, transfertat janë kryer në BKT, pranë së cilës shoqëria ka pasur llogari bankare ku rezultoi të jenë kryer derdhje të çmimit të blerjes së pasurive edhe nga klientët të tjerë.

pyetur në seancën dëgjimore se *cila është arsyeja që nuk keni kallëzuar direkt shoqërinë për falsifikimin e firmës tuaj pranë bankës*, subjekti i rivlerësimit u përgjigj, *unë kam kallëzuar faktin penal dhe jo personat konkretë*, deklarim që nuk rezulton të jetë i vërtetë, pasi referuar vendimit të sipërpërmendur, kallëzimi i subjektit është konkret në adresë të BKT-së dhe jo në adresë të shoqërisë “****” sh.p.k.

49. Duke qenë përpara faktit të pranuar si nga shoqëria ndërtimore ashtu dhe nga subjekti, se pagesa e shumës prej 48.000 euro është kryer nga një punonjës i shoqërisë në datën 8.6.2012, me qëllim evidentimin e qëllimit të kësaj pagese, përpara një vlerësimi përfundimtar të çështjes, bëhet e domosdoshme një përmbledhje e detajuar e informacionit të paraqitur shoqëria “****” sh.p.k. si vijon:

49.1. Në shkresën datë 20.12.2021, shoqëria, pasi i është referuar mënyrës së likuidimit të çmimit në kontratën e sipërmarrjes me datë 12.5.2012, e cila parashikon se pjesa më e madhe prej 39.000 euro do të likuideohej brenda muajit qershor të vitit 2012, ka bërë me dije se në fakt kjo shumë është paguar nga subjekti në datën 23.7.2012, pa shpjeguar arsyen përse nuk ishte respektuar afati i kontratës së sipërmarrjes. Gjithashtu, shoqëria konfirmon pagesën e kështit prej 1.000 euro, në datën 5.1.2015. Në vijim, shoqëria shprehet se blerësve të apartamenteve u është bërë me dije që pagesa e çmimit të shitjes duhet të ishte realizuar deri në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes, në formën e kërkuar nga ligji, në një nga llogaritë bankare të shoqërisë, pavarësisht faktit se kjo pagesë do të bëhej paraprakisht pranë zyrave të shoqërisë “****” sh.p.k. Kjo për arsye të formës së kërkuar nga ligji për kryerjen e transaksioneve financiare nëpërmjet llogarive bankare.

49.2. Në shkresën me datë 9.2.2022, shoqëria vijon të konfirmojë pagesën e kështit me vlerë 39.000 euro në datën 23.7.2012, pra pas datës 31.6.2012 që kontrata e sipërmarrjes parashikonte, pa u shprehur në lidhje me shkakun përse ka ndodhur kjo, si dhe pagesën e kështit prej 1.000 euro, në datën 5.1.2015. Gjithashtu, në këtë shkresë, duke pranuar pagesën e kryer në vlerën 48.000 euro, në datën 8.6.2012 nga persona të autorizuar prej shoqërisë, shoqëria informon se për shkak të fluksit të punës është bërë një lapsus, duke u shprehur se: *“Kjo ngjarje dhe ky lapsus në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet si ndryshim i çmimit të shitjes, pasi çmimi i shitjes është një i vetëm dhe, konkretisht, 48.000 euro”*. Siç duket qartazi, duke u shprehur për një lapsus, shoqëria le të kuptohet që në emër të znj. Eriselda Bala është depozituar gabimisht shuma prej 48.000 euro, pasi në fakt duhej depozituar shuma 40.000 euro, për shkak se kështi prej 8.000 euro ishte paguar në datën 12.5.2012, kur ishte lidhur kontrata e sipërmarrjes. Po këtë qëndrim shoqëria ka mbajtur edhe në shkresën me datë 24.2.2022.

49.3. Në shkresën datë 9.3.2022, me kërkesë të Komisionit për të paraqitur raste të tjera të ngjashme me rastin e subjektit, si dhe të informonin në lidhje me personin konkret që ka kryer transfertën në BKT, shoqëria informoi se në një situatë pune të ngarkuar është e vështirë të identifikohen raste të tjera të ngjashme me atë të znj. Bala, në të cilën pagesa e çmimit të shitjes të ishte bërë nga ana e shoqërisë (në datën 8.6.2012), pa u likuiduar realisht dhe tërësisht nga ana e palës blerëse. Po kështu, shoqëria bëri me dije se nuk mund të identifikojnë emrin e personit që ka kryer pagesën pranë BKT-së. Gjithashtu, shoqëria informoi se likuidimet e muajit pasardhës bëheshin brenda datës 10 të muajit pasardhës, ku përkatësisht këto janë dhe datat që klientët likuidojnë kështet sipas kontratës, duke u shprehur midis të tjerash seka pasur të nevojshme të kryejë pagesa për të tretë, për këtë arsye ka marrë masa duke bërë qarkullimin e shumës 48.000 euro, në datën 8.6.2012, në mënyrë që ditën e hënë, përkatësisht, në datën 11.6.2022, të likuidonte furnitorët.

49.4. Nga deklaratimet e përfaqësueses së shoqërisë “****” sh.p.k., pyetur nga Komisioni në datën 2.3.2022, në mënyrë të përmbledhur rezultoi se: (i) për herë të parë shoqëria, nëpërmjet përfaqësueses së saj, ka bërë me dije se është njoftuar nga klienti që nuk e kishte të mundur

që ta kryente pagesën në muajin qershor dhe likuidimin do ta bënte më vonë; (ii) në kushte të tilla ishin injektuar/përdorur fonde të shoqërisë nga dividenti i administratorit në vlerën 48.000 euro, për nevoja të shoqërisë; (iii) dokumenti i identifikimit në bankë i përkiste subjektit të rivlerësimit; (iv) sipas një marrëveshjeje me bankën ka ndodhur që pagesat e çmimit të blerjes së pasurive bëheshin nga një punonjës i shoqërisë, duke përdorur kartën ID të klientit blerës.

49.5. Në një analizë tërësore të informacionit të paraqitur nga shoqëria “***” sh.p.k., në përfundim të procesit rezultoi se:

i) Nga shoqëria u pranua praktika e ndjekur, sipas së cilës pagesat e çmimit të shitjeve të apartamenteve pasi paguheshin paraprakisht pranë arkës së shoqërisë nga klientët, mund të depozitoheshin në bankë edhe nga një punonjës i saj dhe, fakt i konformuar në përgjigje të shkresës nr. *** prot., datë 6.12.2021, të Komisionit, me shkresën pa numër protokolli me datë 20.12.2021, ku shoqëria është shprehur se kjo pagesë bëhej paraprakisht pranë zyrave të shoqërisë “****” sh.p.k.

ii) Për rastin konkret, shoqëria “****” sh.p.k. pranoi derdhjen e shumës 48.000 euro nga ana e një punonjësi të shoqërisë në emër të subjektit në qershor të vitit 2012, duke pretenduar se kjo shumë ka qenë me të ardhura të administratorit të shoqërisë/divident dhe për nevoja të shoqërisë, në formën e një huaje që administratori i ka dhënë shoqërisë, të cilën e ka marrë pasi subjekti ka paguar çmimin e shitjes, pretendime të cilat mbeten në nivel deklarativ pasi: (a) nuk vërtetoi veprimin e huadhënies nga ana e administratorit të shoqërisë së shumës 48.000 euro me ndonjë dokument shkresor si bilancin e vitit 2012, ku duhet të ishte pasqyruar veprimi juridik i huamarrjes; (b) nuk vërtetoi kthimin e shumës 48.000 administratorit të shoqërisë, pasi blerësit kishin paguar çmimin e shitjes; (c) nuk u vërtetoi raste të tjera të ngjashme në të cilat pagesa e çmimit të shitjes të ishte bërë nga ana e shoqërisë, pa u likuiduar realisht nga ana e palës blerëse. Për më tepër, shoqëria nuk deklaroi emrin e punonjësit që kishte kryer depozitimin e shumës.

iii) Deklarimi i shoqërisë që derdhja e shumës 48.000 euro, në emër të subjektit, ka qenë një lapsus, pasi në fakt duhet të derdhej shuma 40.000 euro, vlerësohet i pavërtetë, referuar kuptimit të mirëfilltë të fjalës lapsus: *një gabim pa dashje në të shkruarit apo në të folurit për shkaqe shpërqendrimi apo nëndijeje*, si dhe, faktit që punonjësi i shoqërisë me ndërgjegje të plotë kishte marrë paraprakisht nga administratori i shoqërisë shumën 48.000 euro, të cilën e ka depozituar në BKT, në datën 8.6.2012, nëpërmjet dy transfertave bankare. Në këto kushte, deklarimi se derdhja e kësaj shume ka qenë një lapsus, çmohet të jetë kryer nga ana e shoqërisë për të justifikuar pikërisht derdhjen në total të çmimit të shitjes në vlerën 48.000 euro, në datën 8.6.2012, dhe është një fakt më tepër që tregon se pagesa e shumës 8.000 euro nuk ishte kryer me lidhjen e kontratës së sipërmarrjes, datë 12.5.2012, sikurse subjekti pretendon.

50. Sipas përfaqësueses së shoqërisë, subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të paguar çmimin e shitjes brenda qershorit të vitit 2012, fakt që e ka pranuar ndër rreshta dhe subjekti në deklaratimet në përgjigje të pyetësorit nr. 2 (në fakt, në përgjigjet e veta në këtë pyetësor subjekti në mënyrë të pakuptueshme i referohet shtyrjes së afatit në muajin korrik dhe jo në muajin qershor të vitit 2012). Por, si subjekti ashtu edhe shoqëria, nuk vërtetuan me një akt shkresor vullnetin e palëve për të ndryshuar këtë afat. Për të vërtetuar likuidimin e kështit me vlerë 39.000 euro, në datën 23.7.2012, dhe pagesën e kështit prej 1.000 euro, në datën 5.1.2015, subjekti paraqiti dy shkresa të titulluara *mandatarkëtim*, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., përkatësisht në këto data.

Është e vërtetë se mungesa e një akti shkresor që të vërtetonte një marrëveshje të re të palëve për ndryshimin e afatit të pagimit të çmimit të shitjes nuk mund të penalizojë subjektin për shkak se kjo marrëveshje verbale ndodh shpesh në praktikë. Por, në rastin konkret, Komisioni

krijoi bindjen se realisht nuk ka pasur një marrëveshje midis palëve për shtyrjen e afatit të pagimit të këstit me vlerë 39.000 euro dhe se shuma prej 48.000 euro është paguar nga një punonjës i shoqërisë “****” sh.p.k., në datën 8.6.2012, pasi ishte parapaguar nga subjekti i rivlerësimit. Për të krijuar këtë bindje kanë shërbyer faktet dhe rrethanat si vijojnë:

- Pavarësisht titullimit *mandatarkëtimi* konstatohet lehtësisht se këto akte shkresore nuk janë mandatarkëtime të mirëfillta më numër serie dhe në formatin e njohur të tyre, por dy shkresa të printuara dhe të nënshkruara nga shoqëria në datat 23.7.2012 dhe 5.1.2015. Për më tepër, këto dy pagesa nuk janë deklaruar dhe paraqitur nga subjekti në asnjë prej DPV-ve dhe as në dokumentacionin bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, kur subjekti ka paraqitur një numër të konsiderueshëm dokumentesh për të vërtetuar pretendimet e saj, por janë paraqitur për herë të parë gjatë procesit të rivlerësimit.

- Kontrata e shitjes së pasurisë nr. ***, datë 26.1.2015, parashikon që *shitësi deklaron se pronën sa sipër ia shet blerësit kundrejt shumës 48.000 euro, e cila është likuiduar nga ana e blerësit në favor të shitësit në llogarinë bankare të këtij të fundit*, pa përmendur dy shkresat *mandatarkëtime*, lëshuar përkatësisht në datat 23.7.2012 dhe 5.1.2015. Ky deklaram në këtë kontratë që përbën provë shkresore të pakontestueshme, si dhe fakti që në datën 6.8.2012, është paguar në rrugë bankare shuma 48.000 euro dhe jo shuma 40.000 euro, përforcon bindjen se subjekti nuk e ka paguar realisht shumën 8.000 euro, në datën 12.5.2012, kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes dhe se vlera e paguar në rrugë bankare në datën 8.6.2012 prej 48.000 euro ka qenë pikërisht për blerjen e pasurisë objekt verifikimi, ndonëse derdhja nuk është bërë nga subjekti, por nga një punonjës i shoqërisë. Për më tepër, kontrata e porosisë parashikon se shuma 8.000 euro do të likuidohet menjëherë me firmosjen e kësaj kontrate dhe nuk ka parashikuar se kjo shumë është likuiduar me nënshkrimin e kësaj kontrate. Lidhëza *do të* tregon që veprimi do të kryhej në të ardhmen dhe, në këtë rast, vërtetimi i pagesës së këstit prej 8.000 euro, do të bëhej i besueshëm nëpërmjet një dokumenti bankar apo një mandatarkëtimi. Akoma më tej, pretendimi i subjektit mbështetur edhe nga shoqëria se shuma 8.000 euro është likuiduar *cash* ditën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, bie në kundërshtim me vetë parashikimin në këtë kontratë, sipas së cilës çmimi i shitjes, duke përfshirë edhe këstin me vlerë 8.000 euro, do të likuidohej në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., si dhe me praktikën e ndjekur dhe orientimin e shoqërisë ndërtimore, e cila kishte paralajmëruar klientët që likuidimi i çmimit të blerjes do të bëhej në rrugë bankare.

- Subjekti është kontradiktor në deklarime, pasi në përgjigje të pyetësorëve 2 dhe 3 është shprehur se veprimet, në lidhje me pagesën e vlerës së apartamentit, janë kryer në përputhje të plotë me detyrimin kontraktor të përcaktuar në nenin 4 të kontratës së sipërmarrjes me datë 12.5.2012, ndërkohë që ka paraqitur si provë shkresore mandatarkëtimin me datë 23.7.2012, i cili vërteton një mënyrë të ndryshme të likuidimit të këstit prej 39.000 euro nga ajo e parashikuar në kontratën e sipërmarrjes, e cila parashikon se ky këst do të paguhet brenda muajit qershor të vitit 2012.

51. Në parashtrime, subjekti, duke iu referuar datave të tërheqjeve të depozitave bankare prej saj dhe bashkëshortit pas datës 8.6.2012, për shumën në total prej rreth 3.900.000 lekësh (shihni deklaramet e detajuara në paragrafin 46.3 më sipër), i konsideron këto pagesa si një argument për të vërtetuar që kësti i dytë prej 39.000 euro është kryer në muajin korrik dhe sipas saj, nuk mundet kurrsesi të ishte kryer e gjithë pagesa në datën 8.6.2012 kur pjesa më e madhe e parave janë tërhequr nga banka pas datës 8.6.2012. Në analizë të këtij pretendimi, nëse shihet tërheqja e depozitave nga bashkëshorti i subjektit dhe prindërve të tij, të pretenduara nga subjekti se janë përdorur për pagimin e shumës 39.000 euro në korrik të vitit 2012, vërehet se: (i) bashkëshorti i subjektit ka tërhequr shumën 4.000 USD, më 20.7.2012, nga një llogari që ka qenë rrjedhëse, pra ai ka pasur mundësinë që ta tërhiqte këtë shumë brenda muajit qershor të vitit 2012; (ii) në datën 15.6.2012 prindërit e bashkëshortit kanë

tërhequr shumën 6.607 euro nga një depozitë në euro dhe shumën 1.109.000 lekë nga një depozitë në lekë. Të dyja këto depozita kanë qenë me datë maturimi 28.10.2012 dhe janë prishur në datën 7.5.2012, pra brenda muajit qershor të vitit 2012. Siç vërehet, bashkëshorti i subjektit dhe prindërit e tij e kanë pasur të gjithë mundësinë e tërheqjes së shumave të sipërpërmendura brenda datës 8.6. 2012, çka e bën jo të besueshëm pretendimin e subjektit se tërheqjet pas datës 8.6.2012, duhet të merren si një provë se janë përdorur për blerjen e pasurisë objekt verifikimi.

52. Veç sa më sipër, gjatë hetimit administrativ është konstatuar se si burim për të paguar shumën 39.000 euro, në datën 23.7.2012, përveç depozitave të sipërpërmendura, subjekti ka deklaruar se ka përdorur edhe shumat në vijim:

i) shumën 1.000.000 lekë, dhuratë nga prindërit B dhe V.B, shumë kjo e tërhequr prej nënës së subjektit V.B nga llogaria e saj në “ProCredit Bank” në datën 5.10.2012, pra, disa muaj pasi është pretenduar të jetë paguar shuma prej 39.000 euro, në datën 23.7.2012. Subjekti ka deklaruar se me qëllim që nëna e saj të mos prishte interesat në këtë datë, këtë shumë ia kanë marrë hua shtetasit V.L, duke e përdorur për të paguar këstin e datës 23.7.2012 dhe në momentin që është maturuar depozita e nënës, ajo i ka tërhequr fondet e saj në datën 5.10.2012 dhe ia ka dhënë shtetasit V.L;

ii) shumën 1.000.000 lekë, hua nga motra E.B, shumë e tërhequr nga llogaria e saj në “Union Bank” më 9.11.2012, pra, disa muaj pas pagesës së shumës prej 39.000 euro, në datën 23.7.2012. Subjekti ka deklaruar se me qëllim që motra të mos prishte interesat, këtë shumë ia ka marrë hua shtetasit V.L, të cilën ia ka kthyer pasi motra tërhoqi lekët në datën 9.11.2012, kur është maturuar depozita.

52.1 Siç vërehet, në momentin e pagesës së pretenduar në datën 23.7.2012, të shumës 39.000 euro, subjekti nuk i ka pasur shumat e dhuruara dhe dhënë hua, përkatësisht nga prindërit dhe motra e saj, në vlerën prej 1.000.000 lekësh/secila palë, por ka deklaruar: *“Çmuj me rëndësi t’ju sqaroj se kontributi i prindërve të mi dhe motrës sime E.B për blerjen e apartamentit janë bërë në kohë reale, pra në muajin korrik kur unë kisha nevojë. Në atë kohë në fillim u vendos nga unë dhe bashkëshorti (atë kohë i fejuari) që t’i kërkonim shoqërisë sipërmarrëse një shtyrje të afatit të kësteve, por prindërit dhe motra menduan që të na ndihmonin duke kërkuar një ndihmë të përkohshme hallës dhe bashkëshortit të saj. Për këtë kanë huazuar një shumë parash prej shtetasit V.L (bashkëshorti i hallës), deri në maturimin e depozitave të tyre me afat. Me tërheqjen e depozitave të tyre bankare, ato i janë kthyer bashkëshortit të hallës. Kjo hua është marrë jo vetëm për një periudhë shumë të shkurtër kohore, por edhe mbi bazën e marrëdhënieve shumë të mira familjare mes nesh dhe hallës e bashkëshortit të saj”*.

Pretendimi i subjektit se kontributi i dhënë nga prindërit dhe motra në formë dhurimi dhe huaje kanë qenë në kohë reale duke e ndihmuar për pagimin e shumës 39.000 euro, në korrik të vitit 2012, është i pavërtetë, pasi nevoja reale e subjektit ka qenë brenda muajit qershor të vitit 2012 sipas parashikimit të kontratës së sipërmarrjes.

52.2. Sa i takon dy huave të mara përkatësisht nga prindërit dhe motra e subjektit prej shtetasit V.L, për të mundësuar dhurimin dhe huazimin e dy shumave prej 1.000.000 lekësh subjektit në datën 23.7.2012, është e vërtetë se jo në çdo rast huat e marra prej subjekteve nga familjarë të tyre janë dokumentuar me akte shkresore për shkak të marrëdhënieve të posaçme familjare. Por, në rastin konkret, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni krijoi bindjen se huat e pretenduara të dhëna nga shtetasi V.L përkatësisht prindërve dhe motrës së subjektit, nuk kanë shërbyer për pagimin e kështit 39.000 euro në datën 23.7.2012, në vlerësim të rrethanave si vijojnë:

i) Ndërkohë që ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë objekt verifikimi dy shuma prej 1.000.000 lekësh, të dhuruara dhe huazuara përkatësisht nga prindërit dhe motra, të cilët nuk i ka disponuar në momentin e likuidimit të kështit prej 39.000 euro, subjekti nuk ka dhënë

sqarime në lidhje me huat e marra nga shtetasi V.L në deklaratën *Vetting*, të cilat, sipas variantit të paraqitur prej saj, kanë shërbyer si burim real për pagesën e shumës 39.000 euro, në datën 23.7.2012.

ii) Mbetet e paqartë dhe e pakuptueshme përse subjekti nuk ka marrë personalisht hua në vlerën 2.000.000 lekë prej shtetasit V.L brenda qershorit të vitit 2012, për të paguar këstin prej 39.000 euro, siç parashikon kontrata e sipërmarrjes (apo edhe në muajin korrik të vitit 2012, kur subjekti pretendon të jetë kryer pagesa prej 39.000 euro), përderisa prindërit dhe motra e saj nuk mund të prishnin depozitat, përkatësisht, përpara datave 5.10.2012 dhe 9.11.2012. Për më tepër, bashkëshorti i subjektit ka pasur mundësinë e tërheqjes së shumave të deklaruara të paguara prej tij që në muajin qershor të vitit 2012 (arsyetuar më sipër).

iii) Në mënyrë të përsëritur gjatë hetimit administrativ, për të dyja pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, për të justifikuar shpenzime për të cilat nuk ka pasur mundësi financiare në momentin e kryerjes së pagesave, subjekti ka deklaruar si burime vlera të marra hua nga shtetasi V.L, për të cilat në asnjë rast nuk ka kryer deklarime si në DPV ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, kur subjektet kanë pasur mundësinë dhe detyrimin për të paraqitur një deklaratë të detajuar të interesave pasurore, çka hedh dritë mbi dyshimin se kjo është një përpjekje për të justifikuar shpenzime të pajustificuara financiarisht, të kryera prej saj.

53. Pretendimi i subjektit, sipas të cilit, pjesa takuese e bashkëshortit të saj është përfituar me të ardhura të krijuara para bashkëjetesës dhe aq më tepër përpara se të ishte subjekt deklarues, nuk qëndron pasi pasuria objekt verifikimi në bashkëpronësi me bashkëshortin është pasuri e deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, duhet të vërtetohen burimet e ligjshme për krijimin e saj dhe, për më tepër, pasuria është porositur gjatë periudhës që subjekti ka qenë në detyrë.

54. Përkundër sa deklaron subjekti se ka qenë gjithmonë transparente në deklarimet e saj, Komisioni evidentoi mungesë deklarimesh të plota në lidhje me burimet e krijimit të pasurisë, pasi vërehet se në çdo deklarim subjekti i është referuar burimit të pjesës së saj takuese. Ndërkohë që bashkëshorti i subjektit ka kryer deklarime të burimeve të pjesës së tij takuese vetëm në deklaratën *Vetting*, mbeten të paqarta dhe të padeklaruara burimet e pjesës takuese të bashkëshortit në deklaratat periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, deklarimi si burim i krijimit të pasurisë i dy shumave prej 1.000.000 lekësh, dhuruar dhe dhënë hua përkatësisht nga prindërit dhe hua nga motra, në një kohë që si dhuruesit dhe huadhënësja nuk i dispononin këto shuma në momentin e pagesës së këstit prej 39.000 euro, si dhe shpjegimet gjatë procesit se si burim për shumën e dhuruar dhe dhënë hua në total prej 2.000.000 lekësh, kanë qenë dy hua të tjera që dhuruesit dhe huadhënësja morën nga një person i tretë, pa dhënë asnjë sqarim dhe deklarim për këto hua si në DPV ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, vlerësohen nga Komisioni si mungesë transparence në deklarime nga subjekti.

55. Sa i takon pretendimit se çmimi i shitjes është paguar në pjesën më të madhe (39.000 euro) në datën 23.7.2012, subjekti ka sjellë si argument faktin se: *“Në kontratën e sipërmarrjes ishte parashikuar fakti se dorëzimi i çelësave të apartamentit do të bëhej në momentin e pagesës së këstit të dytë. Nga provat e dorëzuara prej meje rezulton se pagesa prej 39.000 euro është kryer më 23.7.2012, ndërkohë që procesverbali i dorëzimit të çelësave është bërë një ditë më vonë, më 24.7.2012”*. Në analizë të këtij pretendimi, Komisioni çmon se procesverbali i dorëzimit të çelësave të apartamentit më 24.7.2012, përveç faktit se nuk ka ndonjë vlerë të posaçme për të vërtetuar pretendimet e subjektit përballë provave të tjera të administruara gjatë hetimit administrativ, nuk rezulton të jetë përmendur dhe as të jetë pjesë përbërëse e kontratës së shitjes, çka të krijon dyshimin se është përpiluar pikërisht për efekt të procesit të rivlerësimit. Gjithashtu, Komisioni e vlerëson pa rëndësi faktin që subjekti ka marrë dy kredi në muajin gusht të vitit 2012, të cilat jo domosdoshmërisht tregojnë se

likuidimi i shumës prej 39.000 euro është kryer në korrik të vitit 2012, sikurse subjekti pretendon.

Veç sa më sipër, në përfundim të procesit të rivlerësimit, nga Komisioni vlerësohet se çdo argument tjetër i parashtruar nga subjekti që nuk është analizuar hollësisht në këtë vendim, ka qenë përpjekje e pasuksesshme për të vërtetuar pretendimet e veta, përballë provave, fakteve e rrethanave, të rezultuara gjatë gjithë këtij procesi.

Vlerësim përfundimtar në lidhje me apartamentin e banimit objekt verifikimi, me nr. pasurie *, Tiranë**

56. Bazuar në të gjitha sa është arsyetuar më sipër, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes dhe pas një hetimi shterues, përtej çdo dyshimi, Komisioni nuk administroi asnjë provë dhe të dhënë që hedh dritë mbi dyshimin e blerjes së një apartamenti tjetër, veç atij të deklaruar nga subjekti dhe bashkëshorti i saj, pranë shoqërisë “****” sh.p.k.

57. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni krijoi bindjen se çmimi i blerjes së pasurisë apartament banimi me nr. ***, prej 48.000 euro, është likuiduar në datën 6.8.2012 (ndonëse transfertat bankare janë kryer nga një punonjës i shoqërisë “****” sh.p.k.) dhe jo sipas pretendimeve të subjektit se 1.000 euro janë paguar në datën e lidhjes së kontratës së porosisë datë 12.5.2012, 39.000 euro më 23.7.2012 dhe 1.000 euro më 5.1.2015, fakt që afekton analizën financiare përfundimtare të kryer me qëllim vërtetimin e blerjes së pasurisë me të ardhura të ligjshme.

58. Për të arritur në këtë përfundim, Komisioni është bazuar në provat e renditura në mënyrë të përmbledhur si vijojnë:

i) Kontrata e sipërmarrjes datë 12.5.2012 vërteton se çmimi i shitjes do të likuidohet brenda muajit qershor të vitit 2012 (kësti i tretë në shumën 1.000 euro do të likuidohet me nënshkrimin e kontratës së shitjes) dhe se likuidimi do të bëhet në rrugë bankare në llogari të shoqërisë ndërtimore.

ii) Kontrata e shitjes me akt noterial më 28.1.2015 vërteton se çmimi i shitjes së pasurisë prej 48.000 euro është likuiduar nga blerësit në favor të shitësit në llogarinë bankare të këtij të fundit.

iii) Dy transfertat bankare të datës 8.6.2012, në emër të subjektit të rivlerësimit, konkretisht: 33.150 euro, me përshkrim veprimi “Eriselda Bala, derdhje në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k.” dhe 14.850 euro, me përshkrim veprimi “Eriselda Bala, derdhje në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k. për këst blerjeje apartamenti” vërtetojnë kalimin në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k. në BKT, të shumës 48.000 euro, e cila përkon me çmimin e shitjes së parashikuar në kontratën e sipërmarrjes dhe atë të shitjes, si dhe me mënyrën e likuidimit të çmimit të shitjes, parashikuar në të dyja këto kontrata.

iv) Dy raportimet e kryera në DPPPP nga BKT-ja, në përshkrimet e veta përcaktojnë burimin e transfertave, konkretisht: për shumën 14.850 euro figuron përshkrimi “Eriselda Balla, derdhje në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k. për këst blerjeje apartamenti, burimi i të ardhurave: të ardhura nga kursimet” dhe për shumën 33.150 euro figuron përshkrimi “Eriselda Bala, derdhje në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., burimi i të ardhurave: “kursime”. Burimi i të ardhurave në këto përshkrime, përputhet në thelb me burimin e të ardhurave të deklaruar nga subjekti, përdorur për blerjen e pasurisë objekt verifikimi që janë: kursime të saj, të bashkëshortit, të prindërve të tyre, të gjyshërve dhe të motrës.

v) Nuk u vërtetua likuidimi i çmimit të shitjes me tri këste dhe jo në rrugë bankare sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, pasi sikurse është arsyetuar hollësisht në këtë vendim, kontrata e sipërmarrjes me datë 12.5.2012, nuk vërteton likuidimin e shumës 8.000 euro në këtë datë, ndërsa shkresat e titulluara *mandatarkëtimi* me data 23.7.2012 dhe 5.1.2015,

paraqitur nga subjekti vetëm gjatë hetimit administrativ, nuk përbejnë prova shkresore që vërtetojnë likuidimin *cash* të shumës 40.000 euro në këto data dhe, për më tepër këto akte shkresore nuk konkurrojnë me provat shkresore të sipërpërmendura. Përveç kësaj, përpilimi i këtyre shkresave vlerësohet nga Komisioni si një përpjekje e shoqërisë për të justifikuar pretendimet e subjektit, bindje e cila përforcohet edhe me mungesën e një kallëzimi penal të subjektit në adresë të shoqërisë “****” sh.p.k., që prej vitit 2015, kur u nënshkrua kontrata e shitjes, e cila parashikonte që çmimi i shitjes ishte paguar në rrugë bankare, kallëzim i cili nuk rezulton të jetë bërë edhe në vijim.

vi) Nuk u vërtetua që pagesa e shumës 48.000 euro, në datën 8.6.2012, të jetë kryer për nevoja të shoqërisë “****” sh.p.k. me të ardhura të administratorit të saj, dhënë prej tij në formë huaje, pa u paguar realisht tërësisht çmimi i blerjes nga ana e blerësve të pasurisë. Përkundrazi, provat shkresore të sipërpërmendura dhe faktet e argumentet kundër pretendimit të subjektit në lidhje me pagimin e kësteve jo në rrugë bankare, arsyetuar hollësisht në këtë vendim, janë në harmoni të plotë me praktiken e ndjekur nga ana e shoqërisë “****” sh.p.k., sipas së cilës kalimi i çmimit të shitjes së pasurive bëhej në rrugë bankare në llogari të shoqërisë nga një punonjës i shoqërisë, pasi blerësit kishin paguar paraprakisht shumën përkatëse pranë shoqërisë.

vii) Pretendimi i subjektit se pagesa e pjesës më të madhe të çmimit prej 39.000 euro nuk është kryer për shkak të pamundësisë financiare për të paguar këtë vlerë brenda muajit qershor të vitit 2012, bëhet i pabesueshëm në kushtet kur nuk u vërtetua që deri në datën 23.7.2012 kur pretendohet të jetë paguar kjo shumë, subjekti të ketë marrë ndonjë kredi apo të ketë përfiturar të ardhura nga shitja e ndonjë pasurie apo burime të tjera të ligjshme. Përkundrazi, ashtu sikurse u arsyetua hollësisht me sipër në këtë vendim, u vërtetua plotësisht se në datën 23.7.2012 subjekti ka qenë në të njëjtën situatë financiare ashtu sikurse edhe gjatë muajit qershor të vitit 2012 dhe se mënyra se si subjekti ka siguruar shumën 39.000 euro nuk e justifikon shtyrjen e afatit të likuidimit të saj.

59. Për këto arsye, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, nga ana Komisionit, me ndihmën e Njesisë së Shërbimit Ligjor, është kryer analiza financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit dhe bashkëshortit të saj, për të paguar çmimin e shitjes në datën 8.6.2012, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese, nga e cila rezulton se nuk justifikojnë blerjen e pasurisë me të ardhura të ligjshme për shkak të një balance negative në vlerën 5.674.731 lekë.

Nr.	Përshkrimi	Datë 8.6.2012
1	TË ARDHURA	753,393
	Të ardhura nga paga subjekti	399,516
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	353,877
2	SHPENZIME	150,654
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	120,654
	Shpenzime qiraje	30,000
3	PASURI	6,277,470
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Apartament më sip. 91.09 m ² (48.000 euro)	6,648,480

	<i>Ndryshim likuiditeti</i> ⁶⁵	-371,010
	DIFERENCA (1-2-3)	-5,674,731

Në këtë analizë nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat nga burimet e deklaruara nga subjekti pas datës 8.6.2012 si: (i) tërheqja nga depozita e saj në shumën 1.438.712.4 lekë, më 22.6.2012; (ii) tërheqja e bërë nga bashkëshorti në shumën 4.000. USD, më 20.7.2012; (iii) tërheqjet në datën 15.6.2012 nga prindërit e bashkëshortit të shumave 6.607 euro nga një depozitë në euro dhe shumën 1.109.000 lekë nga një depozitë në lekë. Në një qasje garantiste ndaj subjektit, në këtë analizë është konsideruar si e ardhur e ligjshme likuiditeti *cash* i shumës 500.000 lekë, në fund të vitit 2011 i bashkëshortit të subjektit, ndonëse ky burim nuk është deklaruar në DPV, por është deklaruar vetëm në deklaratën *Vetting*.

60. Veç sa më sipër, në analizë të çdo prove e rrethane, të rezultuara nga hetimi administrativ, dhe sidomos në kushtet kur u vërtetua mungesa e burimeve financiare për të justifikuar likuidimin e shumës 48.000 euro, në datën 8.6.2012, Komisioni çmoi se deklaratimet e subjektit në lidhje me burimet e krijimit të pasurisë si në DPV dhe në deklaratën *Vetting*, janë jo vetëm të pasakta, por edhe të rreme. Sa i takon pretendimit të subjektit se *për sa kohë rezultojn të kem qenë transparente në çdo deklaratë nuk do të kishte logjikë që unë të mos deklaroja një pagesë të kryer nëpërmjet sistemit bankar, nëse do ta kisha kryer, veprim i cili është lehtësisht i verifikueshëm ...*, përveç faktit të arsytuar hollësisht më sipër në këtë vendim se subjekti nuk ka qenë transparente në deklaratimet e saj, nga Komisioni çmohet se mungesa e deklarimeve në lidhje me transaksionet bankare të kryera më 8.6.2012 ka qenë pikërisht për shkak se subjekti nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme shumën 48.000 euro, paguar në këtë datë dhe, për më tepër, subjekti ka qenë plotësisht e ndërgjegjshme që dy transfertat nuk jenë kryer prej saj.

61. Në rubrikën “detyrime financiare” të deklaratës *Vetting*, subjekti ka deklaruar:

61.1. Hua në vlerën 1.000.000 lekë, marrë motrës E.B, me qëllim blerjen e apartamentit. Në lidhje me këtë hua rezultoi se: (i) subjekti e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2012, në rubrikën “detyrime financiare”; (ii) në DPV-të e viteve 2013 dhe 2014 nuk ka kryer deklarime në lidhje me këtë detyrim financiar; (iii) në DPV-në e vitit 2015 e në vijim e ka deklaruar këtë detyrim financiar në vlerën 1.000.000 lekë; (iii) në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka deklaruar se e ka shlyer tërësisht këtë detyrim⁶⁶.

Siç vërehet, subjekti ka kryer deklarime të pasakta në DPV-të e viteve 2013 dhe 2014, pasi nuk ka deklaruar detyrimin financiar sipas detyrimit ligjor të parashikuar në ligjin nr. 9049/2003, i ndryshuar. Është e vërtetë që mungesa e deklarimeve në DPV për këto vite, mund të jetë një harresë nga subjekti, referuar edhe faktit që ky detyrim financiar është deklaruar në DPV-në e vitit 2015 e në vijim. Por, nga vëzhgimi i DPV-ve vërehet se, ndërsa mungon të ketë kryer deklarime në lidhje me detyrimin financiar ndaj motrës së saj E.B në DPV-të e viteve 2013 dhe 2014, subjekti ka kryer deklarime të sakta në lidhje me dy kredi konsumatore të marra në vitin 2012, duke deklaruar saktësisht përkatësisht shlyerjen e kësteve takuese, si dhe detyrimin e mbetur në DPV-të për vitet 2012 dhe 2013, e duke vijuar

⁶⁵Vjen si diferencë e gjendjes së likuiditeteve në datën 8.6.2012 dhe më 31.12.2011, referuar të dhënave bankare. Në datën 31.12.2011 gjendja ka qenë në vlerën 3.522.283.24 lekë, ndërsa në datën 8.6.2012 është në vlerën 3.151.273.34 lekë.

⁶⁶Nga të dhënat bankare të “Raiffeisen Bank” rezultoi se në datën 31.12.2018, shtetasja Eriselda Bala kalon me transfertë nga llogaria e saj në atë të motrës E.B, shumën 100.000 lekë; në datën 16.12.2019, shtetasja Eriselda Bala kalon me transfertë nga llogaria e saj në atë të motrës E.B, me përshkrimin “kthim huaje motrës kursime nga paga” shuma 500.000 lekë; më 18.9.2020, shtetasja Eriselda Bala kalon me transfertë nga llogaria e saj në atë të motrës E.B, me përshkrimin “shlyerje huaje” shuma 400.000 lekë.

me vitin 2014, kur ka deklaruar shlyerjen përfundimtare të detyrimeve financiare dhe gjendjen 0 (zero) të tyre. Në këto kushte, mungesa e deklarimit të detyrimeve financiare për shkak të huas objekt verifikimi në DPV-të e viteve 2013 dhe 2014, e bëjnë të pabesueshme një harresë të mundshme nga subjekti, duke i bërë këto deklarime të pasakta në kuptim të ligjit dhe nga ana tjetër, i bëjnë të dyshimta deklarimet dhe veprimet e mëvonshme të subjektit të rivlerësimit. Për më tepër, nga analiza financiare e viteve 2013 dhe 2014, vite në të cilat subjekti nuk e ka deklaruar detyrimin financiar, subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të mundësuar shlyerjen e huas me të ardhura të ligjshme. Pavarësisht se subjekti nuk i janë kërkuar sqarime gjatë procesit në lidhje me pasaktësitë në DPV-të e viteve 2013 dhe 2014, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni nuk mund të anashkalonte rrethanat e sipërpërmendura, të cilat i ka mbajtur në konsideratë në procesin e vendimmarrjes, duke i vlerësuar në raport me rrethana të tjera të evidentuara në përfundim të këtij procesi, që kanë lidhje me kriterin pasuror.

61.2. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Detyrim ndaj *** për ruajtjen e qelizave staminale të lindjes së fëmijës E.N. Detyrimi fillestar 2.550 euro. Janë paguar dy këste. Detyrim për t’u shlyer me këste deri më 2.5.2017. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur pa shlyer 1.533,32 euro*”. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁶⁷. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë detyrim në DPV-në e vitit 2016 dhe se deklarimet e subjektit përputhen me dokumentacion e administruar nga Komisioni.

62. Në rubrikën “të dhëna konfidenciale të deklaratës *Vetting*”, subjekti ka kryer të njëjtin deklaram ashtu si edhe për detyrimet financiare.

Deklarimi i pasurive të bashkëshortit të subjektit, GJ.N

63. Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “*Apartament me sipërfaqe 91.09 m², i ndodhur në *** , apartamenti ku aktualisht banoj, i blerë në shumën 48.000 euro, me anë të kontratës së shitjes nr. *** , datë 28.1.2016, e regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të pasurive të paluajtshme nr. pasurie *** , në bashkëpronësi me bashkëshorten Eriselda Bala. Kjo pasuri është trajtuar hollësisht në paragrafin 22 e vijues të këtij vendimi.*”

64. Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “*Depozitë bankare nr. *** , datë 1.12.2010, pranë ‘Raiffeisen Bank’. Vlera: 11.077,75 USD. Pjesa takuese: 100%*”. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁶⁸. “Raiffeisen Bank”⁶⁹ ka konfirmuar se bashkëshorti i subjektit GJ.N ka depozitë me gjendje në datën 26.1.2017, në vlerën 11.077,75 USD, pra, deklarimi i bashkëshortit të subjektit është i saktë. Edhe pse kjo depozitë daton në kohën kur subjekti ishte beqare, Komisioni e ka analizuar dhe nuk i kanë rezultuar problematika.

65. Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “*Kontratë llogari rrjedhëse nr. *** , datë 28.1.2016, pranë ‘Raiffeisen Bank’. Gjendje 84.368.78 lekë. Pjesa takuese: 100 %*”. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁷⁰. “Raiffeisen Bank”⁷¹ ka konfirmuar se bashkëshorti i subjektit GJ.N ka llogari rrjedhëse me gjendje në datën 26.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, në vlerën 84.368,78 lekë. Deklarimi i bashkëshortit të subjektit është i saktë.

⁶⁷Dokument lëshuar nga shoqëria “****” në favor të familjes N.B, datë 23.11.2016, në shumën 250 euro dhe datë 25.11.2016, në shumën 2.300 euro; skema e shlyerjes së detyrimit ndaj shoqërisë “****” (Aneks nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁶⁸Nxjerrje llogarie në emër të shtetasit GJ.N në “Raiffeisen Bank”, gjatë periudhës 1.12.2010 – 21.1.2017. Gjendja në llogari në shumën 11.075 USD (Aneks nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁶⁹Shkresë nr. *** prot., datë 14.5.2020.

⁷⁰Formë autorizimi për pagesa periodike nga llogaria rrjedhëse e shtetasit GJ.N të shumës 20.000 lekë/muaj, afat 2 vjet, në llogari tjetër me përfitues GJ.N, në “Raiffeisen Bank”; kontratë llogari rrjedhëse në emër të shtetasit GJ.N në “Raiffeisen Bank”; nxjerrje e llogarisë në emër të shtetasit GJ.N në “Raiffeisen Bank”, me gjendje në vlerën 84.368 lekë (Aneks nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁷¹Shkresë nr. *** prot., datë 14.5.2020.

66. Në rubrikën “detyrime financiare” të deklaratës *Vetting*, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar:

66.1. Detyrim ndaj shoqërisë “***” për ruajtjen e qelizave staminale të lindjes së fëmijës E.N me detyrim fillestar në vlerën 2.550 euro dhe janë paguar dy këste. Detyrim për t’u shlyer me këste deri më 2.5.2017 dheshuma e detyrimit financiar që ka mbetur pa shlyer 1.533,32 euro (trajtuar në paragrafin 61.2).

66.2. Detyrim ndaj “Raiffeisen Bank”. Gjendja në llogari (*overdraft*) -6.333.79 lekë. “Raiffeisen Bank”⁷² ka konfirmuar se bashkëshorti i subjektit GJ.N ka llogari me gjendje në datën 25.1.2017, në vlerën -6.333,79 lekë. Deklarimi ibashkëshortit të subjektit ishte i saktë.

67. Nga korrespondenca e Komisionit me institucionet publike⁷³ si, AMF, Policia e Shtetit (për hyrje-daljet) dhe Ministria e Drejtësisë (për regjistrin noterial), trupi gjykues ka konkluduar se nuk kanë rezultuar problematika apo dyshime për përdorim automjetesh, dalje në sistemin *TIMS* me mjete të padeklaruara apo kontrata të nënshkruara pranë noterit publik nga dhe në adresë të subjektit të rivlerësimit.

Vlerësim përfundimtar në lidhje me kriterin pasuror

68. Në konkluzion të rivlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit Eriselda Bala ka kryer:

i) Deklarime të pasakta dhe jo nëpërputhje me ligjin të burimit të krijimit të pasurive, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Sa i takon mungesave dhe pasaktësisë në deklaratat periodike vjetore, arsyetuar hollësisht në këtë vendim, referuar fakteve: (a) mungesës së deklarimeve nga subjekti ashtu edhe nga bashkëshorti i saj të burimit të krijimit të ½ pjesë takuese të pandarë të bashkëshortit në pasurinë apartament banimi, si dhe (b) deklarimit në mënyrë të përsëritur se, si burime krijimi për të dyja pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting* kanë shërbyer të ardhura të cilat subjekti nuk i ka disponuar në momentin e kryerjes së pagesave, në mungesë të deklarimeve dhe sqarimeve në lidhje me burimin real të të ardhurave që kanë shërbyer për këto pagesa, në përfundim të procesit Komisioni çmoi se ato marrin një peshë specifike në vendimmarrje, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit, tashmë të konsoliduar, sipas së cilës:

*“[...] Deklarata *Vetting* nuk është dokumenti i vetëm i mjaftueshëm për vendimmarrjen e Komisionit[...]*⁷⁴.

*“[...] Rivlerësimi nuk mund të bëhet pa bazë krahasimore mes deklarimeve periodike dhe deklarimit të pasurisë *Vetting* 2017. Ballafaqimi i deklarimeve periodike me atë të bërë për efekt të deklaratës *Vetting* në vitin 2017, u jep mundësi institucioneve të rivlerësimit për të arritur në përfundimin nëse është bërë deklarim i saktë ose i pasaktë i pasurisë, është bërë ose jo fshehje e kësaj pasurie, nëse është i justifikuar burimi i të ardhurave dhe i pasurisë së dekluar etj., të vendimeve të marra prej tij [...]*⁷⁵.

“[...] Dispozitat ligjore që rregullojnë vlerën e deklarimeve të bëra në deklaratat periodike dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit janë neni Ç, pika 4 dhe neni D i Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 30, 32 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016. Sipas përcaktimeve të neneve të sipërcituara, si Kushtetuta, edhe ligji, kanë parashikuar shtrirjen e procesit të rivlerësimit

⁷²Shkresë nr. *** prot., datë 14.5.2020.

⁷³E-mail datë 26.5.2020 nga AMF-ja, shkresë nr.*** prot., datë 11.5.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si dhe shkresë nr. *** prot., datë 8.5.2020, nga Ministria e Drejtësisë.

⁷⁴Vendimi nr. ***, nr. 7/2018.

⁷⁵Vendimi nr. ***

edhe në shqyrtimin e deklarimeve periodike të pasurisë, të kryera në të shkuarën nga subjektet e rivlerësimit, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha sesa 2 mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur [...]»⁷⁶.

[...] Trupi gjykues i Kolegjit të Apelimit vlerëson se pavarësisht se është e vërtetë që objekti i vlerësimit të pasurisë nga Komisioni është deklarimi i pasurive që i përkasin subjektit të rivlerësimit në momentin e deklaratës Vetting (ex nunc), deklaratimet periodike duhet të merren në konsideratë si prova në këtë vlerësim, për shkak se ato mund të hedhin dritë mbi burimet e krijimit të pasurisë dhe, në këtë mënyrë, edhe mbi ligjshmërinë e pasurisë»⁷⁷.

ii) Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të blerëpasurinë apartament banimi, sipas parashikimit të germës“b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, për shkak të një balance negative prej 5.674.731 lekësh.

iii) Ka kryer deklarime tërreme të burimit të krijimit të pasurisë apartament banimi, sipas parashikimit të germës“ç”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin pasuror, që sipas parashikimit të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, është shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Kontrolli i figurës

69. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte, nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 27.10.2017, mbi kontrollin e figurës, për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. 303, datë 27.10.2017, të KDZH-së, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Eriselda Bala.*

69.1. Komisioni, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar nëmënyrë të pavarur në lidhje me figurën e subjektit të rivlerësimit, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Konkretisht, është kërkuar përditësimi i të dhënave për subjektin dhe me shkresën konfidenciale, Komisioni është informuar se nuk ka pasur të dhëna.

69.2. Për sa kohë që nga hetimi administrativ⁷⁸ nuk u gjenden elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, apo të dhëna për korrupsion, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Eriselda Bala ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Vlerësimi i aftësive profesionale

70. Raporti⁷⁹ për analizimin e aftësive profesionale është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet bazuar në ligjin nr.

⁷⁶Vendimi nr. ***.

⁷⁷Vendimi nr. ***.

⁷⁸Shkresë nr. *** prot., datë 16.4.2021.

⁷⁹Raporti nr. *** prot., datë 17.12.2021, miratuar me vendimin nr. ***, datë 17.12.2021, të KLP-së.

84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; si dhe (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

71. Analiza e gjetjeve⁸⁰ dhe raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, i cili është i nënshkruar dhe i plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; (ii) tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; si dhe (iv) të dhënave nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, sektori i protokoll-arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar, si vijon:

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se prokurorja Eriselda Bala, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit. Prokurorja Eriselda Bala shfaq aftësi shumë të mira në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi, duke përdorur arsyetim të qartë dhe lidh drejt normën ligjore me zbatimin e saj. Subjekti ka njohuri të plota rreth instituteve të së drejtës penale dhe shfaq njohuri të mira edhe në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të normave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Nga dosjet e vëzhguara konstatohet se ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret për procedimet për të cilat janë ndjekur nga prokurorja. Kështu, menjëherë pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti i rivlerësimit përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se ajo identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme. Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurorja Eriselda Bala, për vitet 2015 dhe 2016, të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se për aftësitë profesionale, në cilësinë e prokurorit, është vlerësuar “shumë mirë”.

b) Arsyetimi ligjor

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë prokurorja dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, evidentohet se subjekti i rivlerësimit Eriselda Bala shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej saj kanë shtjellim të kuptueshëm. Subjekti organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar për aktet përkatëse dhe tregon kujdes që konkluzionet e saj të përfaqësojnë një lidhje koherente mes fakteve të parashtruara në akt dhe bazës ligjore të përdorur gjatë arsyetimeve. Në arsyetimet ligjore prokurorja bën një analizë përveç normave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej saj të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore dhe etike. Lidhur me tetë aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se nga ana e saj bëhet analizë mbi rrethanat e faktit, provave të mbledhura, provave të paraqitura nga mbrojtja, si dhe kërkesave dhe pretendimeve të mbrojtjes, duke shprehur qëndrimin e saj logjik mbi zgjidhjen ligjore të çështjeve në ndjekje.

⁸⁰Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Sipas të dhënave rezulton se për periudhën e punës si prokurore, subjekti ka trajtuar 533 çështje. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në datën 23.1.2020 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për përzgjedhjen e pesë dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, rezulton se nga ana e subjektit tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara.

Konstatohet se subjekti Eriselda Bala ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuarra dhe numrit total në çështjeve të përfunduara për të gjithë periudhën e vlerësimit.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore

Prokurorja Eriselda Bala kryen veprime procedurale hetimore, të cilat rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet që nga ana e subjektit të rivlerësimit veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat e aktet e nevojshme dhe konkluduar në një vendimmarrje. Lidhur me njoftimet e vendimmarrjeve, konstatohet se është respektuar detyrimi për të kryer njoftimet përkatëse subjekteve.

Gjithashtu, vihet re se qëndrimi i prokurores në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e saj të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Prokurorja ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të strukturuarra dhe në respektim të normave të drejtshkrimit.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga prokurorja, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nuk rezulton të ketë pasur ankesa se nga subjekti të jenë kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla, jo në përputhje me etikën profesionale të prokurores.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Eriselda Bala dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e rëna në short, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Eriselda Bala. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Nga tri dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjet e përzgjedhura në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektit Eriselda Bala për vitet 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, subjekti Eriselda Bala rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

Rivlerësimi i aftësive profesionale

72. Komisionit, në lidhje me analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, në tërësi nuk i rezultuan problematika në lidhje me tri dokumentet ligjore, të llojit vendim pushimi të procedimit penal, konkluzione mbi çështjen penale dhe kërkesë për gjykim, të përzgjedhura nga ky i fundit, si dhe në pesë dosjet e përzgjedhura me short, të llojit vendime pushimi ose mosfillimi të procedimeve penale, kërkesë për gjykim dhe praktikë të ekzekutimit të vendimit penal. Komisioni, nga tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, ka konkluduar se vendimet e pushimit të procedimit penal, konkluzionet dhe kërkesat për gjykim të hartuara nga subjekti, rezultojnë të strukturuar në mënyrë logjike dhe me një gjuhë të kuptueshme. Nga përmbajtja konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta dhe përmbajnë referenca ligjore. Teksti paraqitet i kuptueshëm dhe i ndarë në paragrafë, duke përmendur dhe analizuar drejt në arsyetim normat e Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale.

73. Komisioni, në referim të rubrikës mbi të dhënat arkivore, ka konstatuar se në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme janë administruar tri ankesa në të cilat përmendet subjekti i rivlerësimit. Nga analizimi i tyre Komisionit i rezultoi se:

73.1. Shtetasi M.B, në ankesën drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, kërkonte rifillimin e hetimeve të çështjes nr. *** të vitit 2014, të regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pretenduar se kjo çështje ishte mbyllur nga ana e prokurores Eriselda Bala. Rezulton se Prokuroria e Përgjithshme, pasi ka administruar këtë ankesë/kërkesë, është informuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë se ndaj vendimit të mosfillimit të kallëzimit penal nuk është ushtruar ankim nga ana e kallëzuesit. Në vijim rezulton se, pas verifikimeve dhe marrjes së një kopjeje të akteve të kallëzimit penal, Prokuroria e Përgjithshme i ka kthyer përgjigje ankuesit/kërkuesit se vendimmarrja e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë është e drejtë dhe se nuk ka asnjë shkak për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit, duke e konsideruar si një çështje të juridiksionit administrativo-civil kallëzimin e shtetasit M.B.

Në këto kushte, referuar veprimeve dhe procedurës së ndjekur nga Prokuroria e Përgjithshme, e cila ka konkluduar se kjo çështje nuk i përkiste juridiksionit penal por atij administrativo-civil, Komisioni vlerësoi se nuk kishte problematika lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

73.2. Shtetasja A.S, e cila kishte bërë ankesë në Prokurorinë e Përgjithshme, rezultoi se kishte bërë edhe denoncim për të njëjtën çështje dhe me të njëjtin objekt pranë Komisionit të

Pavarur të Kualifikimit. Në këtë kuadër, ky rast gjendet i trajtuar në vijim në rubrikën e denoncimeve.

73.3. Ankesa e shtetas A.S dhe avokates së saj M.K në Prokurorinë e Përgjithshme i referohej disa subjekteve, ndër të cilët edhe subjektit të rivlerësimit, lidhur me vendimmarrjen e mosfillimit dhënë prej saj në datën 23.11.2015, për procedimin penal të materialit kallëzues nr. ***, datë 2.11.2015. Ankesa kishte si objekt mosnjoftimin e vendimit të mosfillimit si rezultat i së cilës ankuesja pretendonte se nuk mund të ushtronte të drejtën e ankimit. Rezultoi se me shkresën nr. *** prot., datë 6.7.2017, Prokuroria e Përgjithshme i ka kthyer përgjigje ankueses se ankesa e saj është dërguar për ndjekje në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

74. Në përfundim të hetimit administrativ lidhur me ankesën e shtetas A.S, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime për: (i) pretendimin e ankuesit për mosnjoftimin e vendimit në kohë, si dhe (ii) veprimet e ndërmarra nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas kalimit të ankesës për ndjekje, duke i kërkuar të depozitojë dokumentacionin nga fashikulli penal.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

75. Subjekti, në parashtrimet e saj lidhur me ankesën, ka qartësuar fillimisht rrethanat e çështjes, duke deklaruar se ankuesja ka bërë kallëzim ndaj ish-bashkëshortit të saj, me pretendimin se ai tregonte parfume të falsifikuara dhe i shmangej detyrimit tatimor. Subjekti ka pretenduar se, pas studimit të materialit kallëzues (nr. ***, datë 2.11.2015), nga ana e saj, me vendimin e datës 23.11.2015, është vendosur “mosfillimi i procedimit penal”, me argumentin se *“nuk ndodhemi përpara elementeve të ndonjë vepre penale”*.

75.1. Sa i përket pretendimit të ankueses lidhur me mosnjoftimin e vendimit të mosfillimit, subjekti ka pretenduar se:

- Në pikën 5 të vendimit të mosfillimit është cituar e drejta e palëve për ankim në gjykatë, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit.

- Në datën 3.12.2015 vendimi është miratuar nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe një kopje e tij i është njoftuar me shkresën përcjellëse nr. *** prot., datë 11.12.2015, Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, kallëzueses/ankueses A.S dhe të kallëzuarit B.H (bashkëshortit të saj).

- Nga posta është kthyer zarfi për mosnjoftimin e të kallëzuarit, ndërkohë që nuk rezulton të jetë kthyer kopja e vendimit të dërguar kallëzueses A.S.

- Fakti që nga ana e ankueses është cituar në ankesë edhe data e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, 23.11.2015, tregon faktin se ajo ka marrë dijeni për këtë vendimmarrje të prokurorit dhe mund ta kishte ushtruar të drejtën e saj për t’u ankuar në gjykatë brenda 5 ditëve nga momenti i marrjes dijeni prej saj në lidhje me vendimin e prokurorit.

- Nga verifikimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. extra prot., datë 28.3.2022, rezulton se ndaj vendimit të mosfillimit të kallëzimit penal nr.*** të vitit 2015, nuk rezulton të jetë bërë ankim.

75.2. Sa i përket veprimeve të ndërmarra nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas kalimit të ankesës për ndjekje nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, subjekti ka pretenduar se:

- Nuk kishte dijeni për këtë shkresë, pasi nga nëntori i vitit 2016 deri më 22.9.2017 ka qenë me leje lindjeje, me qëllim përkujdesje për djalin e saj të vogël, të lindur në datën 23.11.2016.

- Shkresat e ardhura nga institucionet e tjera apo qytetarët, për më tepër kur nuk kanë lidhje me çështjet në hetim, por si në rastin në fjalë ka lidhje me çështjet e arkivuara, trajtohen nga Drejtuesi Prokurorisë ose administrata e prokurorisë, konkretisht kryesekretaria.

Në mbështetje të pretendimeve lidhur me këtë çështje, subjekti ka depozituar disa dokumente⁸¹.

75.3. Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, çmon se qëndrojnë shpjegimet e subjektit lidhur me provueshmërinë e njoftimit të vendimit të mosfillimit të procedimit dhe me rrethanat që i kanë pamundësuar subjektit pasjen dijani për shkresën që Prokuroria e Përgjithshme i kishte dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke dalë në konkluzionin që në këtë rast nuk ka problematika sa i përket vlerësimit të kriterit profesional.

76. Komisioni është vënë në dijeni nëpërmjet artikujve në media lidhur me disa çështje penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit, për të cilat u vlerësua i nevojshëm administrimi i dosjeve penale. Në përgjigje të kërkesave të Komisionit⁸², Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka depozituar⁸³ dosjet penale përkatëse.

77. Komisioni administroi dosjen penale⁸⁴ që i përket procedimit penal nr. *** të vitit 2018, regjistruar për veprën penale “keqtrajtim i të miturit”, parashikuar nga neni 124/b/1 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetases N.SH. Sipas të dhënave të administruara rezultoi se kallëzimi penal në komisaratin e policisë është bërë nga nëna e të miturit, shtetasja D.K, e cila pretendonte se djali i saj A.H është dëmtuar në kopsht, duke dyshuar tek drejtoresha e tij, shtetasja N.SH. Në vijim, rezulton se oficerët e policisë gjyqësore kanë kryer veprimet hetimore dhe i kanë referuar materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Komisionit, nga analizimi i fashikullit penal, i rezultoi se subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera:

- ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal, për veprën penale “keqtrajtim i të miturit”, parashikuar nga neni 124/b/1 i Kodit Penal dhe ka administruar materialet procedurale hetimore të përcjella nga Komisarati i Policisë nr. 4 Tiranë;
- ka urdhëruar kryerjen e disa veprimeve hetimore;
- ka njoftuar nënën e fëmijës, shtetasen D.K, mbi përfundimin e hetimeve paraprake të procedimit penal, duke analizuar veprimet e kryera hetimore;
- ka dërguar kërkesën për pushimin e procedimit penal në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kërkesa ju është dërguar për dijeni edhe palëve.

78. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 10.6.2019, me kërkues Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga subjekti, ndër të tjera, ka vendosur: “Kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përkasin procedimit penal nr. *** të vitit 2018 dhe vazhdimin e hetimeve sipas detyrave të përcaktuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, veprime të cilat duhet të përfundojnë brenda 40 ditëve”. Vendimi nuk është ankimuar dhe ka marrë formë të prerë në datën 25.6.2019.

79. Komisionit, nga analizimi i pjesës arsyetuese të vendimit, i ka rezultuar se pala kallëzuese ka ngritur në seancë pretendimin se prokuroria nuk ka kryer hetim të plotë, pasi janë pyetur prindër të fëmijëve të cilët nuk janë në grupin e të miturit të pretenduar të dhunuar, por janë

⁸¹(i) Shkresë nr. *** prot., datë 28.3.2022, me objekt “kthim përgjigje”, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (ii) një kopje e vendimit të mosfillimit të kallëzimit penal nr. *** të vitit 2015; (iii) shkresë përcjellëse nr. *** prot./E. B., datë 11.12.2015, me anë të të cilës një kopje e vendimit i është dërguar shtetasit B.H; (iv) shkresë përcjellëse nr. *** prot./E. B., datë 11.12.2015, me anë të të cilës një kopje e vendimit i është dërguar shtetases A.S; (v) shkresë përcjellëse nr. *** prot./E. B., datë 11.12.2015, me anë të të cilës një kopje e vendimit i është dërguar Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë; (vi) fotokopje e zarfit të kthyer nga posta mbi mosnjoftimin e vendimit shtetasit B.H; (vii) vërtetim nr. extra prot., datë 28.3.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (viii) kopje e raportit për leje lindjeje; (ix) listëpagesat e punëdhënësit gjatë periudhës së lejes së lindjes.

⁸²Kërkesë nr. *** prot., datë 13.12.2021 dhe kërkesë nr. *** prot., datë 16.12.2021 (ripërsëritur me shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2022).

⁸³Administruar nga Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë 21.12.2021 dhe shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2022.

⁸⁴Dërguar me shkresën nr. *** prot., të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

persona të punësuar dhe paguhen nga e kallëzuar N.SH. Gjykata ka çmuar se për një hetim të plotë e të gjithanshëm të çështjes, vendimi i prokurorisë për pushimin e procedimit penal nr. *** duhet shfuqizuar dhe i ka kthyer aktet prokurorisë, duke i caktuar kësaj të fundit detyrën që të marrë deklaratimet e dy prindërve të fëmijëve të përzgjedhur nga lista e prindërve nga pala kallëzuese.

80. Komisionit i ka rezultuar se subjekti e ka zbatuar vendimin e gjykatës dhe më pas ka paraqitur sërish kërkesë për pushimin e procedimit penal, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në analizë të veprimeve procedurale të kryera gjatë hetimit dhe dokumentacionit në fashikullin penal, duke u përqendruar në vendimin e pushimit të subjektit, me njoftimin e rezultateve të hetimit, i kërkoi subjektit shpjegime lidhur me moskryerjen e veprimeve hetimore për pyetjen e prindërve të fëmijëve të cilët ishin në të njëjtin grup më fëmijën e pretenduar të dhunuar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

81. Subjekti, në parashtrimet e saj në lidhje me këtë procedim penal, ka pretenduar se:

- Janë kryer një sërë veprimesh hetimore, duke specifikuar se nga oficerja e policisë gjyqësore, dhe më tej edhe prej saj personalisht, janë pyetur disa prindër të fëmijëve që frekuentonin kopshtin nr. *** të Tiranës, konkretisht 7 prindër, pa u përfshirë këtu kallëzimetarja, nëna e fëmijës A.H.

- Duke qenë se episodi i pretenduar ka ndodhur në muajin gusht dhe si rrjedhojë stafi ishte i reduktuar, dhe duke qenë se edhe frekuentimi i kopshtit në këtë periudhë nuk ishte në kapacitet të plotë nga fëmijët, pasi edhe prindërit zgjedhin t'i bëjnë pushimet në një nga këta dy muaj, në praktikë ndodh bashkimi i dy grupeve (klasave) të fëmijëve.

- Pasi nga hetimi ka arritur në konkluzionin se nuk provohej të ishte kryer vepra penale, në bazë të neneve 328 dhe 329 të Kodit të Procedurës Penale, ka dërguar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë “kërkesën për pushimin e procedimit penal”.

- Sa i përket seancës gjyqësore, pavarësisht pretendimit të nënës së fëmijës A.H se asnjë nga prindërit e pyetur gjatë hetimeve nuk ishte prind i fëmijëve të grupit të zakonshëm të fëmijës së cituar, gjithsesi rezultoi të ishin në po të njëjtin grup në ditën kur pretendohet të kishte ndodhur ngjarja.

- Edhe pas pyetjes së prindërve të fëmijëve, të lënë si detyrë nga gjykata, përsëri nuk rezultoi asnjë e dhënë keqtrajtimi të fëmijëve.

- I ka përmbushur plotësisht detyrat e lëna nga gjykata dhe fakti që kjo e fundit e ka miratuar kërkesën për pushim tregon se ajo e ka çmuar se nga ana prokurores janë përmbushur detyrat e lëna.

- Ndaj vendimit nr. ***, datë 5.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është ushtruar ankim dhe çështja aktualisht është dërguar në Gjykatës e Apelit Tiranë dhe është ende në shqyrtim.

Subjekti, në mbështetje të pretendimeve, ka depozituar disa dokumente⁸⁵.

82. Në analizë të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, Komisioni evidenton se: (i) veprimet hetimore të ndërmarra nga subjekti kanë qenë të plota, pavarësisht faktit se prindërit e fëmijës së pretenduar të dhunuar, në seancë kanë kërkuar pyetjen e disa prindërve të tjerë të fëmijëve në një grup me fëmijën e tyre, ndërkohë që këtë të drejtë procedurale mund ta kishin kërkuar edhe gjatë hetimit, referuar germës “dh”, të pikës 1, të nenit 58 “Të

⁸⁵(i) Vërtetim nr. extra prot., datë 28.3.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; si dhe (ii) kopje të vendimit të gjykatës të printuar nga sistemi.

drejtat e viktimës” të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se: “*Viktima e veprës penale ka të drejtë të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrijë kërkesa të tjera përpara organit procedues*”; (ii) nga verifikimi i akteve të dosjes ka rezultuar se subjekti i ka vënë në dispozicion palës kallëzuese të veprës (prindërve të të miturit) kopje të fashikullit penal, mbi bazën e kërkesës së këtyre të fundit, ndërsa lidhur me kërkesat e tjera të tyre i ka sqaruar se duhet t’i parashtronin në gjykatë, sikurse edhe ka ndodhur; (iii) referuar vendimit të gjykatës, provohet se subjekti e ka zbatuar detyrën e lënë nga gjykata për pyetjen e dy prindërve të tjerë nga emrat e propozuar në seancë nga kallëzuesit, ku gjithashtu nuk u provua ushtrimi i dhunës nga ana e personit të kallëzuar (drejtoresha e kopshtit) dhe në përfundim çmon se lidhur me këtë çështje nuk konstatohen problematika sa i përket vlerësimit të kriterit profesional. Gjithashtu, për sa kohë kjo çështje është aktualisht në proces mbi ankimin e ushtruar, ligjshmëria e saj është objekt i punës së gjykatave më të larta.

83. Komisioni administroi edhe dosjen penale⁸⁶ që i përket procedimit penal nr. *** të vitit 2020, regjistruar për veprën penale “kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit G.N, i hetuar nga subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të dosjes hetimore, vlerëson se subjekti i rivlerësimit në hetimin e kësaj çështjeje ka kryer veprime të plota hetimore, ka respektuar afatet procedurale dhe në këtë kuadër çmon se në këtë çështje nuk konstatohen problematika lidhur me kriterin profesional.

Denoncimet e publikut të depozituara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit

84. Për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar dy denoncime të paraqitura në Komision, ku pas shqyrtimit të tyre i janë kërkuar shpjegime, si vijon:

85. Denoncimi⁸⁷ i shtetasës A.S

85.1. Kjo shtetase ankohet lidhur me pushimin në mënyrë të padrejtë të çështjes penale të iniciuar mbi bazën e kallëzimit të saj dhe moskryerje të hetimeve në mënyrë të plotë nga subjekti i rivlerësimit Eriselda Bala. Gjithashtu, denoncuesja ankohet edhe për disa subjekte të tjera rivlerësimi. Komisioni ka konstatuar se denoncuesja ka bërë ankim me të njëjtin objekt në Prokurorinë e Përgjithshme, në adresë të subjektit të rivlerësimit, evidentuar më sipër në pikën mbi të dhënat arkivore.

85.2. Problematikat e pretenduara nga denoncuesja lidhen me një konflikt pronësor të saj me shtetasit SH.I dhe A.S, ndaj të cilëve ka bërë kallëzim penal për vjedhje me anë të mashtrimit. Ky konflikt bazohet në kontratën e premtimit dhe kalimit të të drejtave reale për një apartament (nr. ***, datë 31.5.2014), që denoncuesja ka lidhur me shtetasen SH.I, në cilësinë e shitëses. Denoncuesja pretendon se nuk po gëzon të drejtat e saj të pronësisë mbi këtë pronë, pasi shtetasja SH.I gjithashtu ka nënshkruar një deklaratë noteriale (nr. ***, datë 25.8.2014) me një shtetase tjetër S.E, ku merr përsipër që të lirojë apartamentin që i kishte shitur më parë denoncueses. Denoncuesja është ndjerë e mashtruar dhe ka bërë kallëzim penal në vitin 2016 ndaj shtetasve SH.I dhe A.S. Në vijim, denoncuesja ka pretenduar se procedimi penal i iniciuar mbi bazën e këtij kallëzimi është pushuar nga subjekti i rivlerësimit në mënyrë të padrejtë dhe hetimet nuk janë kryer të plota dhe të gjithanshme, si dhe ka evidentuar disa veprime për të cilat ka pretenduar që nuk ishin kryer nga subjekti.

85.3. Referuar denoncimit, denoncuesja gjithashtu pretendon se shtetasja SH.I, për shkak të konfliktit të krijuar, i ka dorëzuar një apartament tjetër, për të cilin pretendon se ka pasur konflikt civil me shtetasin D.B (pronar i truallit), i cili ka bërë kallëzim penal ndaj

⁸⁶Dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁸⁷Denoncim nr. *** prot., datë 10.1.2019.

denoncueses për dhunim banese. Ky kallëzim penal, referuar deklaratave të denoncueses, është hetuar nga një subjekt tjetër.

85.4. Rezulton se denoncuesja nuk ka paraqitur dokumentacion provues në mbështetje të pretendimeve të saj dhe nëse ka bërë ankim ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal të subjektit të rivlerësimit.

85.5. Për sa më sipër, ne rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime, duke u përqendruar në pretendimet e denoncuesit mbi moskryerjen e disa veprimeve hetimore, mbi faktin nëse nga denoncuesi është ushtruar e drejta e ankimit, si dhe të depozitohet dokumentacionin përkatës nga fashikulli penal në mbështetje të shpjegimeve.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

85.6. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e saj, fillimisht ka sqaruar se vendimi i mosfillimit të procedimit penal në lidhje me një material kallëzues të regjistruar në prokurori merret duke u bazuar në ligjin procedural penal (nenet 290 dhe 291), si dhe është rregulluar në vazhdimësi nga udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm dhe konkretisht: udhëzimi nr. 241, datë 21.11.2005, ndryshuar me udhëzimin nr. 2, datë 24.10.2006; dhe udhëzimi nr. 3, datë 19.6.2012. Në këto udhëzime parashikohet qartë se: *“Në rastet kur me gjendjen e akteve prokurori vlerëson se ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit, vendos mosfillimin e procedimit... Gjatë kësaj periudhe mund të bëhet një minimum verifikimesh nëse ka nevojë për një gjë të tillë, në të kundërt vendoset regjistrimi i procedimit”*.

85.7. Sa i përket veprimeve procedurale dhe hetimore të kryera, subjekti ka deklaruar se:

- Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, datë 16.3.2016, të shtetas A.S.

- Pas studimit të materialit kallëzues ka çmuar të nevojshme kryerjen edhe të disa veprimeve të mëtejshme verifikuese dhe në bazë të rezultateve të verifikimit, nga ana e saj, me vendimin e datës 12.5.2016 është vendosur mosfillimi i ndjekjes penale, duke arritur në konkluzionin se: *“Nuk ndodhemi përpara elementeve të ndonjë vepre penale, por konflikti përbën një konflikt të mirëfilltë civil dhe, si i tillë, duhet të zgjidhet me anë të një padie civile në gjykatën civile”*.

- E ka njoftuar kallëzuesen, duke referuar pikën 3 të vendimit, ku parashikohet njoftimi i kallëzueses (denoncueses) mbi të drejtën e ankimit brenda pesë ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, si dhe ka urdhëruar sekretarinë për njoftimin e këtij vendimi palëve të interesuara.

- Një kopje e vendimit të mosfillimit është dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 30.5.2016, por në fund të shkresës përcjellëse, në anën e majtë të fletës, rezulton se nga kallëzimitarja A.S të jetë bërë shënimi *“mora një kopje të vendimit të kthyer nga posta në datën 5.4.2017”*. Për kallëzimitaren A.S, nga ky moment, data 5.4.2017, data në të cilën provohet të ketë marrë kopjen e vendimit të mosfillimit, i lind e drejta për ta ankimuar në gjykatë, gjë që nuk rezulton ta ketë bërë, pasi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk rezulton të ketë ndonjë kërkesë apo ankesë ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. ***, datë 30.5.2016.

Subjekti, në mbështetje të pretendimeve, ka depozituar disa dokumente⁸⁸.

85.8. Trupi gjykues paraprakisht evidenton faktin se denoncuesja ka bërë ankim me të njëjtin objekt në Prokurorinë e Përgjithshme, në adresë të subjektit të rivlerësimit. Sa i përket

⁸⁸(i) Shkresë nr. *** prot., datë 28.3.2022, me objekt “kthim përgjigje”, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (ii) kopje të vendimit të mosfillimit të kallëzimit penal nr. *** të vitit 2016, datë 12.5.2016; (iii) shkresë përcjellëse nr. *** prot./E. B., datë 30.5.2016, me anë të të cilës një kopje e vendimit të mosfillimit të procedimit penal i është dërguar shtetas A.S; (iv) vërtetim nr. extra prot., datë 28.3.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ankesës, ka rezultuar se nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 24.1.2019, i është kthyer përgjigje ankueses se çështja është duke u shqyrtuar në gjykatë dhe se kjo e fundit do të shqyrtojë dhe vlerësojë ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga ana e prokurorëve. Sa i përket denoncimit, në analizë edhe të dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues ka konstatuar se në këtë rast nuk bëhet fjalë për vendim pushimi të procedimit penal, por për vendim mosfillimi të procedimit penal, si dhe konstaton se:

- Vendimi i subjektit për mosfillimin e procedimit, datë 12.5.2016, është i bazuar në germën “ç”⁸⁹ të nenit 290/1 dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale. Referuar këtij vendimi, rezulton se subjekti ka kryer disa veprime hetimore dhe në përfundim ka arsyetuar se: *“Nuk ndodhemi përpara elementeve të veprës penale të ‘mashtrimit’, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, por përpara një konflikti civil i cili mund të zgjidhet me anë të një padie në gjykatë në rast se palët nuk arrijnë ta zgjidhin me marrëveshje midis tyre”*.

- Referuar shkresës përcjellëse nr. *** prot./E. B., datë 30.5.2016, të prokurorisë, për dërgimin e kopjes së vendimit të mosfillimit të procedimit penal (të depozituar si provë nga subjekti), rezulton se denoncuesja është njoftuar me vendimin e mosfillimit dhe me të drejtën për t’u ankuar në gjykatë.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën e datës 28.3.2022, ka vërtetuar se nuk ka vendim penal të dhënë apo kërkesë penale të regjistruar/në gjykim lidhur me kallëzimin penal nr. ***, datë 16.3.2016, me kallëzuese shtetasen A.S.

85.9. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se, lidhur me këtë denoncim nuk evidenton problematika që mund të lidhen me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

86. Denoncim⁹⁰ i shtetasit A.M

86.1. Në denoncimin e tij ky shtetas, kryesisht, ankohet ndaj subjekteve të tjera për dhënie vendimesh gjyqësore të padrejta (duke u bazuar në dokumentacion të falsifikuar) dhe zvarritje procesesh gjyqësore. Problematikat e pretenduara nga denoncuesi lidhen me një konflikt pronësor të tij me shtetasin A.I, të cilin ka deklaruar se e ka paditur për falsifikim dokumentacioni. Ai ka pretenduar se prokurorja e çështjes, subjekti i rivlerësimit, e mbron atë. Në vijim, denoncuesi ka pretenduar se e ka ankimuar çështjen në gjykatën e apelit, e cila e ka rikthyer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe se subjekti në seancë gjyqësore është shprehur se *“kanë kaluar pesë vjet nga padia”*, kështu që nuk u mor asgjë për bazë. Në përfundim, denoncuesi ka deklaruar se çështja është regjistruar në datën 14.4.2016 në Gjykatën Administrative të Apelit dhe nuk është caktuar ende data e gjyqit.

Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit disa dokumente⁹¹, por Komisioni konstatoi se nga analizimi i tyre nuk reflektohej subjekti i rivlerësimit.

⁸⁹Neni 290/1, germa “ç” e Kodit të Procedurës Penale, në fuqi në këtë periudhë, parashikonte: *“1. Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit, kur: ç) kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston”*.

⁹⁰Denoncim nr. *** prot., datë 10.1.2019.

⁹¹Printim nga faqja zyrtare e Gjykatës Administrative të Apelit lidhur me detajet e çështjes, çështja nr. ***, datë regjistrimi 14.4.2016, me paditës shtetasin A.I dhe palë e paditur denoncuesi, ZVRPP Pogradec dhe Bashkia Pogradec dhe objekt “Konstatim i pavlefshmërisë së veprimit juridik të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme 300 m², në emër të të paditurit A.M. Fshirjen e regjistrimit të pasurisë të bërë në vitin 2004. Detyrimin e ZVRPP-së Pogradec të regjistrojë këtë sipërfaqe...”;vendimi nr. ***, datë 14.5.2015, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, me paditës shtetasin A.I dhe palë e paditur denoncuesi, ZVRPP Pogradec dhe Komuna ***, Pogradec dhe objekt “Konstatim i pavlefshmërisë së veprimit juridik të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme me sip. 300 m², në emër të të paditurit A.M. Fshirjen e këtij regjistrimit (të kryer në vitin 2004). Detyrimin e palës së paditur ZVRPP Pogradec të regjistrojë këtë sipërfaqe në emër të ish-pronarit D.I (të trashëgimtareve të tij);certifikatë për vërtetim pronësie, datë 30.12.2008, ZVRPP-ja Pogradec, numri i pasurisë ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, për pasurinë truall me sip. 432 m², në emër të shtetasit R.B dhe hartën treguese të pasurisë.

86.2. Për sa më sipër, me rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime: (i) lidhur me rolin dhe veprimet hetimore të kryera prej saj në këtë çështje; (ii) mbi statusin aktual të çështjes; si dhe (iii) të depozitojë dokumentacionin përkatës në mbështetje të shpjegimeve.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

86.3. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrime, ka sqaruar se fillimisht, për të verifikuar nëse kishte hetuar ndonjë çështje penale me kallëzues denoncuesin, ka kërkuar informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, nga ku ka rezultuar se në bazë të kallëzimit të këtij shtetasi, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar kallëzimin penal nr.*** të vitit 2009. Ndaj këtij kallëzimi prokurori i çështjes ka vendosur mosfillimin e ndjekjes penale. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim prej tij në gjykatë, e cila ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal. Në vijim, subjekti ka deklaruar se është caktuar si prokuror për hetimin e kësaj çështjeje, pasi prokurori (subjekt tjetër) ishte transferuar në një prokurori tjetër.

86.4. Lidhur me këtë çështje, subjekti ka deklaruar se:

- Pas regjistrimit të procedimit, ajo ka kryer disa veprime hetimore por për shkak se vepra penale kishte ndodhur gati 20 vjet më parë, është vendosur pushimi i çështjes, për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit në përputhje me nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale.

- Kundër këtij vendimi kallëzuesi/denoncuesi ka ushtruar të drejtën e ankimit, por si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ashtu dhe Gjykata e Apelit Korçë, e ka gjetur të drejtë vendimin e pushimit të prokurorit duke e lënë atë në fuqi.

- Sa i përket, vendimit të printuar nga sistemi i Gjykatës së Apelit Administrativ dhe i përmendur dhe në denoncim, subjekti ka sqaruar se përbën një gjykim civil ku prokurori nuk është palë në proces.

Subjekti, në mbështetje të pretendimeve, ka depozituar disa dokumente⁹².

86.5. Nga administrimi i provave të depozituara, në raport me pretendimet e subjektit, Komisioni çmon se lidhur me këtë denoncim nuk duket të ketë problematika sa i përket vlerësimit të kriterit profesional.

87. Në konkluzion, pas analizimit të dy denoncimeve, referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni ka vlerësuar se në tërësi nuk ka pasur fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në cenimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Rivlerësimi profesional sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, në zbatim të pikës 1 të nenit 42 dhe të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, është kryer vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, duke arritur nëpërfundimin se:

i) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

⁹²(i) vendim mosfillimi, datë 14.8.2009; (ii) vendim nr. ***, datë 1.3.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; (iii) urdhër regjistrimi i procedimit penal, datë 4.10.2010; (iv) vendim pushimi, datë 5.1.2011; (v) vendim nr. ***, datë 24.6.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

ii) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.

iii) Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.

iv) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni arriti në përfundimin se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave ligjore të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarinim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.

- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës.

- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Bazuar në parimet e parashikuara në pikën 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në Aneksin e Kushtetutës dhe në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, vendimmarrja për subjektin e rivlerësimit Eriselda Bala është bazuar në përfundimet e arritura në lidhje me kriterin e pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor të rrethanave dhe procedurave që kanë lidhje me këtë kriter, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Eriselda Bala, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 7.4.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore/kundër

Firdes SHULI
Anëtare

Sekretare gjyqësore

Resilda Bilaj